

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

G R E T A

Group of Experts on Action
against Trafficking in Human Beings

GRETA(2023)11_ALB_rep

Reply from Albania to the Questionnaire for the evaluation of the implementation of the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings by the Parties

Fourth evaluation round

Thematic focus: Addressing vulnerabilities to trafficking in
human beings

Albanian version

Reply submitted on 20 February 2024

Introduction

In accordance with Article 38, paragraph 1, of the Convention on Action against Trafficking in Human Beings (“the Convention”), GRETA evaluates the implementation of the Convention following a procedure divided into rounds. At the beginning of each round, GRETA selects the specific provisions on which the evaluation procedure is based.

The first round of monitoring of the Convention provided an overview of its implementation by States Parties. The second evaluation round of the Convention examined the impact of legislative, policy and practical measures on the prevention of trafficking in human beings (THB), the protection of the rights of victims of trafficking, and the prosecution of traffickers, paying particular attention to measures taken to address new trends in human trafficking, in particular trafficking for the purpose of labour exploitation, and the vulnerability of children to trafficking. The third evaluation round focused on trafficking victims’ access to justice and effective remedies.

GRETA has decided that the fourth evaluation round of the Convention will focus on **vulnerabilities to human trafficking** and measures taken by States Parties to prevent them, detect and support vulnerable victims, and punish the offenders. This includes a focus on the use of information and communication technology (ICT), which brings structural changes to the way offenders operate and exacerbates existing vulnerabilities.¹

A number of provisions of the Convention establishing substantive and procedural obligations are relevant to this topic. The concept of “vulnerability” appears in Articles 4 (definitions), 5 (prevention of trafficking in human beings) and 12 (assistance to victims) of the Convention. According to paragraph 83 of the Explanatory report to the Convention, “by abuse of a position of vulnerability is meant abuse of any situation in which the person involved has no real and acceptable alternative to submitting to the abuse. The vulnerability may be of any kind, whether physical, psychological, emotional, family-related, social or economic. The situation might, for example, involve insecurity or illegality of the victim’s administrative status, economic dependence or fragile health. In short, the situation can be any state of hardship in which a human being is impelled to accept being exploited. Persons abusing such a situation flagrantly infringe human rights and violate human dignity and integrity, which no one can validly renounce.”

GRETA refers to the ICAT Issue Brief No. 12/2022 on Addressing vulnerability to trafficking in persons which refers to vulnerability as “those inherent, environmental or contextual factors that increase the susceptibility of an individual or group to being trafficked”. It classifies vulnerability factors in three categories: personal (e.g. age, gender, ethnicity, disability), situational (e.g. destitution, unemployment, legal status) and contextual (e.g. discriminatory laws, policies and social norms, armed conflicts, crises) factors, which interact and may increase the risk of human trafficking for certain individuals, groups and/or communities.² Vulnerability to human trafficking is also subject to intersectional factors, such as gender, belonging to a minority group and socio-economic status.

Applying a socio-ecological approach to the analysis of vulnerability to human trafficking demonstrates how different risk factors influence vulnerability, and how protective factors may reduce the risk of victimisation by increasing resilience.³ The socio-ecological model considers the complex interplay between individual, relationship, community and societal factors. It helps to understand how anti-trafficking strategies should: (a) reduce the vulnerability of individuals, (b) work with the communities

¹ [Paolo Campana, Online and Technology-Facilitated Trafficking in Human Beings, Council of Europe, April 2022.](#)

² [ICAT Issue Brief No. 12 on Addressing vulnerability to trafficking in persons - Search \(bing.com\)](#)

³ https://www.avoiceforcentraloregon.com/uploads/1/3/9/9/139904528/socio_ecological_model_and_trafficking.pdf

(which may also include relationships) concerned to ensure that their practices or current dynamics do not exacerbate or contribute to vulnerabilities to human trafficking and, (c) change a number of system-driven or structural elements (such as policies) so that they do not facilitate but discourage an environment conducive to human trafficking.

In addition to the thematic focus on vulnerabilities to human trafficking, GRETA has decided that each State Party will receive **country-specific follow-up questions** related to recommendations not implemented or partially implemented after the third evaluation round.

States Parties are requested to transmit to GRETA a reply to this questionnaire **within four months** from the date it was sent. The reply to the questionnaire should be submitted in one of the official languages of the Council of Europe (English and French), and preferably also in the original language. Where appropriate, in order to avoid unnecessary repetition, the reply may refer to information contained in the report submitted by the national authorities on measures taken to comply with the Committee of the Parties' recommendation concerning the implementation of the proposals made in GRETA's third evaluation report. States Parties should provide links, copies or extracts of relevant legislation, regulations, national action plans and case law mentioned in the reply to the questionnaire, in the original language and, wherever possible, also in one of the official languages of the Council of Europe.

A variety of stakeholders and civil society representatives should be effectively consulted in the preparation of the reply to the questionnaire, to ensure that the information provided is as comprehensive as possible.

Part I – Addressing vulnerabilities to trafficking in human beings

I. PREVENTION (Articles 5, 6 and 7)

1. Do you have specific data/research/analysis of what makes people vulnerable to trafficking in human beings (THB) in your country? Please provide information on the categories/groups of people identified as being at risk of becoming victims of human trafficking, and how they are addressed in the national anti-trafficking strategy and/or action plan. Have you identified geographical regions or economic sectors in your country as particularly vulnerable to THB, and how do you address them in your strategy or policy?

Lufta kundër trafikimit të personave vazhdon të jetë një ndër prioritetet kyçe të qeverisë shqiptare dhe të gjithë strukturave të tjera me detyra dhe përgjegjësi në këtë drejtim. Në vitin 2002, me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002 u ratifikua “Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” dhe dy protokollat shtesë të saj”. Prej vitit 2002, për të pasur një veprim të koordinuar kundër trafikimit të personave dhe me qëllim minimizimin e këtij fenomeni, Shqipëria zbaton një kornizë kombëtare strategjike dhe planesh veprimi (2002-2005, 2007-2010, 2011-2013, 2014-2017, 2018-2020, 2021-2023, aktualisht është hartuar Plani i ri Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025), e cila koordinohet, monitorohet nga Ministria e Brendshme dhe zbatohet nga strukturat shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile që operojnë në fushën antitrafikim.

Nisur nga të dhënat që grumbullohen dhe analizohen pranë Autoritetit Përgjegjës, Shqipëria është vend origjine, tranziti dhe destinacioni për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit.

Dy format kryesore të trafikimit në Shqipëri përfshijnë trafikimin me qëllim shfrytëzimin seksual, ku viktimat detyrohen të kryejnë prostitucion dhe trafikimin për lypje dhe punë të detyruar, për të vijuar më tej me fëmijët në situatë rruge, vepra të ulëta kriminale (vjedhje, shpërndarje droge, etj.), premtim për martesë, etj. Grupet vulnerabël, duke përfshirë gratë dhe fëmijët, janë veçanërisht të rrezikuar. Varfëria, papunësia dhe paqëndrueshmëria sociale kontribuojnë në ndjeshmërinë e individëve ndaj rrjeteve të trafikimit. Trafikimi i brendshëm, ku viktimat zhvendosen brenda vendit, vijon të jetë tendencë e vazhdueshme. Kjo tendencë përfshin trafikimin e individëve nga zonat rurale në ato urbane ose ndërmjet rajoneve të ndryshme brenda Shqipërisë.

Grupi më i rrezikuar për viktimizim, si për shfrytëzim prostitucioni, ashtu edhe për forma të tjera të mundshme shfrytëzimi, vazhdon të jetë gjinia femërore. Fëmijët shfrytëzohen më shumë për lypje dhe vepra të ulëta kriminale. Një nga grupet vulnerabël, të cilat shfrytëzohen nga trafikantët janë gratë e vajzat me probleme të shëndetit mendor, të cilat janë shfrytëzuar prej tyre për qëllime seksuale.

Disa nga metodat e përdorura nga trafikantët janë premtimi për martesë, premtimi për punë, shfrytëzimi i situatave të ndryshme vulnerabël, rekrutimi nga rrjetet sociale duke i përfshirë në situatë të rrezikshme që të çojnë drejt shfrytëzimit.

Përsa i përket trafikimit të fëmijëve me qëllim shfrytëzimin për lypje apo punë të detyruar, në vendet fqinjë, BE-së apo Mbretërisë së Bashkuar, në të shumtën e rasteve ka rezultuar që kanë qenë vetë familjarët e tyre që i kanë nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të destinacionit BE-së, për t'u bashkuar me familjarë të tyre, apo për të përfituar nga ligji për azilin, duke u sjellë si viktimë e trafikuar me qëllim përfitimin e dokumentacionit për qëndrim të përhershëm në ato vende.

Për sa i përket mënyrës së rekrutimit, kryesisht përzgjidhen vajza me prindër të divorcuar, pa mbështetje apo në vështirësi ekonomike dhe shëndetësore. Në fillim krijojnë lidhje intime me trafikantët dhe më pas me anë të mashtrimit dhe shtrëngimit shfrytëzohen për prostitucion. Gjithashtu ata i kontrollojnë viktimat nëpërmjet abuzimeve fizike, emocionale dhe psikologjike, abuzimit seksual, kërcënimeve, përdorimit të detyruar të alkoolit dhe drogës, etj. Një mënyrë tjetër është rekrutimi nëpërmjet rrjeteve sociale, si: Facebook, Instagram apo Snapchat etj., duke i ofruar fejesë/martesë, apo duke i premtuar punë dhe një jetë më të mirë. Gjithashtu, një mënyrë tjetër rekrutimi është nëpërmjet telefonit apo njohjes nga persona të tjerë, ku trafikantët shkojnë në familjet e vajzave, duke përdorur si justifikim martesën dhe, duke u prezantuar si dhëndri apo familjarë të tij.

2. What specific measures are taken to reduce children’s vulnerability to THB by creating a protective environment for children? Please provide information in the following areas:

- a. protecting children’s rights from attitudes, customs, behaviour and practices that can have an adverse effect (including child, early and forced marriage, and illegal adoption);

Legjislacioni shqiptar nuk lejon martesat e hershme dhe të detyruara. Neni 7 i Kodit të Familjes parashikon: “Martesa mund të lidhet midis një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Gjykata e vendit ku lidhet martesa, për shkaqe të rëndësishme, mund të lejojë martesën edhe para kësaj moshe”. Neni 8 i Kodit të Familjes parashikon: “Martesa lidhet para nëpunësve të gjendjes civile, me pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve të ardhshëm”.

Kodi i Familjes parashikon një kapitull nga neni 240-262 për birësimin ligjor si dhe kushtet dhe rastet e ndalimit të birësimit. Ligji nr. 9695, datë 19.3.2007, “Për procedurat e birësimit dhe komisioni shqiptar i birësimeve”, i përditësuar, parashikon procedurat për birësimin ligjor.

Fëmijët viktimë informohen për të drejtat e tyre që në kontaktin e parë. Neni 58/a i KPP “Të drejtat e viktimës së mitur” (Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) parashikon që: viktimë e mitur ka të drejtë: (a) të shoqërohet nga një person i besuar prej tij; b) të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale; c) të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut. Organi procedues duhet të trajtojë viktimën e mitur të veprës penale duke mbajtur parasysh moshën, personalitetin dhe rrethanat të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm. Nëse ekziston mundësia që viktimë është e mitur dhe mosha e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur. Viktimë e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kritereve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. Kur viktimë e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedis të përshtatura për të.

Dokumenti strategjik “Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2012-2026”, i miratuar me VKM Nr. 659, datë 03.11.2021, në një nga shtyllat kryesore strategjike “Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme”, parashikon masa, të cilat kanë si synim që fëmijët të rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi. Për realizimin e këtij qëllimi në një prej objektivave, që ka të bëjë me adresimin e normave sociale jopozitive në komunitet dhe familje, në kuadër të parandalimit dhe adresimit të dhunës ndaj fëmijëve, janë parashikuar masa lidhur me hartimin e një plani komunikimi dhe materialeve/produkteve mbështetëse, për të adresuar normat negative sociale që lidhen me të gjitha format e dhunës/abuzimit ndaj fëmijëve, përfshirë dhe tematikën e martesave të hershme.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, e miratuar me VKM-në nr. 400, datë 30.6.2021 në një nga qëllimet strategjike që ka të bëjë me zvogëlimin e të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, me synim fuqizimin e grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet, për të pasur kontroll të plotë, për të vendosur lirshëm dhe me përgjegjësi për çështjet që lidhen me shëndetin seksual e riprodhues. Gjithashtu është parashikuar edhe një masë për fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve, gjyqësorit për të zbatuar kuadrin ligjor të përmirësuar, për të mbështetur vajzat në rrezik dhe për të parandaluar martesat e hershme të fëmijëve.

Për vitin 2023, nga raportimet e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF-ve) në gjithë bashkitë, rezulton që fenomeni i martesave të hershme të detyruara nuk është një fenomen i përhapur. Detyrimi i fëmijëve për martesë ka ardhur duke u zbutur dhe kohët e fundit është bërë një fenomen shumë i rrallë. Ka disa raste të bashkëjetesës së vajzave minorene me bashkëmoshatarë apo më të rritur, që janë ndikuar nga neglizhimi prindëror, ushqyerja me kulturën tradicionale apo komunitare. Në përgjithësi këto raste i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane për shkak të kulturës, normave tradicionale të tyre, varfërisë etj. Megjithatë një ndryshim shumë i madh është vënë re edhe në këtë komunitet pasi kohët e fundit shumë vajza dhe djem janë të ndërgjegjësuar, duke ndjekur shkollën apo kurse të formimit profesional.

NJMF-të bashkëpunojnë dhe me qendrat e kujdesit shëndetësor me qëllim nxitjen e raportimit të rasteve të dhunës në familje, apo incidente të tjerë që mund të parandalojnë fenomenin e martesave të hershme. Në bashkëpunim me strukturat e arsimit, NJMF-ja identifikon fëmijët që nuk janë regjistruar në shkollë apo që kanë braktisur shkollën dhe punon me familjen për regjistrimin dhe rikthimin e tyre në shkollë.

Për vitin 2022, asnjë vajzë nën 18 vjeç nuk ka lidhur martesë në Shqipëri. Sipas të dhënave zyrtare përgjatë vitit 2022 janë regjistruar 18.782 martesat dhe për herë të parë nuk ka asnjë martesë nën moshën 18 vjeç.

Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar takime ndërgjegjësuese me nxënësit e shkollave lidhur me shëndetin seksual dhe riprodhues. Njëkohësisht, gjatë vitit 2022/23 janë trajnuar 40 mjekë pjesë e stafit shëndetësor lidhur me këtë çështje.

Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik shpesh ka organizuar disa sesione informuese dhe trajnime për edukimin ligjor të përfituesve. Shumica e pjesëmarrësve në sesione nuk ishin në dijeni të ndryshimeve në legjislacion që trajtojnë të drejtat e viktimave të veprave penale, veçanërisht të drejtat e viktimave të trafikimit.

E drejta e sigurimit të përkthimit dhe interpretimit parashikohet në VKM-në nr. 499 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit dhe nenin në nenin 58/a të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Gjatë periudhës 2019-2023 për nëntë fëmijë të identifikuar si të mitur të huaj të pashoqëruar, nga Siria dhe një nga Afganistani janë parashikuar masa të plota mbrojtëse, përfshirë ndërmjetësimin kulturor dhe shërbimin e përkthimit dhe interpretimit.

World Vision Albania (WVA) ka kontribuar në promovimin e të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet ndërhyrjeve të mëposhtme:

- Informimi, orientimi, trajnimi i 1082 fëmijëve dhe të rinjve në vitin 2023, nëpërmjet programit Fëmijët dhe Adoleshentët, i cili promovon qytetarinë aktive tek fëmijët, rrit vetëbesimin e tyre dhe i ndihmon ata të kontribuojnë në jetën socio-ekonomike të vendit.

- Në vitin 2024, më shumë se 60 grupe të rinjsh (me një mesatare prej 15-16 anëtarë/grup) janë pjesë e programit të zbatuar nga WVA.
- Në vitin 2023 WVA trajnoi 158 prindër dhe kujdestarë për prindërimin pozitiv dhe krijimin e një mjedisi familjar mbrojtës dhe të shëndetshëm për fëmijët. 160 fëmijë dhe të rinj kanë qenë pjesë e aktiviteteve dhe seancave të përbashkëta familjare me prindërit/kujdestarët e tyre gjatë zbatimit të programit.
- Rritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve dhe lokaliteteve të marginalizuara në 17 komuna në 2023 dhe 24 të synuara në 2024 për të parandaluar disa fenomene si trafikimi i qenieve njerëzore.

Nëpërmjet skemës së Fondit Social dhe në partneritet me Bashkinë e Durrësit, WVA ka vijuar të mbështesë forcimin e shërbimeve të Qendrës për Mbrojtjen dhe Fuqizimin e Familjes, si dhe Shërbimin e Urgjencës për Fëmijët. Duke promovuar një model shërbimi gjithëpërfshirës, kjo qendër fokusohet në parandalimin, mbrojtjen dhe reagimin me shërbime specifike ndaj fëmijëve të rrezikuar nga dhuna, abuzimi, neglizhimi, shfrytëzimi dhe çdo formë tjetër dhune. Në vitin 2023, 183 fëmijë dhe të rritur kanë marrë shërbime ditore dhe rezidenciale në qendrën e ngritur në Durrës. Mbështetja do të vazhdojë të jetë e disponueshme deri në vitin 2024.

Në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës, World Vision vazhdon të mbështesë ofrimin e shërbimeve komunitare në Qytetin e Fëmijëve, një qendër multifunksionale që kontribuon në zhvillimin intelektual, social, shkencor, fizik, artistik dhe shpirtëror të fëmijëve. Fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve përmes këtyre shërbimeve unike është një qasje e fuqishme për t'i edukuar ata se si mund të ndërtojnë mekanizma elastikë për të mbrojtur veten dhe për të reaguar ndaj fenomeneve si trafikimi i qenieve njerëzore. Gjatë vitit 2023, gjithsej 4045 fëmijë 3-18 vjeç kanë vizituar qendrën dhe kanë marrë pjesë në të paktën një nga aktivitetet e ofruara në të. Programi i qendrës i kushtohet forcimit të mekanizmit të mbrojtjes së fëmijëve dhe mbetet një shërbim unik në këtë fushë, duke dhënë kontributin më të madh në edukimin, argëtimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.

WVA ka ndërmarrë veprime të koordinuara me grupet e interesit në lidhje me aktivitetet parandaluese, duke synuar krijimin e një mjedisi mbrojtës për fëmijët, sikurse:

- Fushata ndërgjegjësuere lokale në bashkëpunim të ngushtë me aktorët kryesorë që luftojnë trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri në të gjithë vendin.
- Hartimi i Planeve Lokale të Veprimit në bashkëpunim të ngushtë me Sektorin e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore të komunave ku operon WVA. Ndërmarrja e veprimeve për identifikimin e hershëm dhe raportimi i çështjeve të ndjeshme që lidhen ngushtë me rrezikun e mundshëm të trafikimit. Plani vendor i hartuar dhe zbatuar me stafin e shkollës psiko-sociale dhe njësinë e mbrojtjes së fëmijëve në Bashkinë Kamëz në pothuajse të gjitha shkollat që ndodhen në këtë territor administrativ, për monitorimin e fëmijëve dhe të rinjve me qëllim parandalimin e një fenomeni të përhapur vetëdëmtues të ekspozuar në rrjetet sociale dhe në potencial rrezik trafikimi në 2022-2023.

Avokimi i drejtuar nga fëmijët dhe të rinjtë ka mundësuar pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve, veçanërisht atyre më vulnerabël dhe atyre që u përkasin grupeve sociale më të pafavorizuara në procesin e konsultimit të dokumenteve të rëndësishme për përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve në Shqipëri, si në: Strategjitë Kombëtare, Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2021-2026, Planet Kombëtare të Veprimit, Iniciativat Vendore, takime konsultative për rekomandimet e fëmijëve dhe të rinjve me Institucionet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatin e Popullit për përmirësimin e mekanizmit për pjesëmarrje dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve. Për më tepër,

fëmijët dhe të rinjtë që i përkasin grupeve të të rinjve janë pjesëmarrës aktivë në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, për më shumë se katër vjet. Në këtë Këshill ata kanë ngritur zërin për pabarazitë sociale dhe disa çështje me të cilat përballen ata dhe bashkëmoshatarët e tyre në jetën e përditshme. Krijimi dhe forcimi i Politikës dhe Mekanizmit të Përgjegjshmërisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rriturve të World Vision për të parandaluar praktikën e dëmshme ndaj fëmijëve dhe për të krijuar një mjedis mbrojtës kudo ku WVA ka prani me programe.

- b. developing children's life skills (including media literacy and online safety skills), knowledge and participation;

Siguria e fëmijëve online është një çështje e re në Shqipëri që ka marrë një vëmendje të shtuar vitet e fundit. Në nenin 23 të ligjit nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve” përcaktohet se: “Fëmija ka të drejtë të mbrohet ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhet,” çka do të thotë se ligji parashikon edhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi online.

Gjithashtu për herë të parë kemi një nen të veçantë në këtë ligj (nenin 27) i cili flet për mbrojtjen e fëmijës nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet. Është bërë një përpjekje për të përkufizuar se çdo të thotë “përmbajtje të dëmshme për fëmijën” ku përfshihen të gjitha ato pamje, imazhe dhe çdo material tjetër që qarkullon në internet dhe që cënon dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës.

Ligji vendos detyrimin që të gjitha qendrat e ofrimit të internetit, institucionet e edukimit, si dhe çdo institucion tjetër publik ose privat, i cili ofron akses në internet, të aplikojnë instrumente teknike dhe masa të tjera për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe ose të dëmshme, sipas legjislacionit në fuqi.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF), kur konstaton se në rrjetet kompjuterike ose ato të informacionit, në faqet e internetit apo në mjedise ku ka fëmijë, qarkullojnë materiale me përmbajtje të dëmshme për fëmijën, i kërkon autoritetit përgjegjës të marrë masat për bllokimin e aksesit në këto rrjete ose faqe. Për periudhën Janar – Nëntor 2023, ASHDMF ka raportuar në portalin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), 59 faqe me përmbajtje të dëmshme dhe të ndaluara për fëmijët.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 synon të krijojë një mjedis të favorshëm për mirëqenien e fëmijëve nëpërmjet aksesit në shërbime cilësore, praktikave pozitive të pjesëmarrjes, prindërimit të mirë, eliminimit të çdo forme dhune dhe të zhvillimit në botën digjitale.

Strategjia e re Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe plani i saj i veprimit 2020–2025, përmbajnë një kapitull të dedikuar për fëmijët, i cili përfshin nënobjektiva dhe aktivitete të dedikuara për rritjen e nivelit të sigurisë së fëmijëve në internet. Kjo paraqet vetëm hapin e parë drejt vendosjes së zbatimit efektiv të ligjit në lidhje me fëmijët. Mbi gjithçka, qëndron si domosdoshmëri forcimi i kapaciteteve për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të kryera kundër fëmijëve në internet. Strategjia monitorohet nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) dhe rezultatet e saj raportohen në Grupin Ndërinstitucional të Punës së Digjitalizimit.

Me qëllim përmirësimit e bashkëpunimit institucional, lidhur me sfidat e përditshme për t'i mbajtur fëmijët të sigurt në internet, ASHDMF ka qenë në bashkëpunim me institucionet, shkollat, fëmijët,

punonjësit e vijës së pare, etj., në realizimin e takimeve informuese dhe ndërgjegjësuere për internetin e sigurt.

Në bashkëpunim me AKCESK janë realizuar takime me profesionistë duke përfshirë prokurorinë dhe policinë lidhur me ndëshkimin e rasteve të abuzimit online. Në këto takime morën pjesë 76 profesionistë. Janë organizuar trajnime dhe takime për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet për fëmijët në mjedisin kibernetik. Morën pjesë rreth 210 fëmijë dhe 70 profesionistë.

Përmbajtjet e paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet për fëmijët mund të raportohen tashmë në një aplikacion të ri që është mundësuar nga AKCESK, i cili është i aksesueshëm për çdo profesionist, institucion, fëmijë, prind, qytetar. ASHMDF është përdorues i këtij portali dhe sigurohet që çdo rast i referuar të ndiqet nga institucionet përkatëse për t'i ardhur në ndihmë çdo fëmije, që ai të ndihet i mbrojtur dhe i sigurt në mjedisin digital. <https://cesk.gov.al>

Në harmoni me Direktivën e ndryshuar të BE-së 2018/1808, në maj 2023, në Shqipëri hynë në fuqi ndryshime të rëndësishme në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Këto ndryshime forcuan më tej kompetencat e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), duke rritur rolin e saj në inkurajimin e aktorëve dhe transmetuesve drejt edukimit mediatic.

Për t'u mundësuar qytetarëve shqiptarë të aksesojnë informacionin dhe të përdorin, të vlerësojnë në mënyrë kritike dhe të krijojnë përmbajtje mediatiche në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt, ata duhet të zotërojnë aftësi të avancuara të shkrim-leximit mediatic. Njohuria mediatiche nuk duhet të kufizohet në të mësuarit rreth mjeteve dhe teknologjive, por duhet të synojë t'i pajisë qytetarët me aftësitë e të menduarit kritik që kërkohen për të ushtruar gjykimin, për të analizuar realitetet komplekse dhe për të njohur dallimin midis opinionit dhe faktit. Nisur nga nevoja që, si ofruesit e shërbimeve mediatiche, ashtu edhe ofruesit e platformave të ndarjes së videove, në bashkëpunim me të gjithë aktorët përkatës, të promovojnë zhvillimin e edukimit mediatic në të gjitha shtresat e shoqërisë, AMA, nëpërmjet financimit të projekteve nga një organizatë e shoqërisë civile partnere, ka zhvilluar aktivitetet e mëposhtme në mbështetje të edukimit mediatic gjatë periudhës 2023:

- Organizoi fushata avokuese në mediat sociale dhe debate publike, se si të luftohet dezinformimi dhe teoritë e konspiracionit.
- Një sërë programesh trajnimi u janë ofruar gazetarëve të rinj dhe studentëve të gazetarisë lidhur me aftësitë dhe mjetet e nevojshme për të kuptuar dhe luftuar dezinformimin.
- Organizatat mediatiche të mbështetura nga AMA kanë realizuar studime monitoruese për lajmet e rreme, dezinformatat dhe konspiracionet në media gjatë pandemisë dhe rolin e edukimit mediatic.
- Janë përkthyer dhe botuar një sërë librash mbi lajmet e rreme, dezinformimin, propagandën, etj., të mbështetur nga AMA, duke plotësuar një boshllëk të mëparshëm në këtë fushë.
- Janë publikuar pamflete nga AMA mbi përmbajtjen e transmetuar të përshtatshme për zhvillimin e fëmijëve.

Gjithashtu, më datë 10 korrik 2023, Kodi i ri i Transmetimit u miratua me Vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023. Kodi përmban 11 seksione, krahasuar me 8 seksione të Kodit të mëparshëm, nga të cilët një pjesë i dedikohet posaçërisht rregullimit të imazhit të transmetuar të fëmijës në mediat audiovizive. Konkretisht, Seksioni 4 i Kodit (Fëmijët në Transmetimet Audio dhe Audiovizive – me nënseksione: Media që i shërben interesit më të mirë të fëmijës, Ndalimi i identifikimit të fëmijës, Intervistimi i fëmijës, Reklamati dhe fëmijët, Programet kulturore, argëtuese, edukative, filmat dhe fëmijët, Shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve në programet audio dhe audiovizive), rregullon në detaje rastet kur, një fëmijë është pjesë e një përmbajtjeje audio ose audiovizive të

transmetuar, ose kur kjo përmbajtje nuk është e përshtatshme për zhvillimin fizik, mendor dhe moral të fëmijës. Seksioni me fokus fëmijët u rishikua për të përditësuar Kodin me standardet më të larta të mbrojtjes së fëmijëve, por edhe për të trajtuar mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës në të gjitha llojet e transmetimeve.

Për sa i takon pjesëmarrjes së fëmijëve, tashmë është një realitet konkret, që është përfshirë edhe në angazhimin e institucioneve shtetërore gjatë proceseve për hartimin e ligjeve e politikave të reja për çështjet e të drejtave të fëmijëve. Fëmijet janë konsultuar gjatë hartimit të Ligjit “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” si dhe për hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës.

Ligji nr.18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, ka në themel të tij parimin e pjesëmarrjes së fëmijës dhe e përkufizon atë si një proces të vazhdueshëm të përfshirjes aktive të fëmijës dhe të respektimit të së drejtës së tij për t’u shprehur e për t’u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendim-marrjes për çështje që lidhen me të. Në disa nene të këtij ligji është përcaktuar e drejta për pjesëmarrje, si p.sh:

- Neni 12 i këtij ligji sanksionon lirinë e shprehjes së fëmijës. Fëmija ka të drejtë të shprehë lirisht, individualisht dhe kolektivisht pikëpamjet dhe mendimin e tij për çdo çështje që ka të bëjë me të drejtpërsëdrejti osë me familjen e tij apo komunitetin, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
- Neni 13 garanton të drejtën e fëmijës për t’u dëgjuar vetë osë nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit jo vetëm në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të, por edhe nga autoritetet shtetërore gjatë proceseve vendim-marrëse që lidhen me hartimin e zbatimin e politikave për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.
- Neni 5 pika 10, përcakton se pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, duhet bërë në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

Dëgjimi i fëmijëve dhe lejimi i tyre për të kontribuar në këto procese, çojnë në vendime më të mira, në politika që janë në të vërtetë, jo vetëm teorikisht, në interes të fëmijëve. Gjatë procesit të hartimit të raportit të monitorimit të Agjendës, pjesë e procesit ka qenë edhe konsultimi me fëmijët në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të Agjendës. Gjatë këtij procesi janë përfshirë rreth 120 fëmijë nga grupmosha 11-17 vjeç të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme nga rajone të ndryshme të Shqipërisë, si: bashkia Sarandë, Pukë, Kamëz, Tiranë, Elbasan, me qëllim që fëmijëve t’u mundësohet njohja më e mirë e dokumentit strategjik, por njëkohësisht ata kontribuuan duke dhënë mendimet e tyre mbi situatën aktuale, zbatueshmërinë e tyre dhe çfarë duhet bërë për realizimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Në nëntor 2023 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, organizuan mbledhjen e rradhës së Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve për prezantimin e raportit të monitorimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2021-2026.

Pjesëmarrës në Këshill ishin dhe fëmijët, të cilët shprehen vlerësimet dhe mendimet e tyre për aspekte të ndryshme të jetës, bazuar në 4 objektivat kryesore që lidhen me realizimin e të drejtave të fëmijëve. Shprehja e pikepamjeve të fëmijëve mbi realizimin e Agjendës Kombëtare të Drejtave të Fëmijëve 2021-2026 është kontributi më i mirë në përmirësimin e politikave gjithëpërfshirëse për çdo fëmijë.

Nisma ARSIS në kuadër të kësaj mase është angazhuar në sesione sensibilizuese me fokus informimin e fëmijëve për faktorët që rrezikojnë të miturit përballë fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore në grupet më vulnerabel përfshirë Bashkitë Tiranë, Kamzë, Krujë, Elbasan, Durrës dhe Shkodër. Ekipi Nisma-ARSIS ka vënë në pah situatën aktuale të fëmijëve të privuar nga të drejtat elementare, të

kërcënuar, të shfrytëzuar dhe punën që mund të bëhet për t'i ndihmuar ata. Në të njëjtën kohë në dy qendra komunitare në Bashkinë e Tiranës dhe në bashkëpunim me qendrat e tjera komunitare publike në Tiranë është angazhuar në zhvillimin e aktiviteteve me fëmijët nga grupet më vulnerabël të fokusuar vetëm në sigurinë, pjesëmarrjen, mbështetjen e shëndetit mendor, parandalimin e martesave të hershme. ndërgjegjësimi për rreziqet e shfrytëzimit dhe trafikimit.

Në kuadër të ndërgjegjësit të fëmijëve, gjatë vitit 2023, Qendra Vatra prodhoi broshurën "Trafikimi dhe shfrytëzimi online i fëmijëve" e cila u shpërnda në 1000 kopje në takimet informuese të zhvilluara me të rinjtë në shkolla dhe stafin e shkollave, me qëllim informimin e të rinjve të shkollave lidhur me rrezikun e trafikimit online dhe parandalimin e tij. Broshura është publikuar në faqen e internetit të Vatrës: http://www.qendravatra.org.al/previewdoc.php?file_id=763

WVA Albania informon se, gjatë periudhës raportuese:

- 1600 fëmijë dhe të rinj janë arritur përmes fushatës ndërgjegjëse për muajin Antitrafik dhe 20 Nëntorin Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve në Bashkinë e Durrësit.
- 1154 fëmijë dhe të rinj arritën përmes fushatës ndërgjegjëse për muajin Antitrafik dhe 20 Nëntorin Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve dhe Ditën e Internetit të Sigurt në Bashkinë e Shkodrës.
- 180 fëmijë u arritën përmes aktiviteteve sensibilizuese për mbrojtjen e fëmijëve, të organizuara në bashkëpunim me 3 shkolla në Kurbin në kuadër të projektit Përmirësimi i Qëndrueshmërisë Komunitare.
- 76727 fëmijë, të rinj dhe të rritur janë arritur përmes pjesëmarrjes masive në aktivitetet e organizuara për ditët e mëdha, siç është (20 Nëntori), Muaji Antitrafik (çdo tetor), Dita e Internetit të Sigurt dhe orientimet e kryera mbi informacionin mbi mekanizmin e raportimit të rasteve për stafin e shkollave, bashkitë Tiranë dhe Kamëz.
- Janë organizuar disa fushata kombëtare të World Vision Albania si: 1Goal4Impact, Sport4All, SayitDigital, ITAW. Duhet një botë për t'i dhënë fund dhunës ndaj fëmijëve dhe së fundmi fushata Jo Uria, kanë kontribuar në fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve dhe kanë përforcuar zërin e fëmijëve për të drejtat e tyre.

c. putting in place a system for monitoring and reporting cases of abuse;

Detyrimi për raportim i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë ata në rrezik, parashikohet në mënyrë të detyrueshme për të gjithë punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët, pavarësisht përcaktimeve ligjore, të cilat ndodhen për disa kategori në akte të tjera ligjore. Parashikimi në ligjin 18/2017 i detyrimit për raportim, vjen me detajimin se ku duhet të raportojnë punonjësit që punojnë me fëmijët, duke përfshirë, përveç strukturave hierarkike institucionale, edhe raportimin tek strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

Në zbatim të nenit 67 të ligjit 18/2017 "Detyrimi për raportim", çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijët për shkak të profesionit dhe ka dyshim se një fëmijë abuzohet, neglizhohet, keqtrajtohet apo ndodhet në rrezik për diçka të tillë, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor. Mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social shkollor kanë për detyrë të raportojnë çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në njësitë arsimore vendore ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës. Njësia arsimore vendore, në çdo rast, kur merr dijeni për fëmijë në nevojë për mbrojtje, bën raportimin tek strukturat për mbrojtjen e fëmijës. Punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private, kanë për detyrë të raportojnë

menjëherë te drejtori i institucionit, organet e Policisë së Shtetit, strukturat për mbrojtjen e fëmijës çdo rast të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit, braktisjes, neglizhimit apo dhunës tek fëmijët.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes” është përcaktuar në nenin 12 “Monitorimi i Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës (PMF) për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes”

1. Drejtuesi i NJMF-së është përgjegjës për monitorimin e punës së PMF-së, në lidhje me zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes (PIM-it), përfshirë PMF-në pranë NJMF-së apo PMF-në pranë njësisë administrative.
2. Drejtuesi i NJMF-së, i mbështetur nga PMF-ja përgjegjëse për ecurinë e PIM-it, realizon vizita monitoruese për të verifikuar situatën e fëmijës dhe të familjes së tij, me qëllim verifikimin e progresit në zbatimin e PIM-it.

Pas miratimit të ligjit 18/2017 për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe strukturat e lidhura me të mbulojnë të gjithë territorin e vendit duke vendosur struktura në çdo njësi vendore, me punonjës për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe duke funksionalizuar Grupin Teknik Ndërsektorial (GTN) në nivel bashkie. GTN ka autoritetin të merret me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik të lartë abuzimi dhe në rrezik të mundshëm trafikimi.

Lidhur me raportimin e rasteve, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Sociale (ISSHSSH) ka ngritur një sistem për raportimin e ankesave (*info @sli.gov.al*), i cili gjendet në faqen e internetit të ISSHSSH.

Gjithashtu, Linja telefonike e fëmijëve-Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ofron një linjë telefonike pa pagesë, me numër të publikuar gjerësisht, e cila është e detyruar të verifikojë dhe t'i referohet njësive të mbrojtjes.

ALO 116 - 111 Linja Kombëtare për Fëmijë në Shqipëri, funksionon 24 orë në 7 ditë në javë dhe çdo ditë të vitit.

Linja Kombëtare për viktimat e trafikimit në Shqipëri -116 006 është funksionale 24 orë në 7 ditë në javë dhe çdo ditë të vitit.

Nr.112 ose 129 të Policisë së Shtetit është i disponueshëm për çdo rast emergjence.

- d. providing training to child care professionals, legal guardians, education professionals;

Në vitin 2023, ASHDMF ka realizuar trajnime me rreth 80 PMF të rinj në detyre në 17 bashki. Takime në nivel vendor në lidhje me identifikimin dhe raportimin e rasteve të fëmijëve të dhunuar, abuzuar, shfrytëzuar ekonomikisht, të trafikuar dhe neglizhuar me profesionistë të fushës së shëndetësisë, arsimit, policisë, punonjës të mbrojtjes së fëmijëve. Në total kanë marrë pjesë 80 profesionistë.

Gjatë periudhës raportuese, ASHMDF ka organizuar trajnime dhe takime koordinuese me qëllim parandalimin e kriminalitetit dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin, ku kanë marrë pjesë rreth 350 profesionistë si dhe 220 oficerë sigurie.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Autoritetin Përgjegjës, në gjashtëmujorin e parë të 2023, kanë realizuar takime në bashkitë Kukës, Dibër dhe Shkodër me

punonjësit e Njërive të Mbrojtjes së Fëmijëve si dhe me aktorë vendorë përfaqësues të Grupit Teknik Ndërsektorial. Qëllimi i takimeve ishte diskutimi nga afër dhe nxitja e bashkëpunimit në nivel vendor me punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, specialistët e trafikeve dhe me aktorë të tjerë lokalë, të cilët janë pjesë e Grupit Teknik Ndërsektorial mbi ecurinë e menaxhimit të rasteve të fëmijëve VT/VMT dhe adresimin e problematikave të hasura në këtë drejtim.

Gjatë periudhës së zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023, nga organizata Key Adviser janë trajnuar 335 punonjës të institucioneve publike në bashkitë Tiranë, Elbasan, Vlorë, Kukës, Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Mat, Klos, Bulqizë dhe Dibër. Konkretisht, këto punonjës kanë marrë pjesë në trajnimet me temat: “Ndërtimi i soft skills dhe aftësive jetësore për integrimin social dhe ekonomik të viktimave të mundshme të trafikimit, viktimave të trafikimit dhe personave në rrezik”, “Procedurat standarde të veprimit për referimin, trajtimin dhe mbështetjen psiko-sociale për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit”.

Gjithashtu, është punuar mbi trajnimin e punonjësve të institucioneve arsimore parauniversitare lidhur me temat e trafikimit. Përveç rritjes së numrit të punonjësve të shërbimit psiko-social në shkolla, është rritur edhe cilësia e shërbimit përmes trajnimeve të ofruara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). Nga ASCAP janë trajnuar punonjës të shërbimit psiko-social shkollor, mbi sigurinë, mbrojtjen, identifikimin dhe referimin e rasteve në rrezik trafikimi si dhe janë realizuar seanca informuese/ndërgjegjësuere me stafet e shkollave. Gjithashtu, trajnime janë zhvilluar edhe me mësuesit e lëndës qytetari.

Në muajt janar-shkurt-mars 2023 Nisma ARSIS, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, mbështetur financiarisht nga Ambasada Amerikane në Shqipëri, zhvilluan trajnime me 75 profesionistë të sigurisë në zonat Tiranë, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Fier, Berat, Lushnje, Tepelenë, Përmet, Gjirokastrë, Sarandë, Libohovë, Kelcyrë, Shkodër, Lezhë, Malësi e Madhe, Fushë Arrëz, Pukë, Kurbin. Qëllimi i trajnimit ishte: Zhvillimi i kapaciteteve të autoriteteve kombëtare, rajonale dhe vendore për të identifikuar dhe mbështetur fëmijët në rrezik të dhunës, abuzimit, neglizhencës dhe shfrytëzimit, duke përfshirë objektivat e barazisë gjinore dhe njohja me procedurat e ndërhyrjes që përfshijnë menaxhimin e rastit, identifikimin/referimin, vlerësimin fillestar, vlerësimin e plotë, hartimin e planit të mbrojtjes individuale, zbatimin e planit dhe monitorimin e rastit për kategoritë më vulnerabel në rrezik trafikimi, përfshirë fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët e huaj të pashoqëruar në Shqipëri, etj.

- e. access to education and health care for vulnerable children, including from minority groups, unaccompanied migrant children, and children of migrant workers;

Neni 18 i ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” parashikon:

“1. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe ndjekjes së arsimit falas dhe cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si autoriteti publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete për:

f) ndërmarrjen e veprimeve konkrete për të garantuar të drejtën për arsimim të fëmijëve që i përkasin një grupi ose rajonesh me boshllëqe të konsiderueshme arsimore, ose që përballen me situata vulnerabiliteti për shkak të situatës së vështirë social-ekonomike ose gjendjes së veçantë fizike ose mendore, ose për shkak të aspekteve që lidhen me gjininë, besimet fetare ose praktikat kulturore, ose që janë pjesë e një grupi kulturor ose etnik, ose vijnë nga një situatë migrimi.”

Neni 21 i ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” parashikon:

“1. Fëmijës i garantohet e drejta për kujdes shëndetësor falas dhe standardi më i lartë i arritshëm dhe e drejta për lehtësira për trajtimin e sëmundjeve dhe rehabilitimin e shëndetit. Kjo e drejtë nuk mund të kufizohet pavarësisht nëse fëmija është i regjistruar në gjendjen civile dhe nëse prindërit e fëmijës kanë paguar taksa.”

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) siguron mbështetje për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit për regjistrimin në arsimimin me kohë të plotë apo kohë të pjesshme dhe pajisjen me tekste shkollore falas. Për arsimimin e fëmijëve/nxënësve me shtetësi të huaj, përfshirë edhe shtetas të Bashkimit Evropian, legjislacioni përkatës është i plotë dhe siguron arsimimin e tyre pa diskriminim.

Udhëzimi nr. 10, datë 17.05.2021, “Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore parauniversitare publike të fëmijëve të personave në situatë migrimi/azili, refugjatësh, fëmijëve të huaj të pashoqëruar, fëmijëve të kthyer nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijëve viktimat e trafikimit në Republikën e Shqipërisë” lehtëson procedurat e pranimit dhe të ndjekjes së arsimit për të gjitha kategoritë e përfshira në të.

Për nxënësit me shtetësi të huaj, institucionet arsimore publike sigurojnë ekuivalentimin e dokumenteve shkollore të nxënësve që vijnë, vlerësimin e njohurive në rast të mungesës së dokumentacionit shkollor, trajtimin me plan arsimor individual, mësimin falas të gjuhës shqipe dhe regjistrimin e tyre në arsimin parauniversitar në çdo periudhë të vitit.

Për fëmijët me shtetësi të huaj të regjistruar në shkollë, institucioni arsimor publik harton një plan veprimi, ku aktivitetet kryesore janë: trajtim special psiko-social nga psikologu i shkollës; punë e diferencuar nga çdo mësues, për të përshtatur lëndën me nivelin e gjuhës shqipe që zotëron.; orë shtesë për mësimin e gjuhës shqipe me mësuesin e gjuhës shqipe në shkollë; përfshirja e tyre në aktivitete shkollore që ndihmojnë në mësimin e gjuhës shqipe dhe integrimin e tyre.

Në kuadër të parandalimit, në institucionet arsimore parauniversitare (IAP) zhvillohen aktivitete informuese dhe edukuese në lidhje me fenomenin e trafikimit, efektet e tij negative, mënyrat e parandalimit dhe raportimit dhe rëndësinë e përdorimit të internetit në mënyrë të sigurt nga nxënësit. Lidhur me këtë, çdo vit shkollor zhvillohen takime informuese dhe ndërgjegjësuese me nxënësit për sensibilizimin mbi konceptin e trafikimit, llojet e trafikimit të qenieve njerëzore, shkaqet pse ndodh trafikimi, ndalimi me ligj i trafikimit të qenieve njerëzore etj.

Janë realizuar veprimtari me prindër, si: takime individuale dhe në grup me prindër të fëmijëve me probleme të sjelljes dhe të disiplinës; përfshirja e prindërve në planet e ndërhyrjes për nxënësit me probleme të sjelljes; njohja e elementeve të kodit penal për të mitur dhe përgjegjësia penale. Nga ana e shërbimit psiko-social në shkolla (SHPS) janë zhvilluar seminare dhe aktivitete me nxënës me qëllim rritjen e nivelit të njohurive të tyre për çështjet e trafikimit.

Gjithashtu, evidentimi i sjelljeve të dhunshme, informimi i fëmijëve rreth fenomenit të trafikimit, evidentimi i viktimave të mundshme të trafikimit, njohja me institucionet e mbrojtjes kundër dhunës dhe trafikimit në vendin tonë, realizimi i hartës sociale të shkollës ka qenë fokusi i punës së punonjësve të SHPS-së. Bashkëpunëtorë në këto veprimtari ishin: mësuesit koordinatorë të senatit, përfaqësuesit nga drejtorja e policisë, përfaqësuesit nga drejtorja e shëndetit publik, përfaqësues nga OJF të ndryshme, si dhe oficerët e sigurisë në institucionet arsimore. Në kuadër të muajit Antitrafik me nxënësit e IAP realizohen aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe organizata të ndryshme.

Për sa i takon kuadrit ligjor për viktimat e trafikimit brenda fushës së përgjegjësisë së MAS mbështetet tek udhëzimi nr. 10, datë 17.5.2021, “Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet e arsimit

parauniversitar publik të fëmijëve të personave në situatë migrimi/azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijë viktime të trafikimit, në Republikën e Shqipërisë”. Ky udhëzim ka të përcaktuar në kreun IV se si realizohet arsimimi i fëmijëve, viktime të trafikimit dhe, konkretisht si vijon:

1. Fëmijëve, viktime të trafikimit në moshën e detyrimit shkollor (6–16 vjeç), u sigurohen kushtet për ndjekjen e arsimit parauniversitar. ZVAP-ja, në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, përcaktojnë institucionet arsimore parauniversitare publike ku ata do të regjistrohen.
2. Fëmijët, viktime të trafikimit, që nuk provojnë me dokument zyrtar përfundimin apo vazhdimin e një klase, provohen për shkallën e njohurive me testim nga një komision ndërlëndor të përbërë nga mësues dhe nga punonjësi i shërbimit psikosocial, që ngrihet në institucionin arsimor parauniversitar, përcaktuar nga ZVAP-ja. Komisioni vlerëson dhe cakton klasën ku nxënësit i përket të regjistrohet.
3. Punonjësi i shërbimit psikosocial në institucionin arsimor parauniversitar publik harton një plan të veçantë pune për mbështetjen, trajtimin dhe integrimin në shkollë të fëmijëve viktimeve të trafikimit.
4. Institucioni arsimor parauniversitar publik siguron tekstet shkollore për fëmijët viktime të trafikimit që ndjekin arsimin parauniversitar.

Vendimi nr. 903, datë 21.12.2016, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” i ndryshuar, ku në pikën 5, gërma f, parashikohet se: “studentët që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç”, konsiderohen studentë në nevojë.

Në zbatim të vendimeve nr. 486, datë 17.6.2020 “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar” i ndryshuar dhe nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, i ndryshuar, nxënësit viktime/viktima të mundshme të trafikimit përfitojnë tekste shkollore falas dhe bursa në arsimin parauniversitar.

Për sa i përket aksesit në kujdesin shëndetësor, Nisma ARSIS ka luajtur një rol vendimtar në ofrimin e shërbimeve të nevojshme të kujdesit shëndetësor për fëmijët e pashoqëruar, veçanërisht në situata emergjente. Ndërmjet viteve 2022 dhe 2023, Shqipëria dëshmoi 42 raste të të miturve të pashoqëruar që përdornin vendin si pikë tranziti. Pavarësisht sfidave, janë bërë përpjekje për të adresuar nevojat e tyre të kujdesit shëndetësor, edhe pse shpesh në rrethana emergjente.

- f. birth registration for all children born in the country.

Neni 8 i ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” parashikon:

“1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija ka të drejtë: a) të regjistrohet menjëherë pas lindjes, pa asnjë tarifë. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të prindit ose të kujdestarit ligjor, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.”

Bazuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, për periudhën 2019-2023 janë regjistruar këto lindje, si më poshtë:

Viti	Numri i lindjeve
2019	28.790
2020	27.403
2021	27.405
2022	24.883
2023	23.754
Totali	132.235

Megjithatë ekzistojnë disa sfida në lidhje me regjistrimin e individëve në gjendjen civile. Nga përvoja praktike, Ekipi i Nisma ARSIS ka identifikuar disa çështje kryesore:

- Vështirësi në regjistrimin e individëve të lindur jashtë vendit në regjistrin kombëtar shqiptar, veçanërisht kur nuk kanë një adresë fikse banimi në vendin e tyre të lindjes. Kjo pengesë lind për shkak të masave të detyrueshme të aplikimit online të zbatuara nga e-albania dhe zyrat e gjendjes civile. Pavarësisht posedimit të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm të lindjes, mosdhënia e një adrese fikse në vendin e lindjes e bën regjistrimin të pamundur.

3. What measures are taken in your country to address vulnerabilities related to the gender dimension of human trafficking?

Në rastin e një viktime veçanërisht të cenueshme, ligji shqiptar parashikon një dënim më të lartë kur viktima është femër. Kështu, neni 110/a, paragrafi.2 i Kodit Penal parashikon:

“Kur një vepër e tillë kryhet ndaj një personi madhor femër, dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”

Gjithashtu, Planet Kombëtare të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018-2020 dhe 2021-2023 parashikojnë masa dhe aktivitete konkrete për fëmijët, gratë dhe vajzat, grupet nga komuniteti rom dhe egjiptian, etj., me qëllim mbrojtjen e tyre, mbështetje për punësim, këshillim, formim profesional, etj.

Programet që synojnë të nxisin punësimin e punëtorëve në një vend, marrin në konsideratë edhe dimensionin gjinor, duke synuar fuqizimin dhe punësimin e grave. Ata marrin parasysh edhe personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e tjera vulnerabël sipas ligjit 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar. Këto programe synojnë punësimin dhe vetëpunësimin nëpërmjet pjesëmarrjes në programet e nxitjes së punësimit dhe trajnimeve në punë dhe praktikave profesionale.

Programet kryesore përcaktohen në akte nënligjore, si:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 15.1.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, i ndryshuar;

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 29.4.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat e zbatimit të programit të stimulimit nëpërmjet vetëpunësimit”, i ndryshuar;

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 05.10.2022 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat e zbatimit të programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruara, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet profesionale formale, publike ose private".

Në përzgjedhjen e subjekteve për inspektim, Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) vepron mbi bazën e një analize risku, ku tregues risku janë edhe sektorët apo subjektet ku punësohen të mitur, gra dhe të huaj. ISHPSHSH realizon fushata sensibilizuese për zbatimin e të drejtave të punonjësve, me fokus gratë, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, të cilët gëzojnë mbrojtje të veçantë në legjislacionin e punës. Inspektori i punës informon dhe këshillon subjektet për zbatimin e legjislacionit të punës, për të gjithë punonjësit pa diskriminim. Gjithashtu, është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet ISHPSHSH dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të luftuar diskriminimin në vendin e punës.

Që nga viti 2019, UNICEF Shqipëri, me financim nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar në kuadër të Fondit të Skllavërisë Moderne, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme po zbaton programin "Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria" në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e saj zbatues. Që nga fillimi i tij, Programi ka synuar të përmirësojë realizimin e të drejtave të njeriut të grupeve më vulnerabël të popullsisë në Shqipëri, në përputhje me parimin e mosdiskriminimit. Të gjitha aktivitetet kryhen me synimin për të garantuar interesin më të lartë të fëmijës, mosdiskriminimin dhe ndjeshmërinë gjinore, si dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në çdo proces vendimmarrjeje. Është evidente që ndjeshmëria gjinore është integruar në aktivitetet dhe ndërhyrjet e planifikuara, me qëllim promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave që janë përfituese të Programit.

4. What specific measures are taken to reduce the vulnerability to trafficking of persons from disadvantaged minorities? Please provide information on policies and measures in the following areas:

a. research;

Një kontribut tjetër i rëndësishëm i programit "Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria" është publikimi i studimeve kërkimore mbi tema të ndryshme të trafikimit, të cilat përmirësojnë kërkimin në vend dhe më gjerë. Një burim i mirë informacioni mbi rezultatet e programit mund të gjeni në: <https://endhumantrafficking.al/>

Publikimet kërkimore të ndërmarra nga programi janë renditur si më poshtë:

- 1- Studim vëzhgues i valës së parë mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, në katër rajone në Shqipëri: <https://www.unicef.org/albania/documents/first-wave-survey-study-youth-knowledge-attitudes-and-practices-regard-human-trafficking>
- 2- 'Trafikuar nga dikush që njoh'- Një studim cilësor i marrëdhënieve midis viktimave të trafikimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore në Shqipëri: <https://www.unicef.org/albania/reports/trafficked-someone-i-know>
- 3- 'Riintegrimi ekonomik i të mbijetuarve të trafikimit në Shqipëri': <https://www.unicef.org/albania/reports/economic-reintegration-trafficking-survivors-albania>
- 4- 'Anketim mbi njohuritë, qëndrimet & praktikat e të rinjve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në 4 rajone të Shqipërisë' - Vala e Dytë, Anketa mbi njohuritë, qëndrimet & praktikat e të rinjve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në 4 rajone të Shqipërisë:

<https://www.unicef.org/albania/reports/survey-youth-knowledge-attitudes-practices-regarding-human-trafficking-4-regions-albania>

- 5- ‘Vlerësimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2022’ - Vlerësimi i Programit për Transformimin e Reagimit Kombëtar ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria, 2019–2022 Raporti kryesor dhe Shtojcat e Raportit: <https://www.unicef.org/albania/reports/2022-human-trafficking-evaluation>

Në maj 2022, World Vision Albania lançoi për herë të parë në Shqipëri studimin “Gra të fuqizuara, fëmijë të fuqizuar” i cili analizon marrëdhënien që ekziston mes fuqizimit të nënës dhe fuqizimit/përmirësimit të jetës së fëmijës. Studimi synon të mbështesë me të dhëna lidhjen mes fuqizimit të gruas dhe mirëqëniens së fëmijës. Të dhënat e këtij studimi japin pamjen vetëm për 8 zona të Shqipërisë (Dibër, Durrës, Korçë, Kurbin, Lezhë, Librazhd, Shkodër, Tiranë) dhe nuk janë ezauruese për të gjithë dimensionet e binomit nënë-fëmijë. Studimi shërben si bazë për ndërhyrje të mirëinformuara në këtë sektor. <https://www.wvi.org/publications/report/albania/empowered-women-empowered-children>

b. information, awareness-raising and education campaigns;

Programi “Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria” ka trajtuar rregullisht parimet e mbrojtjes, ndjekjes dhe parandalimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit në të gjithë komponentët e tij kryesorë, ndërkohë që ka zhvilluar dhe ofruar një fushatë të shëndoshë komunikimi strategjik në nivel kombëtar, rajonal, lokal dhe komunitar që ka rezultuar në arritjen e rreth 2,3 milionë reagime dhe aplikacione në internet, si dhe 17,500 individë ballë për ballë.

Në zbatim të Programit, janë ngritur dhe funksionojnë 4 Njësi Lëvizëse (Kukës, Shkodër, Dibër dhe Tiranë). 8 Njësitë Lëvizëse Vlorë, Durrës, Berat, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Pogradec, Korçë mbështeten nga programi i granteve të vogla të financuara nga Ambasada e SHBA. Gjithashtu “Vatra” me mbështetjen e IRC-së, Serbia ka krijuar një Njësi tjetër Lëvizëse në Shëngjin/Lezhë për të punuar me migrantët afganë për t’i informuar ata përmes sesioneve informuese me gra, vajza, burra dhe djem në lidhje me çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore dhe gjithashtu ka punuar në identifikimin e viktimat të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore mes migrantëve.

Në të gjitha bashkitë ku operojnë Njësitë Lëvizëse (NJL), përveç identifikimit të VT/VMT, organizohen edhe sesione informuese me komunitetin, me të rinjtë në shkollat e mesme dhe 9-vjeçare, si dhe fokus grupe me përfaqësues të shëndetësisë, arsimit, punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, shërbimeve sociale në bashki dhe shërbimeve sociale shtetërore. Kryesisht, NJL punuan në zona që njihen për popullsinë e tyre nga komunitetet rome dhe egjiptiane.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2022, Njësitë Lëvizëse Shkodër dhe Tiranë kanë kontaktuar me 64 institucione dhe individë, përfaqësues të institucioneve. Qëllimi i kontakteve me institucionet dhe me individët ka qenë marrja e informacionit për rastet vulnerabël për trafikim dhe prezantimi i aktivitetit të NJL-së. Gjithashtu, në këto takime në terren është prezantuar edhe shërbimi që D&E ofron për viktimat e trafikimit. Kontaktet janë zhvilluar me individë që kanë njohje në zonë, me administratorët socialë dhe infermierët e zonave përkatëse, psikologët e shkollave edhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve.

Gjatë kësaj periudhe janë takuar familje të referuara nga ndërlidhësit në komunitet, në zona të ndryshme të dy qarqeve. Gjithashtu janë bërë vizita në familje, janë mbledhur informacione dhe janë bërë vëzhgime mbi situatën e familjeve dhe nevojën për mbrojtje/ shërbime. Janë kontaktuar gjithsej

92 individë të rritur dhe minorenë. Puna në terren ka përfshirë zona të caktuara, të identifikuar nga NJL Tiranë dhe Shkodër si zona ku ka problematika të fëmijëve në situatë rruge, duke lypur, etj.

c. socio-economic initiatives targeting underlying and structural causes;

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Fondit Social, ka ofruar mbështetje financiare për bashkitë, qendrën e emergjencës dhe qendrat komunitare multifunksionale. Që nga viti 2019, Fondi Social ka mbështetur 54 shërbime sociale për të gjithë grupet sociale, përfshirë komunitetet rome edhe egjiptiane.

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve miratuar me Vendim Nr. 701, datë 18.12.2021 përmban Objektivin specifik 3. Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe egjiptianëve në rrezik trafikimi/shfrytëzimi si dhe referimi, mbrojtja dhe riintegrimi i rasteve të trafikuar/ shfrytëzuara është trajtuar nga ekipet multidisiplinare në nivel vendor. Ky plan përcakton prioritetet në fusha si aksesimi në drejtësi, arsimit dhe kulturës, punësimi, strehimi, mbrojtja sociale dhe anti-xhipsizmit, duke respektuar parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Në Prill 2022 u organizua Seminari i Pestë të Dialogut Politik Shqipëri-BE, me qëllim zbatimin dhe promovimin e masave për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve. Rekomandimet e Seminarit të Pestë të Dialogut Shqipëri- BE do të ndiqen në vijimësi për të gjitha fushat, duke përfshirë Arsimin dhe Anti-xhipsizmin, Punësimin dhe Formimin Profesional, Aksesin në Shëndetësi dhe Mbrojtje Sociale; Strehimi social; Regjistrimit civil si dhe të kthyerit dhe emigrantët në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe shoqërinë civile.

Ekzistojnë modele pozitive të planeve lokale të veprimit lokal të dedikuara për komunitetin rom/egjiptian, me mbështetjen e KiE, të miratuara nga këshillat bashkiakë që trajtojnë përfshirjen sociale të romëve. Familjet rome dhe egjiptiane janë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike (2700 familje rome dhe egjiptiane). Për këto familje, qasja e shërbimeve sociale të integruara dhe punësimi dhe formimit profesional është dalja nga ndihma ekonomike, formimi profesional, punësimi dhe mentorimi për t'u integruar në tregun e punës.

Më datë 15.02.2023 është nënshkruar Urdhri i përbashkët nr. 85, i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për mekanizmin e referimit për punësim dhe integrim social të individëve në moshë aktive pune”. Bazuar në këtë urdhrë, Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) referon për punësim në sistemin e Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (AKPA), anëtarë të cilët janë pjesë e sistemit të Ndihmës Ekonomike, ku përfshihen edhe viktimat e trafikimit. Janë referuar 10 raste të cilat janë pjesë e sistemit të Ndihmës Ekonomike që synojnë punësimin dhe përfshirjen sociale për t'u integruar në komunitet.

Nisma ARSIS ofron paketat e plota të shërbimeve në kuadër të procesit të menaxhimit të rasteve, duke përfshirë por jo vetëm mbështetjen e drejtpërdrejtë me paketa ushqimore dhe higjienike, qira, punësim, mbështetje administrative, shërbime të specializuara, mentorim dhe ndjekje të rasteve në mbështetje të punonjësit të mbrojtjes së fëmijës. Më shumë se 100 fëmijë dhe familjet e tyre janë mbështetur gjatë vitit 2023. Gjithashtu është pjesë e proceseve të konsultimit për hartimin e politikave të ndryshme, raportimeve dhe kërkimeve.

d. education, vocational training and job placement programmes.

Viktimat dhe viktimat e mundshme nga Komuniteti rom dhe egjiptian janë shfrytëzuar kryesisht për qëllime seksuale dhe lypje. Çdo vit, Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me aktorët antitrafikim organizojnë sesione informuese, sensibilizuese dhe edukimi. Ky është një proces i kryer gjatë gjithë vitit, por më i dukshëm është gjatë muajit tetor si muaj antitrafik dhe korrikut gjithashtu. Vihet në vëmendjen e komunitetit rreziku dhe vulnerabiliteti i fëmijëve nga komuniteti rom dhe egjiptian.

Disa nga shërbimet riintegruese të ofruara për të miturit si VT/VMT, të ofruara nga strukturat shtetërore në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, janë: frekuentimi i shkollës, regjistrimi në kurset e formimit profesional ose në programet e punësimit. Fokusi i veçantë i ofrohet grupit të minoriteteve.

Në shtator 2022, UNICEF Shqipëri publikoi një studim cilësor të përvojave të të mbijetuarve në aksesin dhe profesionistët e vijës së parë në ofrimin e mbështetjes për riintegrimin ekonomik. Raporti gjendet në linkun e mëposhtëm: <https://www.unicef.org/albania/reports/economic-reintegration-trafficking-survivors-albania>

Me Vendimin nr.173, date 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave u miratua Strategjia kombëtare e punësimit dhe aftësive 2023–2030, plani i veprimit për zbatimin e saj, si dhe plani i zbatimit të garancisë rinore 2023–2024. Objektivat dhe masat e strategjisë lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me OZHQ 8 “Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse e të qëndrueshme, punësim i plotë e produktiv dhe punë e denjë për të gjithë” dhe veçanërisht në përmbushjen esynimeve specifike të OZHQ8, si: 8.5 (punësimi i denjë), 8.3 (produktiviteti), 8.2 (inovacioni), 8.6 (punësimi i të rinjve) dhe 8.8 (të drejtat në punë). Por njëkohësisht, zbatimi strategjisë lidhet natyrshëm dhe me arritjen e objektivave të tjerë të rëndësishëm për Shqipërinë në kuadër të Agjendës 2030 si OZHQ1 (varfëria), OZHQ2 (ushqimi), OZHQ 4 (arsimi), OZHQ 5 (barazia gjinore), OZHQ 9 (industria, inovacioni dhe infrastruktura) dhe OZHQ 10 (zvogëlimi i pabarazisë).

5. What specific measures are taken to reduce the vulnerability to THB of persons with disabilities? Please provide information in the following areas:

- a. deinstitutionalisation, including community and family-based services for children and support for independent living;

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2023 dhe Strategjisë së re të Mbrojtjes Sociale 2024-2030, që përfshin objektivin specifik të deinstitutionalizimit, po shkon drejt procesit të deinstitutionalizimit duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara në institucionet rezidenciale për përkujdesje sociale.

Është hartuar një plan gjithëpërfshirës për zëvendësimin e institucioneve me shërbime me bazë komunitare, duke siguruar që asnjë person me aftësi të kufizuara të deinstitutionalizuar të mos mbetet pa mbrojtjen e nevojshme, me përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara.

- Mekanizmi i Fondit Social ka prezantuar shërbimet për shërbimin e ndihmës në shtëpi, mbështetje psikosociale dhe shërbime të integruara sociale.
- Standardet e shërbimeve për shërbimin e ri të specializuar lëvizës dhe për jetesë të pavarur për Personat me Aftësi të Kufizuar (PAK) janë miratuar në vitin 2022.
- Ofrohen 28 shërbime komunitare të kujdesit ditor (11 shërbime publike dhe 17 jopublike), nga të cilat përfitojnë 16 105 fëmijë me aftësi të kufizuara
- Për herë të parë janë ofruar 6 shërbime të specializuara lëvizëse për fëmijët me aftësi të kufizuara në 6 bashki, për më shumë se 600 përfitues dhe familjet e tyre.

Në zbatim të Vendimi nr. 706, datë 9.9.2020, “Për miratimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit, 2020–2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”, janë krijuar shërbime të reja mbështetëse për fëmijët dhe familjet me fokus parandalimin e ndarjes së fëmijëve nga familjet e tyre si dhe mbështetjen e familjes për ribashkimin me fëmijët. Shërbimet janë ngritur në bashkitë e Korçës dhe Vlorës dhe po pilotohen në Tiranë dhe Durrës, pranë qendrave komunitare. Janë hartuar standardet e shërbimeve të jetesës gjysmë të pavarur për personat/të rinjtë mbi 14 vjeç pa kujdes prindëror.

Nisma ARSIS me mbështetjen e UNICEF Shqipëri është angazhuar në mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në avancimin e procesit të deinstitutionalizimit, veçanërisht në pilotimin e modeleve të para të transformimit të institucioneve të kujdesit rezidencial në shërbime komunitare si modeli i qendrës së mbështetjes së fëmijëve dhe familjes, modelit të kujdesit profesional dhe ribashkimit të fëmijës me familjen biologjike.

World Vision Albania ka kontribuar në shërbimet e komunitetit dhe familjes për fëmijët, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre për të mbështetur jetesën e pavarur në mënyrë specifike përmes disa ndërhyrjeve dhe projekteve të rëndësishme si më poshtë:

- Projekti i “Qendrës Komunitare për Shërbimet ndaj Aftësisë së Kufizuar” në Prrenjas, një projekt i financuar nga BE mbështet 180 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre nëpërmjet shërbimeve të integruara të ofruara në qendrën komunitare të ndërtuar në Prrenjas, të kombinuara me shërbimet celulare të ofruara në shtëpi. Qendra komunitare është ndërtuar në ambientet e spitalit në Prrenjas.
- “KIA Green Light Project”, financuar nga Kia Motors dhe World Vision Korea dhe zbatuar nga WVA në zonën e Librazhdit. Në kuadër të projektit, në Bashkinë Librazhd po ndërtohet një qendër e re multifunksionale, e cila pritet të inagurohet në pranverë. Qendra do të mbështesë 62 fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara me shërbime shëndetësore dhe psikosociale. Prindërit dhe kujdestarët do të trajnohen gjithashtu për fazat e zhvillimit të fëmijës dhe si të përfshihen në aktivitete zhvillimore me fëmijët e tyre në jetën e përditshme.

Një tjetër projekt që ka nisur së fundmi të zbatohet në territorin administrativ të Durrësit dhe Elbasanit: “Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të fëmijëve në rrethin e Durrësit dhe Elbasanit”. Ky projekt synon të ofrojë shërbime shëndetësore për 80 fëmijë me probleme shëndetësore nga familje në nevojë, sipas nevojave të identifikuar. Njëkohësisht, projekti synon të rrisë të kuptuarit dhe njohuritë e 50 prindërve dhe kujdestarëve të fëmijëve mbi rëndësinë e kujdesit shëndetësor për fëmijët.

22 adoleshentë të moshës 12+ dhe prindërit/kujdestarët e tyre kanë përfituar nga projekti “Hello Teen” nëpërmjet vlerësimit të kryer mbi metodologjinë AFLS (The Assessment of Functional Living Skills), një udhëzues për aftësitë që janë thelbësore për pavarësinë.

b. monitoring institutions and foster families accommodating persons with disabilities;

Në vitin 2010 hyri në fuqi Kuadri i Standardeve të Zbatimit të Kujdestarisë dhe në vitin 2018 u miratua VKM për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e regjistrimit të familjes kujdestare për fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe masa e financimit për shpenzimet e fëmijëve të vendosur në familje kujdestare.

Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve ose struktura e shërbimeve të kujdesit social, për bashkitë që nuk kanë njësi të vlerësimit dhe referimit të rasteve, monitoron në mënyrë të vazhdueshme familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari, nëpërmjet vizitave monitoruese në shtëpi ose gjatë aktivitetit normal familjar. Vizitat monitoruese bëhen çdo 2 javë në 3 muajt e parë për familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari dhe më pas çdo muaj. Rezultatet e çdo vizite dokumentohen dhe përfshihen në dosjen përkatëse të fëmijës.

Gjithashtu, drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror monitorojnë çdo 3 muaj proceset e punës së punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore dhe monitorojnë fëmijët e vendosur në kujdestari familjare. Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale inspekton familjen kujdestare dhe fëmijën dy herë në vit, për të siguruar respektimin e standardeve të shërbimit të kujdestarisë, si dhe për të siguruar

mirëqenien e fëmijës, sipas procedurave për zbatimin e standardet e përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Monitorimi nga drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe inspektimi nga inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale koordinohen dhe kryhen në ditët e monitorimit familjar nga struktura e shërbimeve të kujdesit social të bashkisë ose njësisë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve të njësisë administrative.

Për të adoptuar një mbështetje të përshtatshme financiare për familjet kujdestare, në vitin 2023 është hartuar analiza ligjore dhe financiare e kuadrit rregullator, duke synuar rritjen e interesit të personave, përveç anëtarëve të ngushtë të familjes, për t'u bërë kujdestarë.

- c. procedure for the selection and appointment of legal guardians and monitoring of their work;
- d. access to adequate accommodation, education and work;
- e. access to information and reporting/complaints mechanisms which are accessible to persons with disabilities.

Me Ligjin nr. 108/2012, Shqipëria ka ratifikuar gjithashtu Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara" duke ndërmarrë promovimin, mbrojtjen dhe garantimin që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe duke promovuar respektimin e dinjitetit të tyre të qenësishëm.

Në nenin 16 të kësaj Konvente, të titulluar "Liria nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi", parashikohet se: "1. Shtetet Palë do të marrin masat e duhura legjislative, administrative, sociale, arsimore dhe të tjera për të mbrojtur personat me aftësi të kufizuara, si brenda familjes dhe jashtë saj, nga të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, duke përfshirë aspektet e bazuara në gjini (...) 5. Shtetet palë duhet të sigurojnë legjislacion dhe politika efektive, duke përfshirë legjislacionin dhe politikën në lidhje me gratë dhe fëmijët, për të siguruar që rastet e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit ndaj personave me aftësi të kufizuara të identifikohen, hetohen dhe, sipas rastit, të ndiqen penalisht."

Në Shqipëri është më i zhvilluar kujdesi farefisnor në raport me shërbimet e familjeve kujdestare. Institucionet rezidenciale për personat me aftësi të kufizuara nuk janë përfshirë ende në procesin e vlerësimit në kuadër të deinstitutionalizimit.

6. How do you ensure in practice that an assessment of the vulnerability and special needs of asylum seekers is carried out at an early stage? What procedures are followed when vulnerability to THB is detected? Please provide information on policies and measures in the following areas:

- a. provision of comprehensive and accessible information, in a range of relevant languages, on the rights of asylum seekers, indicators of THB, rights of victims of THB, and contacts of relevant organisations;

Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe çdo autoritet tjetër shtetëror, në zbatim të përcaktimeve të bëra në ligjin 10/2021 datë 01.02.2021 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë", u kushtojnë vëmendje, trajtim dhe kujdes të veçantë personave që i përkasin kategorisë së veçantë. Nevojat e veçanta të këtyre personave përcaktohen në bazë të vlerësimit individual të secilit azilkërkues. Nëpërmjet procedurave të veçanta dhe garancive të pranimit, kërkuesve iu jepet mbështetja e duhur duke u bazuar në rrethanat e tyre personale, si: mosha, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, aftësi të kufizuara, sëmundje e rëndë, çrregullim mendor, ose si rezultat i torturës,

përdhunimit apo formave të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale, në mënyrë që të ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë ligj. Procedura e njohjes së rrethanave personale të kërkuesve, kryhet në mënyrë të vazhdueshme nga punonjësit e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, të trajnuar posaçërisht, që nga momenti i shprehjes së qëllimit për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Për azilkërkuesit, ofrohen informacione nëpërmjet broshurave që janë shpërndarë nga UNHCR-ja në pikat e kalimit kufitar dhe në Qendrën Pritëse për Azil (QPA) në gjuhën angleze dhe arabe duke i njohur ato me të drejtat e detyrimet që kanë.

Bazuar në VKM-në nr. 499 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit dhe mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit” dhe në nenin 58/2c të KPP-së, viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit gëzojnë të dejtën për shërbime përkthimi dhe për përkthyes.

Qendra psiko-sociale “Vatra” në kuadër të projektit “Kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës me bazë gjinore midis azilkërkuesve afganë në Shqipëri”, financuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit, ka informuar 555 përfitues (257 burra, 252 gra, 38 djem dhe 9 vajza) të cilët kanë marrë pjesë në sesione informative të organizuara, në fokus grupe dhe janë vlerësuar dhe kanë marrë asistencë direkte gjatë takimeve/vlerësimit individual.

Janë realizuar 11 sesione informative dhe 6 fokus grupe me pjesëmarrjen e 274 personave (153 gra, 107 burra dhe 14 fëmijë). Seancat u zhvilluan nga specialistë të qendrës “Vatra”, anëtarë të Njësisë Lëvizëse dhe koordinatorë të terrenit. Pjesëmarrësit u informuan për çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore, konkretisht mbi konceptet dhe format e trafikimit, treguesit e rrezikut, teknikat për t'u mbrojtur në rast se lëvizin në vende të ndryshme, këshillime për mbrojtjen nga të gjitha format e trafikimit online.

Projekti u përqendrua në Shëngjin dhe në zonën e Durrësit (Golem dhe Durrës) midis grupeve të azilkërkuesve afganë të vendosur në këto zona. Qëllimi i projektit ishte rritja e identifikimit dhe mbrojtjes së migrantëve vulnerabël midis grupit të madh të migrantëve që janë vendosur në qarkun e Durrësit dhe Lezhës, si dhe migrantëve të tjerë që jetonin në një situatë të cënueshme dhe të rrezikshme jashtë këtyre zonave, duke qenë në rrezik trafikimi dhe shfrytëzimi. Gjithashtu, projekti synoi të rrisë ndërgjegjësimin e popullatës në lidhje me parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës me bazë gjinore, nëpërmjet ofrimit të sesioneve informative, fokus grupeve, takimeve individuale, prodhimit dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve informative. Qendra Vatra ka prodhuar 1000 fletëpalosje informuese mbi trafikimin në gjuhët pashto dhe dari. http://www.qendravatra.org.al/previewdoc.php?file_id=761

Për të miturit e huaj të pashoqëruar, të kategorizuar si VT/VMT, zbatohen PSV-të për viktimat e trafikimit dhe kanë përfituar nga programet antitrafikim në qendra.

Gjatë periudhës 2019-2023 janë asistuar në qendra 2 raste të të miturve nga Siria dhe Afganistani. Ata përfituan shërbime të plota akomodimi, mbështetje psiko-sociale, shërbim arsimor dhe lidhje me familjen e origjinës. Për dy të miturit e pashoqëruar është ndjekur procedura në përputhje me ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Komisariati/drejtoria vendore për Kufirin dhe Migracionin kanë bërë regjistrimin e shtetasve dhe më pas e kanë kaluar çështjen në sektorin e qarkullimit rrugor me urdhër të policisë, të cilët kanë bashkëpunuar me Njësinë e mbrojtjes së fëmijës së bashkive përkatëse, të cilët bënë vlerësimin e rrezikut të rasteve.

Në Prill 2023, organizata “Tjetër Vizion”, në kuadër të anëtarësimit në platformën kombëtare për parandalimin e kontrabandës dhe mbrojtjen e migrantëve të kontrabanduar, të koordinuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka hartuar një raport monitorimi që kontribuon në përfundimin e misionit përfundimtar të avokimit në nivel kombëtar dhe rajonal për krijimin dhe përmirësimin e praktikave të

punës në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të migrantëve të paligjshëm. Një nga nismat e kësaj platforme kombëtare ishte monitorimi në zonat pranë pikave të kalimit kufitar (PKK), pranë të cilave janë evidentuar raste të kontrabandimit, si dhe organizimi i takimeve me zyrtarë/specialistë të pikave kufitare dhe të drejtorisë së Migracionit.

b. access to legal assistance and representation;

Neni 22 i ligjit nr.10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” parashikon:

1. Kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare i garantohet ndihma juridike dhe informacion për kriteret dhe procedurën e mbrojtjes ndërkombëtare, si dhe e drejta për ndihmë juridike falas, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Aplikanti ka të drejtë të kontaktojë personat që ofrojnë sigurim në çdo fazë të procedurës këshillim ligjor dhe përfaqësues të UNHCR-së.

Neni 58 “Ndhimja juridike e garantuar nga shteti”

1. Kërkuesit i ofrohet ndihma juridike falas e garantuar nga shteti në lidhje me:

- a) informacion për të drejtat dhe detyrimet e tyre;
 - b) hartimin e ankimit për vendimet e marra gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës;
 - c) hartimin e akteve dhe përfaqësimin në procedurat administrative pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe para gjykatës për ankimin e vendimeve të marra gjatë shqyrtimit të kërkesës.
2. Ndhimja juridike i ofrohet aplikantit që nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për të përballuar shpenzimet përkatëse.
 3. Ndhimja juridike, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të ofrohet nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

Gjatë vitit 2023, Qendra “Vatra” asistoi dhe mbështeti me asistencë ligjore dhe shërbime riintegrimi, një grua nga Siria, e identifikuar si viktimë e mundshme trafikimi. Përfituesja u asistua nga qendra “Vatra” në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Durrës në procesin e aplikimit për azil. Si rezultat, përfituesja dhe 2 fëmijët e saj u pajisën me leje qëndrimi si azilkërkues.

c. access to decent accommodation, health (including psychological) care, work and education.

Neni 3 “Përkufizime”, paragrafi 25 i ligjit nr. 10/2021 “Për Azilin në RSH” përcakton se: “Personat që i përkasin kategorisë së veçantë” janë fëmijët, fëmijët e pashoqëruar, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar, gratë shtatzëna, prind i vetëm me fëmijë të mitur, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, viktimat e gjyrtimit gjeneral, LGBTI, personat me sëmundje të rënda, personat me probleme/çrregullime të shëndetit mendor ose personat, të cilët kanë qenë subjekt i torturës, përdhunimit apo ndonjë forme tjetër të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale.

Kërkuesit që i përkasin kategorisë së veçantë, përfitojnë trajtim të ndryshëm në përputhje me nevojat e tyre specifike për akomodimin, ofrimin e kushteve të veçanta të pranimit, trajtimin e nevojshëm mjekësor sipas nevojave specifike dhe pasojave të shkaktuara, arsimimin, si dhe këshillimin e nevojshëm psiko-social. Konkretisht:

- Neni 50 i ligjit 10/2021 “Për azilin” parashikon shërbimet që u ofrohen personave që i përkasin kategorisë së veçantë.

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe çdo autoritet tjetër shtetëror, në zbatim të përcaktimeve të bëra në këtë ligj, u kushtojnë vëmendje, trajtim dhe kujdes të veçantë personave që i përkasin kategorisë së veçantë.

2. Nevojat e veçanta të këtyre personave përcaktohen në bazë të vlerësimit individual të secilit kërkues, refugjat, person nën mbrojtje plotësuese ose person nën mbrojtje të përkohshme sipas këtij ligji.

3. Kërkuesit, refugjatët, personat nën mbrojtje plotësuese ose personat nën mbrojtje të përkohshme, që i përkasin kategorisë së veçantë, përfitojnë trajtim të ndryshëm në përputhje me nevojat e tyre specifike për akomodimin, ofrimin e kushteve të veçanta të pranimit, trajtimin e nevojshëm mjekësor, si dhe këshillimin e nevojshëm psikosocial.

4. Kërkuesit, refugjatët, personat nën mbrojtje plotësuese ose personat nën mbrojtje të përkohshme, të cilët kanë qenë subjekt i ushtrimit të torturës, të përdhunimit apo të akteve të tjera të rënda të dhunës, marrin trajtimin e plotë dhe të duhur për dëmin e shkaktuar nga akte të tilla, në veçanti mundësinë për të pasur trajtimin dhe kujdesin e duhur mjekësor dhe psikologjik.

5. Personat, të cilët punojnë me viktimat e torturës, të përdhunimit apo të akteve të tjera të rënda të dhunës, duhet të kenë marrë ose marrin trajnimin e duhur në lidhje me nevojat e tyre dhe duhet t'u përmbahen rregullave të konfidencialitetit për informacionin që marrin gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre.

- Neni 59 “E drejta për arsimim e fëmijëve aplikantë” parashikon:

1. Fëmijët aplikantë kanë të drejtë të ndjekin arsimin parauniversitar në të njëjtat kushte si edhe për fëmijët me shtetësi shqiptare.

2. Ndjekja e arsimit parauniversitar nga fëmijët aplikantë, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet brenda 3 (tre) muajve nga data e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

- Neni 61 “E drejta për punësim dhe formim profesional”:

1. Aplikantët kanë të drejtë të punësohen jo më vonë se 9 (nëntë) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës, nëse autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët nuk ka marrë ende një vendim dhe kjo vonesë nuk mund t'i atribuohet aplikantit.

2. Republika e Shqipërisë, për arsye të politikave të tregut të punës, mund t'i japë përparësi tregut të punës qytetarëve të saj.

3. Aplikantët kanë të drejtën e formimit profesional, pavarësisht nëse kanë akses në punën e tregut.

Gjatë periudhës raportuese, Koalicioni Kombëtar I strehëzave Antitrafik informon se: 101 përfitues nga azilkërkuesit afganë janë mbështetur me asistencë të drejtpërdrejtë: 58 përfitues (23 burra, 31 gra dhe 4 fëmijë) janë mbështetur me nevojat bazë: veshmbathje, ushqim dhe ilaçe; 2 prej tyre edhe me apartament me qera; 72 përfitues janë mbështetur me këshillim psikologjik; 52 përfitues me këshillim ligjor; 2 djem janë akomoduan në strehëz dhe 16 djem u asistuan me informacion në komisarariat dhe u referuan për mbështetje të mëtejshme në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve.

-Neni 57 “Kujdesi shëndetësor”

1. Kërkuesit kanë të drejtën për kujdes shëndetësor, i cili përfshin kujdesin e urgjencës shëndetësore, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe trajtimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve të rënda të shëndetit mendor.

2. Kërkuesve që kanë qenë subjekte të përdhunimit, të ushtrimit të torturës, trajtimit çnjerëzor ose degradues apo formave të tjera të rënda të dhunës, si dhe kërkuesve që i përkasin kategorisë së veçantë u ofrohet trajtim i nevojshëm shëndetësor sipas nevojave specifike dhe pasojave të shkaktuara.

7. What specific measures are taken to reduce the vulnerability to THB of migrant workers (including seasonal workers, seconded/posted workers, domestic workers, diplomatic household employees)? Please provide information on policies and measures in the following areas:

Më datë 14 dhjetor 2022, Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama dhe Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, z. Rishi Sunak nënshkruan Komunikatën e përbashkët Shqipëri – Mbretëri e Bashkuar “Thellimi i bashkëpunimit dypalësh në fushat me interes të përbashkët”, ku ranë dakord të thellojnë bashkëpunimin në tri fusha me interes të përbashkët: a) çështjet e sigurisë dhe punët e brendshme (me vëmendje të posaçme të lufta kundër krimit të organizuar dhe emigracionit të paligjshëm); b) rritja ekonomike dhe investimet; c) novacioni, rinia dhe arsimi, për të përmirësuar më tej monitorimin dhe mbikëqyrjen e migracionit të paligjshëm dhe gjithashtu, dy qeveritë bien dakord të punojnë me Grupin e Ekspertëve për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. (GRETA), për të garantuar raportime të pavarura për zbatimin e masave.

<https://www.kryeministria.al/newsroom/komunikate-e-perbashket-shqiperi-mbreteri-e-bashkuar-thellimi-i-bashkepunimit-dypalesh-ne-fushat-me-interes-te-perbashket/>

- a. provision of comprehensive and accessible information, in a range of relevant languages, on migration and labour laws, worker protection and contacts of relevant organisations;
- b. provision of clear employment contracts;

Bazuar në ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt”, punëtori migrant mund të punojë në territorin e vendit, në rast se ka një leje unike, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe. Aplikimi për leje unike bëhet online dhe shqyrtohet nga drejtoritë e kufirit dhe migracionit në qarkun ku ushtrohet aktiviteti.

Autoritetet kufitare dhe të migracionit lëshojnë lejen unike pasi të jetë marrë miratimi i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj, nga marrëveshje ndërqeveritare ose me vendim të Këshillit të Ministrave.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive lëshon miratimin e punësimit pasi ka përfunduar verifikimet e saj në lidhje me kriteret ligjore që duhet të plotësojnë i huaji dhe punëdhënësi i tij. Një prej tyre është se: "b) punonjësit e huaj nuk janë të punësuar në kushte më pak të favorshme se punonjësit shqiptarë në të njëjtin pozicion. Shqyrtohet informacioni lidhur me pagat, orarin e punës dhe kushtet e tjera të punës, janë në përputhje me normat shqiptare. legjislacioni i punës" (nenet 56 dhe 74 të ligjit 79/2021 “Për të huajt”).

Gjithashtu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë garanton mosdiskriminimin e punëtorëve vendas dhe të huaj, në nenin 9 të tij.

Në sportelet e Zyrave të Punësimit dhe AKPA-s gjenden dhe shpërndahen broshura dhe fletëpalosje informative për punëkërkuesit (përfshirë dhe punëtorët migrantë) duke i njohur ata me të drejtat e detyrimet që kanë.

- c. access to decent work and housing, health care, social services and education;

Punëtorët migrantë kanë të drejtë për akses në punë të denjë. Përpara miratimit të punësimit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive kontrollon që kushtet e punësimit dhe të punës janë sipas legjislacionit kombëtar të punësimit dhe nuk ka diskriminim në këtë drejtim në krahasim me shtetasit shqiptarë. (neni 74 i Ligjit për të Huajt dhe Neni 9 i Kodit të Punës).

Në VKM nr.858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve të RSH”, në Kreun III/B përcaktohet se një ndër dokumentat dhe kushtet që duhet të plotësojë i huaji, për të aplikuar për leje qëndrimi është edhe dokumenti që provon akomodim të përshtatshëm/kontratë blerje ose marrje me qira të banesës, në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri.

d. possibility to change employers;

Punëtori migrant mund të ndryshojë punëdhënësin e tij. Në përgjithësi ai ka detyrimin t'i përmbahet motivit të dhënies së lejes unike sipas motivit të punës. Në rast se ai ndryshon vendin e punës, ai është i detyruar të njoftojë autoritetet përgjegjëse për çdo ndryshim të kushteve në të cilat është lëshuar leja unike dhe të kërkojë miratimin e saj në rast se ndryshimi ka të bëjë me:

a) Emri dhe adresa e punëdhënësit;

b) kontratën e vlefshme të punës që mbulon kohën për të cilën është lëshuar leja unike;

c) Veprimtaritë e autorizuar si person i punësuar (neni 71, Ligji 79/2021).

e. access to confidential complaints mechanisms;

f. right to join trade unions and to engage in collective bargaining;

Sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, çdo formë diskriminimi, e parashikuar në Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, është i ndaluar. Në kuptim të Kodit të Punës, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion zbatohet edhe në lidhje me:

- o anëtarësimin dhe aktivizimin në organizatat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve, ose në çdo organizatë, anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, duke përfshirë edhe përfitimet e ofruara nga këto organizata;

Kodi parashikon që, në rastin kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e të drejtës së punësimit dhe profesionit, sipas këtij Kodi, procedura e ankimimit, zbatohet bazuar sipas ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në të gjitha procedurat e ankimimit, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion, personi kundër të cilit paraqitet ankimi ose i padituri është i detyruar të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë. (Neni 9, Kodi i Punës).

Shteti Shqiptar bashkohet me shtetet, ku e drejta e sindikatave mbrohet me ligj, cituar në Kodin e Punës, konkretisht në nenin 10 “Liria Sindikale dhe Bisedimet Kolektive”, gjithashtu në nenet 176-187 “Organizatrat Sindikale”.

g. legal avenues for regularising their stay in the country.

Neni 8 i Kodit të Punës parashikon:

“1. Puna e detyruar në të gjitha format e saj është e ndaluar.

2. Punë e detyruar ose e detyrueshme është çdo punë ose shërbim që i kërkohet individit kundër vullnetit të tij, duke kërcënuar me çdo lloj dënimi”.

Ligji 79/2021 “Për të huajt” rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë. Ligji përcakton funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike e private, shqiptare ose të huaja, që në përputhje me

parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e së drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente dhe parimin e mosdiskriminimit, kryejnë aktivitete në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë të bëjnë me të huajt që kërkojnë të hyjnë, që hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga Republika e Shqipërisë.

Prioritet i inspektimit të punës ka qenë edhe inspektimi i agjencive private të punësimit, si një formë rekrutimi punonjësish, kryesisht të huaj. Është detyrë e inspektorëve të punës të kontrollojnë kontratën ndërmjet agjencisë së punësimit të përkohshëm dhe kompanisë pritëse. Është kontrolluar edhe kontrata e punës ndërmjet agjencisë së punësimit dhe punonjësit, për respektimin e rregullave.

8. Do labour inspectorates and other authorities checking workplace conditions possess a comprehensive mandate, and adequate human, financial and technical resources, to conduct regular, proactive workplace inspections in all economic sectors, with a particular emphasis on high-risk sectors prone to exploitation? How do labour inspectors co-operate with other authorities and trade unions? Is there a separation between labour inspection and immigration control functions?

Inspektimi i punës rregullohet me ligjin nr. 9634/2006 “Për inspektimin e punës” i ndryshuar, i cili përmban parimet e Konventës së ILO-s nr. 81 “Për inspektimin e punës në industri dhe tregti”. Inspektori i punës inspekton personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, privatë ose publikë, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike fitimprurëse ose jofitimprurëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. Misioni i përgjithshëm i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) është kontrolli, konstatimi, këshillimi, informimi, zbutja e konflikteve, parandalimi dhe sanksionimi. ISHPSHSH është një organ i ngarkuar me ligj për:

a) të siguroar zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punonjësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimet, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, të lidhura ngushtë me to, në masën që inspektorët e punës kanë për detyrë të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave;

b) t'i dhënë punëdhënësit dhe punëmarrësit të dhëna dhe këshilla teknike për mjetet më efikase të rishikimit të dispozitave ligjore;

c) të njoftuar autoritetin përgjegjës për mangësitë dhe abuzimet, të cilat nuk mbulohen në mënyrë specifike nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të propozojë mjetet dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e situatës.

ISHPSHSH vazhdon të forcojë kapacitetet institucionale për koordinimin, mbikëqyrjen dhe përmirësimin e procesit të inspektimit. Veprimtaria e inspektimit shtrihet në 6 Drejtori Rajonale, ku procedurat e inspektimit kryhen online nëpërmjet sistemit “e-inspection”, duke kryer hetimin administrativ të respektimit të kërkesave ligjore, në kohë reale pranë dhe në prani të subjektit, si dhe rritjen e transparencës së procesit të inspektimit.

Trajnime të reja dhe mjete të reja janë futur si rezultat i auditimeve të kapaciteteve të inspektorateve të punës. Gjatë vitit 2023, ndër të tjera, fokusi ka qenë në trajnimet lidhur me dhunën dhe ngacmimin në botën e punës. Standardet ndërkombëtare dhe praktika kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin në botën e punës dhe rolin dhe ndërveprimin e institucioneve inspektuese/monitoruese për të luftuar fenomenin e diskriminimit, dhunës dhe ngacmimit si çështje sigurie dhe shëndeti në punë, kanë forcoi bashkëpunimin e ISHPSHSH me sindikatat dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në zbatim të projektit ESAP II, me fondet e BE-së, është ngritur një sistem planifikimi inspektimi bazuar në rrezikun e mundshëm, për shkelje të dispozitave ligjore për informalitetin, marrëdhëniet e punës dhe kushtet e punës, ku tregues janë edhe grupet që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga Kodi i Punës.

Listat kontrolluese të dedikuara sektoriale në aktivitetet e tekstileve, këpucëve, ndërtimit dhe agjencive private të punësimit janë rishikuar gjithashtu.

Zhvillimi i vazhdueshëm i fushatave sensibilizuese krahas detyrës së kontrollit, ka ndikuar në ndërgjegjësimin e aktorëve të punës në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Është forcuar edhe bashkëpunimi për të luftuar punësimin informal, si me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me Qendrën Kombëtare të Biznesit.

ISHPSHSH është pjesë e grupit të punës për rishikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Policisë së Shtetit. Ky memorandum synon të rrisë masat parandaluese për identifikimin proaktiv si dhe mbrojtjen e viktimave të punës së detyruar dhe trafikimit.

9. How are employment and recruitment agencies regulated and monitored? Are all stages of the recruitment process, including advertisements, selection, transport, and placement, subject to regulation? Are recruitment fees and related costs prohibited from being borne by workers or jobseekers?

Rregullimi i veprimtarisë së agjencive private të punësimit bazohet në kuadrin ligjor të parashikuar nga konventa ndërkombëtare në fushën e migracionit për motive punësimi dhe agjencive private të punësimit, legjislationit të punësimit dhe licencimit dhe akteve nënligjore për krijimin dhe funksionimin e agjencive private të punësimit. Përkatësisht:

- Konventa Ndërkombëtare nr. 181 i ONP-së, "Për agjencitë private të punësimit",
- Kodi i Punës,
- Ligji 15/2019 "Për nxitjen e punësimit" i ndryshuar,
- Ligji 9668/2006 "Për emigracionin e shtetasve shqiptarë për arsye punësimi",
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 21.5.2018, "Për disa rregulla të veçanta për punonjësit e përkohshëm, të cilët punësohen pranë agjencive të punësimit të përkohshëm"
- Vendimit i Këshillit të Ministrave nr. 101, datë 23.2. 2018 "Manual për organizimin dhe funksionimin e Agjencive Private të Punësimit".

Ato përcaktojnë rastet e shkeljeve në veprimtarinë e agjencive private të punësimit dhe inspektimin e monitorimin e veprimtarisë së tyre gjatë inspektimeve në agjencitë private të punësimit dhe raportimin tek ministri përgjegjës për punësimin. Ata saktësojnë se punonjësi në çdo rast nuk paguan tarifën e agjencisë, por ato mbulohen nga punëdhënësi. Në këtë drejtim nuk parashikohet diskriminim nëse punonjësi është shtetas vendas apo i huaj.

Krijimi i marrëdhënieve të punës (punëdhënës - punëmarrës) kryhet drejtpërdrejt nga punëdhënësi ose ky i fundit përdor shërbime të specializuara të ofruara nga zyrat shtetërore të punësimit ose agjencitë private të punësimit. Veprimtaria e agjencive private të punësimit i nënshtrohet rregullave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 101 datë 23.02.2018 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencive Private të Punësimit" si dhe VKM nr. 286, datë 21.05.2018 "Për disa rregulla të veçanta për punonjësit e përkohshëm, të cilët janë të punësuar pranë agjencive të punësimit të përkohshëm", i ndryshuar. Sipas këtyre dispozitave ligjore, veprimtaria private e ndërmjetësimit në

punësim ushtrohet vetëm nga agjencitë private të punësimit, të licencuara, pas plotësimit të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për licencat.

Agjencia private e punësimit regjistrohet si person fizik/juridik privat dhe kryen veprimtarinë e ndërmjetësimit në punë, nëpërmjet këtyre shërbimeve:

- a) Informimi, këshillimi, si dhe vlerësimi i kërkesave dhe kërkesave për ndërmjetësim për punësim;
- b) Kërkimi për punë;
- c) Ndërmjetësimi për përcaktimin e kushteve dhe lidhjeve dhe marrëdhënieve të punës, ndërmjet punëkërkuesit dhe punëdhënësit.

Për të ushtruar veprimtarinë e saj, agjencia duhet të jetë e pajisur me licencën e kategorisë X.2.A, “Ndërmjetësim në tregun e punës”, në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi.

Për punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, agjencia zbaton të gjitha marrëveshjet dypalëshe të qeverisë shqiptare me vendet përkatëse.

Shërbimet e agjencisë për punëkërkuesit janë falas. Agjencia nuk ngarkon punëkërkuesin me asnjë detyrim financiar, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, përveç pagesës së shpenzimeve të nevojshme për plotësimin e dosjes administrative të çdo punëkërkuesi.

Shpenzimet për shërbimin e ndërmjetësimit, të kryera nga agjencia, duhet të përballohen nga punëdhënësi. Agjencia siguron trajtim të barabartë për të gjithë punëkërkuesit. Punëkërkuesi i ndërmjetësuar nga agjencia gëzon të drejtën e marrëveshjeve kolektive, pagës minimale, kohës dhe kushteve të punës, përfitimeve të sigurimeve shoqërore, mbrojtjes së pronës dhe shëndetit në punë.

Agjencia duhet të njoftojë punëkërkuesin për kushtet e punës dhe punësimit, përpara fillimit të marrëdhënies së punës. Agjencia nuk duhet të ndërmjetësojë për punëkërkuesin në vendet e punës që paraqesin rrezik për pasiguri për jetën dhe shëndetin e tij ose ku ai mund të jetë objekt abuzimi ose trajtimi diskriminues.

Personeli i agjencisë, për shërbimet që ofron, duhet të ketë kualifikimin dhe trajnimin e nevojshëm.

Agjencia bashkëpunon me zyrat shtetërore të punësimit për:

- a) mbledhjen, shkëmbimin e të dhënave dhe përdorimin e terminologjisë së përbashkët, për përmirësimin e transparencës së funksionimit të tregut të punës;
- b) shkëmbimin e njoftimeve për vendet e lira të punës;
- c) lidhjen e marrëveshjeve për zbatimin e veprimtarive të ndryshme;
- ç) trajnimin e personelit.

Përpunimi i të dhënave të punëkërkuesit nga agjencia bëhet duke respektuar konfidencialitetin.

Inspektorati Shtetëror i Punës kryen kontrole periodike për të përcaktuar përputhjen e veprimtarisë së agjencisë me legjislacionin përkatës dhe, kur vëren shkelje, njofton ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit. Për të monitoruar më mirë agjencitë private të punësimit, ISHPSH ka rishikuar listat e kontrollit për këtë aktivitet.

10. How do you prevent and sanction abuses of legal constructions such as self-employment, letter-box companies, sub-contracting, and posting of workers, which may be used to commit THB?

Në lidhje me punonjësit e huaj që dërgohen nga një kompani ose agjenci pune të përkohshme jashtë territori të Republikës së Shqipërisë (RSH) për të kryer një veprimtari pune, Kodi i Punës neni 3/1 i

Kodit të Punës “Punësimi i përkohshëm i punëtorëve të huaj në Shqipëri” përcakton rastet e punonjësve të punësuar dhe rregullat në përputhje me Bashkimin Evropian.

Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për heqjen e licencës, në rastet kur agjencia/personi fizik/juridik (partner, aksioner ose anëtar i organeve drejtuese të saj):

- a) është dënua për vepra penale të kryera me dashje;
- b) ka shkelur parimin e barazisë, duke diskriminuar punëkërkuuesit;
- c) vërtetohet se ai ka kërkuar tarifa nga punëkërkuuesi për shërbimet e ofruara drejtpërdrejt ose tërthorazi ose ka pranuar pagesa, mallra ose shërbime nga punëkërkuuesi, me përjashtim të pagesës së shpenzimeve të nevojshme për plotësimin e dosjes administrative.
- ç) shpall njoftime të rreme ose mashtruese për ndërmjetësimin;
- d) bën deklaratat të rreme, dëshmi ose përdor dokumente të falsifikuara;
- dh) nxit drejtpërdrejt ose tërthorazi punëkërkuuesit të transferohet në një vend tjetër pune, përveç rasteve kur transferimi është në interes të punëkërkuuesit;
- e) ndikon ose përpiqet të ndikojë në ndonjë punëdhënës ose ndërmarrje që të mos punësojë persona të caktuar;
- ë) ofron shërbimet e veta për të miturit;
- f) merr përsipër të ndërmjetësojë për punëkërkuuesin në vendet e punës që cenojnë dinjitetin e Republikës së Shqipërisë;
- g) pengon ose tenton të pengojë inspektimin e organeve përkatëse;
- gj) nuk përmbush detyrimet për sigurimet shoqërore ose kontratat e punës për punonjësit e tij;
- h) nuk respekton dispozitat e këtij vendimi,

11. How do your country’s migration legislation and policies seek to prevent THB by enabling lawful migration and legal employment opportunities accompanied by decent work conditions?

Kuadri ligjor shqiptar gjatë viteve të fundit ka qenë në një linjë me legjislacionin e BE- së dhe ka synuar ndërtimin e një politike migratore sa më të fortë dhe koherente. Aktet normative në zbatim të tij janë përmirësuar jo vetëm në aspektin e procedurave të dokumenteve të udhëtimit, vizave, punësimit, qëndrimit, bashkimit familjar, por edhe në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të të gjithë migrantëve dhe familjeve të tyre, me një fokus të veçantë në respektimin e parimeve ndërkombëtare në trajtimin e grave migrante.

Gjatë kësaj periudhe është miratuar ligji nr.79/2021, “Për të Huajt” dhe kanë dalë në zbatim të tij, Vendimi nr. 858, datë 29.12.2021, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve të procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimi nr. 174, datë 12.09.2022 i Ministrisë të Brendshme “Mbi procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të cilët rregullojnë edhe situatën e trajtimit të VT dhe VMT.

Persona vulnerabël, sipas parashikimeve të ligjit nr.79/2021 “Për të Huajt”, janë të miturit e huaj, të miturit e pashoqëruar, persona me aftësi të kufizuara, të moshuar, femra shtatzëna, prind i vetëm me fëmijë të mitur, si dhe persona, të cilët kanë qenë objekt i torturës, përdhunimit ose formave të tjera të dhunimeve të rënda psikologjike, fizike e seksuale, migrantët që për shkak të situatës së tyre specifike nuk janë në gjendje të gëzojnë të drejtat e tyre dhe janë në kushte veçanërisht delikate, si punëtorët e shtëpisë, migrantët me orientim seksual të caktuar, migrantët në gjendje shëndetësore të rëndë dhe ata me aftësi të kufizuara’.

Ligji “Për të Huajt”, garanton dhe përcakton të drejtën e të huajve dhe familjarëve të tyre që qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në Republikën e Shqipërisë për të krijuar familje ose kujdesur për jetën familjare. Në rast të zgjidhjes së marrëdhënies familjare të bashkëshortit/es, ose të partnerit/es së pamartuar, brenda periudhës 5-vjeçare nga përfitimi i lejes së parë të qëndrimit, për efekt të bashkimit familjar, kjo e drejtë humbet. Përrjashtimisht, kur zgjidhja e marrëdhënies familjare me bashkëshortin/bashkëjetuesin bëhet për shkak të dhunës në familje ose formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, viktimave të dhunës me bazë gjinore u jepet, me kërkesë, një leje qëndrimi autonome, pavarësisht nga kohëzgjatja e martesës ose marrëdhënies.

Në zbatim të ligjit, autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, pajis me leje të përkohshme qëndrimi të tipit “A” për raste humanitare të huajin, kur është i mitur i braktisur ose ka mbetur pa mbrojtje prindërore, kujdestari apo shoqëruar për arsye të tjera, si dhe në rastet kur është grua shtatzënë mbi 6 muaj. Po ashtu edhe i/e huaji/a, që është viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit, pajiset me leje të përkohshme qëndrimi të tipit “A”.

Në përputhje me nenin 53 të ligjit, parashikohet edhe lëshimi i lejes së qëndrimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Leja e qëndrimit, e lëshuar për këtë motiv, shërben vetëm për qëndrimin dhe nuk mundëson rihyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë në rast se i huaji del nga territori.

Leja e qëndrimit për këtë motiv lëshohet me afat 1-vjeçar dhe rinovohet vetëm në rastet kur:

- vlerësohet se qëndrimi i saj/i tij nuk përbën kërcënim për sigurinë publike dhe atë kombëtare;
- vlerësohet se ekziston një vullnet i qartë i personit për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë gjatë hetimit ose procedimit penal;
- është në pritje të vlerësimit të statusit nga autoritetet kompetente.

Gjithashtu, autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin pajis me leje të përkohshme qëndrimi të tipit “A”, për një afat 3-mujor, të huajin pavarësisht nga vullneti për të bashkëpunuar me drejtësinë, kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se është viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit, e identifikuar si e tillë nga strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit. Kjo leje qëndrimi me afat 3-mujor i jepet viktimës ose viktimës së mundshme të trafikimit me qëllim që të rimarrë veten, si dhe të trajtohet sipas gjendjes fizike dhe mendore për marrjen e një vendimi të mirinformuar për të bashkëpunuar ose jo me organet e drejtësisë.

I huaji, të cilit i jepet leje e përkohshme qëndrimi gëzon të drejtat për të qëndruar dhe lëvizur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të garantuara si për të huajt që kanë leje qëndrimi të përkohshme, sipas procedurave normale. Ai bashkëpunon me organet përgjegjëse për përcaktimin e identitetit të vet, por mungesa e provës, që vërteton identitetin, nuk mjafton si bazë për refuzimin e lëshimit të lejes së përkohshme të qëndrimit. I huaji përfiton kujdes shëndetësor, ndihmë financiare, mbështetje, si dhe të drejtën për të punuar nëse i përfiton sipas dispozitave ligjore në fuqi.

I huaji me statusin e viktimës së mundshme të trafikimit ka të drejtën e punësimit pa marrë më parë miratim nga AKPA-ja dhe duhet të njoftohet nga punëdhënësi lidhja e marrëdhënies të punësimit. Dhënia e lejes së qëndrimit nuk kushtëzohet me ekzistencën e mjeteve të mjaftueshme financiare të viktimës për të mbuluar shpenzimet për kohën e qëndrimit apo nga mungesa e dokumenteve identifikuese të viktimës apo viktimës së mundshme të trafikimit.

Në përputhje me parashikimet e ligjit “Për të Huajt”, institucionet publike kanë detyrimin të bashkëpunojnë, sipas kompetencave, me partnerët socialë, organizatat jofitimprurëse dhe organizatat ndërkombëtare për promovimin dhe zbatimin e programeve të integritit të të huajve në shoqëri. Në të

gjitha veprimtaritë e ushtruara, institucionet publike dhe organizatat jofitimprurëse u ofrojnë të huajve mbrojtje kundër çdo lloji forme diskriminimi.

Për sa i përket punësimit ligjor, ligji për të huajt paraqet disa kategori lejesh unike.

Ky ligj në një farë mënyre ka një natyrë liberale në lidhje me të drejtën për të pasur akses në tregun e punës, sepse, shumë qytetarë nga shtetësi të përcaktuara (SHBA, BE/Zona Shengen, vendet e Ballkanit Perëndimor) kanë mundësinë të pajisen me një leje pune unike pa iu nënshtruar kufizimeve të tregut të punës (parimi preferencial, kuotat, etj.)

Konkretisht, neni 74 “Miratimi i punësimit të një të huaji” parashikon:

1. Leja unike për të huajin, brenda kuotave të caktuara, lëshohet duke mbajtur parasysh zhvillimet dhe nevojat e tregut të punës në Republikën e Shqipërisë.
2. Aplikimi për leje unike bëhet në drejtoritë e kufirit dhe migracionit në rajonin ku kryhet aktiviteti.
3. Autoritetet e kufirit dhe migracionit lëshojnë lejen unike pasi është marrë miratimi i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj, marrëveshje ndërqeveritare ose me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Kërkesa për miratimin e punësimit për një të huaj mund të bëhet nga vetë i huaji me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë ose nga punëdhënësi.
5. Kategoritë që përjashtohen nga detyrimi për të marrë miratimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive sipas këtij neni janë: i huaji, anëtar familjeje i një shtetasi të huaj me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, studentët, i huaji që sipas neneve të posaçme të këtij ligji përjashtohet nga detyrimi për miratim për punësim, të vetëpunësuarit, investitorët, au pairs, i huaji me statusin e viktimës së mundshme të trafikimit, refugjatët, i huaji me mbrojtje të përkohshme dhe i huaji me statusin e mbrojtjes plotësuese.
6. Kategoritë që marrin miratim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe në marrëveshje ndërshtetërore apo akte të tjera ligjore, janë punëmarrësit, punonjësit stinorë të transferuar brenda ndërmarrjes, punonjësit me kualifikim të lartë, vullnetarët, sportistët dhe shërbimet kontraktuale.
7. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive jep miratimin e saj nëse:
 - a) aplikimi është brenda kuotave vjetore të miratuara, në zbatim të këtij ligji;
 - b) punonjësit e huaj nuk janë punësuar në kushte më pak të favorshme se punonjësit shqiptarë në të njëjtën pozicion. Nga shqyrtimi i informacionit lidhur me pagat, orët e punës dhe kushtet e tjera të punësimit, ato janë në përputhje me legjislacionin shqiptar të punës;
 - c) plotësohen kërkesat e neneve të posaçme që lidhen me punësimin;
 - ç) asnjë punonjës nga kategoritë e përcaktuara në pikën 9 të këtij neni nuk është i disponueshëm për atë vend pune.
8. Miratimi për punësim për të huajin e transferuar brenda ndërmarrjes, për punonjës me kualifikim të lartë, punonjës për shërbime kontraktuale, vullnetarë dhe sportistë jepet vetëm për plotësimin e kriterëve të vendosura në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 7 të këtij neni.
9. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, përpara miratimit të kërkesës për punësimin e një të huaji, propozon brenda afatit kohor të publikimit të vendit të lirë të punës kandidatë të përshtatshëm, sipas profilit të kërkuar, të gatshëm të punojnë në vendin vakant të punës si më poshtë:
 - a) punëkërkuar të papunë shqiptarë;
 - b) të huaj, anëtarë të familjes së shtetasve shqiptarë;
 - c) shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të zonës Shengen dhe anëtarët e familjes së tyre, që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë;
 - ç) shtetas të vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut;

- d) anëtarë të familjes së të huajit me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë;
- dh) shtetas të vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje punësimi dy apo shumëpalëshe;
- e) të huaj që gëzojnë përparësi për përfshirje në tregun shqiptar të punës, sipas dispozitave të këtij ligji.
10. Kërkesa për plotësimin e një vendi të lirë pune bëhet publike nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për një periudhë kohore prej 7 (shtatë) ditësh kalendarike që nga dita e regjistrimit të kërkesës për miratimin e punësimit për një shtetas të huaj pranë këtij autoriteti.
11. Për të marrë miratimin, punëdhënësi duhet të dërgojë në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive informacion për pagën, orët e punës, kriteret dhe kushtet e tjera të punësimit. Punëdhënësit që dëshirojnë të punësojnë ose kanë punësuar një të huaj duhet ta dërgojnë këtë informacion brenda një periudhe 2-javore nga kërkesa e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
12. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive jep miratimin për punësim brenda 2 javëve (10 ditë pune) nga marrja e kërkesës për miratim për punësim kur janë plotësuar të gjitha kriteret e tjera ligjore ose nga momenti i plotësimit të tyre.
13. Punëdhënësi, para se të paraqesë një kërkesë për miratim për punësim për një të huaj, mund të kontrollojë kushtet e tregut të punës për dhënien e këtij miratimi. Ai mund ta dërgojë informacionin e përmendur në pikat 10 dhe 11 të këtij neni në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Punëdhënësi mund ta përdorë këtë mundësi në rast se ai do të qartësojë më parë nëse i lejohet punësimi i një të huaji dhe të përshpejtojë procesin e miratimit për punësim.
14. Miratimi për punësim mund të jetë i kufizuar në kohë, llojin e punësimit, punësim, rajon specifik dhe shpërndarje të orëve të punës. Këto kufizime duhet të vendosen në lejen unike ose të qëndrimit.
15. Bashkëpunimi ndërinstitucional për zbatimin e këtij neni përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.

Vështirësitë financiare nuk përbëjnë një arsye të mjaftueshme për anulimin e lejes unike si person i vetëpunësuar, përveç rasteve kur mbajtësi nuk është në gjendje të përballojë koston e jetesës (Neni 82).

Gjatë periudhës 2019-2022 është zbatuar Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i saj të Veprimit (2019-2022) miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 19.6.2019. Ky dokument politik dhe plani i veprimit solli një sërë rezultatesh positive lidhur me trajtimin e kategorive vulnerabël. Në janar 2021 u finalizua hartimi i planit të kontigjencës, që do të bëjë që Shqipëria të menaxhojë flukset e përziera, duke marrë parasysh vulnerabilitetet e popullatave në lëvizje (si të mitur të pashoqëruar, viktima trafikimi, azil kërkues, individë me aftësi të kufizuara etj),

Strategjia ndihmoi në përmirësimin e infrastrukturës pritëse në pikat e kalimit kufitar për të përmbushur siç duhet nevojat specifike të migrantëve (fëmijë, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara etj.) dhe trajnimin e punonjësve të kufirit për identifikimin e kategorive vulnerabël në rastet e flukseve të përziera masive. Gjithashtu u zhvilluan procedura standarde të qarta për kthimin vullnetar të asistuar (KVA), përfshirë për kategoritë vulnerabël si të miturit e pashoqëruar, VT-të dhe azilkerkuesit, si dhe iu dha një vëmendje e veçantë reduktimit të pengesave për gëzimin efektiv të të drejtave nga kategoritë më vulnerabël, si emigrantët femra, fëmijët dhe të rinjtë.

12. How do your country's law and policies to discourage demand that leads to THB address particular vulnerabilities and groups at risk of THB?

Në Kodin Penal janë parashikuar disa nene për dekurajimin e kërkesës. Kështu, neni 110/b "Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar"(Shtuar me ligjin nr.144, datë 2.5.2013) parashikon:

Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Neni 110/c “Veprimet që lehtësojnë trafikimin”(Shtuar me ligjin nr.144, datë 2.5.2013) parashikon: Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

Në shtator të vitit 2022 u miratua Udhëzimi nr. 174, i Ministrisë së Brendshme “Mbi procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë”, i cili rregullon të gjitha standardet dhe proceset e identifikimit dhe regjistrimit të migrantëve në territorin e Shqipërisë, apo në pikat kufitare, si dhe përfshin kontrollin paraprak të migrantëve të parregullt.

Procesi i përzgjedhjes kryhet në kufi ose brenda territorit dhe ka për qëllim përcaktimin e kategorisë së të huajit, duke e klasifikuar atë, si:

- subjekt i refuzimit të hyrjes;
- kërkues i mbrojtjes ndërkombëtare;
- viktimë e mundshme trafikimi;
- imigrant i parregullt;
- i mitur i pashoqëruar.

Udhëzimi parashikon se në qoftëse në procedurën e përzgjedhjes konstatohen elemente që lënë të dyshohet për një viktimë të trafikimit apo viktimë të mundshme të trafikimit, autoriteti vendor për trajtimin e të huajve, në zbatim të Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit (VKM nr.499, datë 29.08.2018), njofton menjëherë strukturat e kundër trafikeve të paligjshme në Drejtorinë Vendore të Policisë dhe dorëzon të huajin kundrejt procesverbalit të dorëzimit.

Në përputhje me ligjin për të huajt, viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit mbahen në qendrat pritëse dhe riintegruese shtetërore dhe joshtetërore, në kuadër të bashkëpunimit me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin i jep përparësi ekzekutimit të kthimit vullnetar, sidomos për disa kategori personash, ku përfshihen edhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, që duan të kthehen në vendin e tyre të origjinës.

13. How do your country’s legislation and practice ensure that there is an individual assessment of protection needs at the borders prior to any refusals of entry or expulsions?

Oficerët e policisë kufitare dhe migracionit (hyrjes) në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar procedurat e screening, sigurojnë një vlerësim individual në kufi, duke respektuar kështu parimin e “mos-kthimit”.

14. What measures are taken to prevent THB in sports? What sectors and categories/groups of people have been identified as being at risk?

Gjatë periudhës raportuese nuk ka asnjë rast të identifikuar si viktimë apo viktimë e mundshme trafikimi në sektorët/klubet/grumbullimet sportive. Procedurat parashikojnë ndërhyrje të specializuara sektoriale dhe ndërsektoriale/multidisiplinore. Zbatimi i tyre është detyrim i të gjitha institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe lokal që punojnë në vend apo janë me mision shtetëror jashtë vendit. Veprimi në përputhje me këto procedura është gjithashtu detyrim edhe i gjithë agjencive joshtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në çdo moment në të cilin ato, gjatë veprimtarisë së tyre (përfshirë veprimtarinë dhe aktivitetet sportive), bien në kontakt me një person që dyshojnë se mund të jetë trafikuar apo informohet tek ata se është viktimë/viktimë e mundshme trafikimi, duhet të vihen menjëherë në kontakt dhe të konsultohen me Autoritetin Përgjegjës.

15. Have you identified online practices that may increase the risk of becoming a victim of THB for different forms of exploitation? What mechanisms have been developed to prevent the misuse of information and communication technology for THB purposes? What is the practical effect of their implementation?

Mjetet më evidente të rekrutimit të përdorur nga trafikantët janë aplikacionet si Instagram, snap chat, FB. Mediat sociale po përdoren gjithnjë e më shumë si një mjet nga trafikantët meshkuj për të identifikuar viktimat e reja gra/vajza me të cilat mund të krijojnë një marrëdhënie të rreme përpara se të trafikojnë gratë dhe vajzat për shfrytëzim seksual në Shqipëri apo gjetkë.

Autorët femra luajnë një rol kyç në veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore: ato veprojnë si mikesha e viktimës, por më pas i joshin ato në vendin e shfrytëzimit. Shumë autore femra janë vetë ish-viktima të trafikimit.

Trafikantët përdorin zakonisht softuerin GPS në telefona për të gjurmuar lëvizjet e viktimave ose, në rastin e robërisë shtëpiake dhe formave të tjera të shfrytëzimit të punës, monitorojnë dhe kontrollojnë viktimat përmes vëzhgimit me video.

Për adresimin e kësaj problematike, me Urdhër të Ministrit të Brendshëm Nr.494, datë 30.12.2020 është miratuar “Strategjia për hetimin e krimeve kibernetike dhe Plani i Veprimit 2021-2025”. Në përmbushje të angazhimeve të strukturave të hetimit kibernetik në Policinë e Shtetit, si dhe në koherencë të plotë me zhvillimet strategjike të vendeve të zhvilluara, për një mjedis kibernetik sa më të sigurt, kjo strategji mbështetet në këto parime themelore:

- Zbatimi i ligjit në hapësirën kibernetike;
- Mbrojtja e të drejtave themelore, liria e shprehjes, të dhënave personale dhe privatësisë;
- Përgjegjësi e përbashkët në garantimin e qasjes së sigurtë në hapësirën kibernetike;
- Bashkëpunim me partnerët për ndërveprim efikas ndaj krimeve kibernetike.

Strategjia e Hetimit të Krimit Kibernetik përcakton detyrimet e policisë së shtetit, për të bërë të mundur ngritjen dhe zhvillimin e mekanizmave të duhur institucionalë, me qëllim rritjen e nivelit të përgjigjes ndaj krimeve kibernetike në vend, por dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtarë. Në strategji parashikohen hapat konkretë që do të ndiqen në lidhje me krimet kibernetike dhe, në veçanti, me problematikat e fëmijëve në mjedisin digjital. Një ndër objektivat e saj është reagimi i shpejtë dhe profesional për parandalimin, ndjekjen dhe hetimin e krimeve kibernetike ndaj fëmijëve në hapësirën kibernetike dhe rritja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e hetimit të krimit kibernetik me partnerët strategjikë.

Strategjia parashikon masa specifike sa i takon parandalimit të abuzimit seksual të fëmijëve në internet nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit të fëmijëve dhe aktorëve që kanë në fokus të punës së tyre fëmijët; - forcimit të kuadrit ligjor për parandalimin, ndjekjen dhe goditjen e krimeve kibernetike ndaj fëmijëve në internet; - hetimit efektiv dhe sjelljes para drejtësisë e autorëve të krimeve kibernetike ndaj fëmijëve

me fokus abuzimin dhe shfrytëzimin seksual; - rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit tek të gjithë aktorët e shoqërisë për krimet kibernetike ndaj fëmijëve; dhe - forcimit të bashkëpunimit ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve ndaj krimeve kibernetike.

16. What measures are taken to raise awareness of the risks of technology-facilitated THB, including among children, parents, teachers, child care professionals and social workers? What technology-based initiatives exist in your country to disseminate information to groups/communities at risk of THB?

Në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2018-2020 dhe 2021-2023, në vijim të një tradite pozitive të krijuar ndër vite, gjatë muajit tetor nominuar “Muaji Antitrafik”, strukturat shtetërore dhe joshtetërore kanë organizuar takime informuese dhe ndërgjegjësuere me fëmijët, gratë, grupe vulnerabël, lidhur me fenomenin e trafikimit, mënyrat e raportimit të rasteve, pasojat e trafikimit, etj.

Për sa i takon masave për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës në mjedisin digital, në bashkëpunim me AKCESK janë realizuar takime me profesionistë duke përfshirë prokurorinë dhe policinë lidhur ndëshkimin e rasteve të abuzimit online. Në këto takime morën pjesë 76 profesionistë. Janë organizuar trajnime dhe takime për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet për fëmijët në mjedisin kibernetik. Morën pjesë rreth 210 fëmijë dhe 70 profesionistë.

Në vitin 2021, Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me OSBE-në organizuan trajnimin e parë simulues, ku morën pjesë përfaqësues të strukturave shtetërore (policia, prokuroria, shërbimi social, punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, ofruesit e shërbimeve, anëtarë të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe Autoritetit Përgjegjës, me qëllim për të identifikuar nevojat institucionale në lidhje me identifikimin, hetimin dhe ndjekjen penale. Në këtë workshop teknik morën pjesë 60 përfaqësues të strukturave të sipërcituara, ku, nën drejtimin e ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë, për të mbledhur të dhëna mbi sfidat e hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore.

KKSAT ka kontribuar në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, nëpërmjet sesioneve informuese, edukative me të rinjtë në shkollat 9-vjeçare, të mesme dhe universitetet dhe gjithashtu me komunitetin. Organizatat e KKSAT përdorën strategji të ndryshme marketingu për të shpërndarë informacionin në komunitetet urbane dhe rurale nga veriu në jug, duke përdorur kanale të ndryshme, si mesazhet në mediat sociale, prezantimet televizive lokale dhe kombëtare, shpërndarja e fletushkave me informacion, takime ballë për ballë, forume publike dhe takime.

ARSIS, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Autoritetin Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike po zbatojnë një projekt, i cili ka për qëllim të krijojë një mjedis të sigurt kibernetik për fëmijët, duke rritur ndërgjegjësimin brenda shoqërisë, duke fuqizuar fëmijët dhe të rinjtë dhe duke rritur kapacitetet profesionale të institucioneve arsimore, policisë, sektorit privat dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit me qasje ndërsektoriale.

Ai synon të informojë dhe fuqizojë fëmijët dhe të rinjtë për t'u përfshirë në programet e sigurisë kibernetike brenda komuniteteve të tyre, të koordinuara me shkollat (stafi akademik dhe psikosocial), përfaqësuesit e komunitetit (prindërit) dhe të mbështetur nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në Bashkitë Elbasan, Durrës, Krujë, Tiranë dhe AKCESK.

Anëtarët e komunitetit, veçanërisht ata që jetojnë në zona të largëta ose të pashërbyera, përfitojnë nga sesionet informuese mbi normat e dëmshme sociale, trafikimin dhe shfrytëzimin online dhe gjuhën e

urrejtjes. Kjo njohuri do t'i ndihmojë ata të jenë më vigjilentë për rreziqet dhe përfitimet e internetit për fëmijët në situata të ndryshme.

Për më tepër, profesionistë të tillë si punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, ekipet psiko-sociale të shkollave, oficerët e policisë dhe profesionistët e vijë së pare do të forcojnë njohuritë e tyre për t'iu përgjigjur rasteve të identifikuara të fëmijëve në rrezik, si dhe masave parandaluese. Këta profesionistë do të rrisin gjithashtu koordinimin dhe ndërveprimin për të krijuar një mjedis të sigurt kibernetik dhe për të promovuar modele pozitive në trajtimin e rasteve të shfrytëzimit të fëmijëve në internet.

17. How do you cooperate with ICT companies and Internet service providers, including content hosts and social media, in preventing THB?

Në dhjetor 2023, në bashkëpunim me AKEP dhe me 2 operatorët telefonikë (ONE dhe VODAFONE), Linja Kombëtare falas 116006 u aktivizua dhe kaloi nga salla operative e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit pranë Sektorit të Antitrafikut në Ministrinë e Brendshme. Një punonjës i stafit, disponon dhe pret vetëm thirrjet hyrëse për numrin 116006.

Me qëllim promovimin e Linjës dhe ndërgjegjësimin e komunitetit ndaj fenomenit të trafikimit, më datë 23 janar 2024, u prezantua fushata e komunikimit antitrafik “E vërteta N’Ndrit” 116 006, si pjesë e programit “Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria”, i cili financohet nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe zbatohet nga UNICEF në Shqipëri. Qëllimi kryesor i kësaj fushate është reduktimi i trafikimit të qenieve njerëzore brenda dhe nga Shqipëria nëpërmjet parandalimit të dukurisë, mbrojtjes dhe shërbimeve për riintegrimin e të mbijetuarve, si dhe fuqizimin e partneriteteve të koordinuara antitrafik. UNICEF ka përgatitur fushatën e komunikimit të Programit Antitrafik, në konsultim të ngushtë me Ministrinë e Brendshme, Ambasadën Britanike në Tiranë dhe me partnerët zbatues të programit. <https://mb.gov.al/prezantohet-fushata-e-komunikimit-antitrafik-e-verteta-nndrit-160-006/>

18. How are policies and practices aimed at preventing THB informed by the experiences of victims and at-risk individuals?

Në prill 2019, u nënshkrua Marrëveshja ndërmjet Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik “Mbi Ngritjen dhe Funksionimin e Bordit Këshillimor për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit (Nr. 2931 Prot, datë 08.04.2019). Në datë 30 maj 2019 u ngrit Bordi Këshillimor për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit me 3 anëtarë. Në zbatim të Marrëveshjes, u hartua Rregullorja e Bordit, Deklarata e Konfidencialitetit dhe Deklarata e Pëlqimit.

Bordi ka për qëllim:

- Krijimin e një mekanizmi këshillimor gjithëpërfshirës dhe me rol aktiv të vetë viktimave të trafikimit që janë riintegruar/në proces riintegrimi;
- Rritjen e partneritetit të institucioneve shtetërore me shoqërinë civile në ndërgjegjësimin, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave;
- Konsolidimin e bashkëpunimit dhe krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm të koordinimit me pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe më gjerë.
- Rritjen e përfaqësimit të viktimave të trafikimit në të gjitha fazat e vendimmarrjes dhe hartimit të politikave dhe programeve për parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave.

Me qëllim adresimin e problematikave të evidentuara nga vetë viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit dhe përfshirjen e tyre në hartimin e politikave dhe vendimmarrjeve antitrafikim, në

Marrëveshjen për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (nënshkruar më datë 26.06.2023) është parashikuar një nen i posaçëm dedikuar për angazhimin e Bordit Këshillimor dhe konkretisht: Neni 12 “Konsultimi me Bordin Këshillimor të Viktimave të Trafikimit”, i cili citon: Në zbatim të parashikimeve të Marrëveshjes ndërmjet Koordinatorit Kombëtar për çështje të luftës kundër trafikimit të personave dhe Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik, rekomandimet e dhëna nga viktimat në takimet konsultative i paraqiten anëtarëve të MKR-së në mbledhjen e planifikuar pasardhëse.

II. IDENTIFICATION OF VICTIMS AND PROTECTION OF THEIR RIGHTS (Articles 10, 11, 12, 14 and 16)

19. Among the victims of THB identified, were any subjected to exploitation on the basis of their sexual orientation and/or gender identity (LGBTI+: lesbian, gay, bisexual, transgender or intersex), especially teenagers and young adults? If yes, did any of them report on police misconduct?

KKSAT raporton se, asnjë rast nuk është identifikuar si viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme e trafikimit e shfrytëzuar në bazë të orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor (LGBTI, lezbike, gay, biseksual, transgjinor ose nderseksual).

Gjatë punës praktike të organizatës ARSIS në ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe emergjente, janë identifikuar raste të të miturve dhe të rinjve që janë vlerësuar si viktima të mundshme trafikimi në kushte vulnerabiliteti të lartë për shkak të orientimit seksual dhe deklaramit si transgjinorë. Por nuk ka pasur asnjë raportim nga ana e tyre për sjellje të pahijshme të policisë.

20. What specific measures are taken to ensure that trafficked persons who are migrant workers, including in an irregular situation, are identified as victims of THB and have access to the rights provided for in the Convention? Is there cooperation with specialised NGOs, trade unions, and employers to enhance the identification and protection of potential victims within these at-risk groups?

Sipas ligjit për të huajt, kur i huaji i është nënshtruar kushteve të punës shfrytëzuese në Republikën e Shqipërisë dhe bashkëpunon në një proces penal kundër punëdhënësit deri në përfundim të procesit dhe i huaji përfiton masën e dëmshpërblimit të tij që është e përcaktuar nga procesi, ai mund të pajiset me leje qëndrimi për arsye humanitare (neni 52, Ligji për të Huajt).

Ligji për të huajt parashikon për viktimat e trafikimit një leje të veçantë, lejen e qëndrimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (shpjeguar në pyetjen 11). Autoriteti vendor përgjegjës për kufirin dhe migracionin i lëshon një leje qëndrimi të përkohshme një të huaji që është viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit. I huaji, të cilit i jepet leje qëndrimi e përkohshme, gëzon të drejtat e qëndrimit dhe lëvizjes brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të garantuara, sipas procedurave standarde. Ai bashkëpunon me organet përgjegjëse për përcaktimin e identitetit të tij, por mungesa e provave që vërtetojnë identitetin e tij nuk mjafton si bazë për refuzimin e lëshimit të lejes së përkohshme të qëndrimit. I huaji përfiton kujdes shëndetësor, ndihmë financiare, mbështetje, si dhe të drejtën e punës nëse përfiton sipas dispozitave ligjore në fuqi. I huaji me statusin e viktimës së mundshme të trafikimit ka të drejtën e punësimit pa marrë më parë miratimin nga AKPA dhe punëdhënësi duhet të njoftohet për marrëdhënien e punës (Neni 53, Ligji për të Huajt).

Në rastet kur i huaji duhet të largohet, autoriteti vendor përgjegjës për kufirin dhe migracionin i jep përparësi ekzekutimit të kthimit vullnetar të asistuar, viktimave të trafikimit që duan të kthehen në vendin e tyre të origjinës, si dhe të huajve që kapen duke punuar ilegalisht në territorin e Republikës

së Shqipërisë por që nuk ka sjellë pasoja të dëmshme për rendin dhe sigurinë publike dhe që deklaroi se do të largohet vullnetarisht nga territori (Neni 101, Ligji për të Huajt).

Për periudhën raportuese nuk ka pasur raste të denoncuara për personat e trafikuar që janë punëtorë migrantë, përfshirë edhe në një situatë të parregullt.

Ekziston një bashkëpunim efektiv ndërmjet organizatave partnere për identifikimin, referimin dhe ndihmën e punëtorëve migrantë që mund të jenë persona të trafikuar.

Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit kanë hartuar dokumentin për rishikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat e bashkëpunimit për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë”.

Qëllimi i këtij memorandumi është rritja e masave parandaluese për identifikimin proaktiv si dhe mbrojtjen e viktimave të punës së detyruar dhe trafikimit. Fokusi kryesor i memorandumit është zbatimi i parimit të ligjshmërisë për ndalimin e punës së detyruar, mbrojtjen e të dhënave personale, respektimin e të drejtës së lirisë së lëvizjes, mbrojtjen shoqërore të punës, mosdiskriminimin, si dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve.

Nëpërmjet këtij dokumenti, përcaktohen përgjegjësitë dhe angazhimet e secilës palë gjatë punës së përbashkët për parandalimin, identifikimin proaktiv dhe mbrojtjen e viktimave të punës së detyruar dhe trafikimit, si dhe rregullimi i marrëdhënieve dhe modaliteteve ndërmjet strukturave të përfshira në të. Memorandumi do të kontribuojë në vendosjen e një bashkëpunimi të ngrushtë midis institucioneve palë në të, me qëllim shmangien e vonesave në shkëmbimin e informacionit, por edhe ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta me qëllim parandalimin dhe identifikimin e rasteve të shfrytëzimit në punë.

21. What measures are in place to encourage victims of THB to report their situation to the authorities and/or civil society organisations?

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.08.2018 “Për miratimin e procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit” ngarkon me përgjegjësi dhe detyrim ligjor një sërë institucioneve publike, si: policia e shtetit, sistemi shëndetësor, sistemi arsimor, inspektorati i punës, shërbimi social shtetëror, shërbimet sociale në bashki, misionet diplomatike, njësitë lëvizëse, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, OJQ-të, etj) që të raportojnë nëse një person është viktimë e mundshme trafikimi. Procedurat Standarde të Veprimit nënkuptojnë ndërhyrje të specializuara sektoriale dhe ndërsektoriale/multidisiplinore dhe zbatimi i tyre është detyrim i të gjitha institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe vendor që punojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo janë me mision shtetëror jashtë vendit, si dhe bashkëpunimin me strukturat analoge të shteteve të huaja. Zbatimi i Procedurave Standarde është i detyrueshëm edhe për agjencitë joshtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, në çdo moment në të cilin ato, gjatë veprimtarisë së tyre, bien në kontakt me një person që dyshojnë se mund të jetë trafikuar apo kanë informacion se është person i trafikuar.

Linja Kombëtare falas 116 006 është e aksesueshme nga çdo telefon, ku, nëpërmjet të cilit kushdo që është në një situatë shfrytëzimi ose dyshon për dikë në një situatë të tillë mund të kërkojë ndihmë drejtpërdrejt dhe mund të raportojë për rastin.

Një masë tjetër është ngritja e Njësive Lëvizëse në 9 qarqe të Shqipërisë, funksioni i të cilave është të identifikojë dhe referojë rastet, si dhe të ndërgjegjësojë dhe informojë individët, grupet dhe komunitetet për çështjet e trafikimit (p.sh. informacion se çfarë është trafikimi i qenieve njerëzore, format e shfrytëzimit, metodat e rekrutimit, grupet e rrezikuara, si të mbrohen, ku të raportojnë dhe të kërkojnë ndihmë).

Viktimave të trafikimit u ofrohet gjithmonë një mjedis fizik i sigurt si përpara ashtu edhe gjatë trajtimit të tyre. Pas përshtatjes së rastit me mjedisin dhe vendosjes së një marrëdhënie besimi me psikologun dhe avokatin e qendrave pritëse, viktimës i ofrohet mbështetje, siguri dhe inkurajim gjatë dhënies së informacionit.

22. What specific measures are taken in your country to detect/identify and refer to assistance possible victims of THB at the borders? What measures are taken in your country to identify victims of THB during the examination of asylum applications and prior to the return of persons whose applications are rejected?

Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit” (VKM nr. 499, datë 29.08.2018), ka për qëllim përcaktimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen në kohën dhe mënyrën e duhur të personave të trafikuar, të rritur apo të mitur, për të gjithë llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar.

Fokusi kryesor i këtyre procedurave është viktimat dhe mbrojtja e saj, duke shqyrtuar çdo situatë rast pas rasti dhe duke ndërtuar disa standarde të pranuar nga të gjithë për mënyrën sesi do të zhvillohet i gjithë procesi i identifikimit, referimit dhe më pas, i mbrojtjes së viktimës së trafikimit. Këto procedura zbatohen për të gjitha kategoritë e viktimave/viktimave të mundshme (të mitur dhe të rritur, femra dhe meshkuj, shqiptarë dhe të huaj) që janë subjekt i trafikimit për të gjitha llojet e shfrytëzimit.

Procedurat parashikojnë situata në të cilat vendi ynë, apo zona të caktuara të vendit, përdoren, apo mund të përdoren si vend origjine, tranziti dhe destinacioni për lëvizjen dhe shfrytëzimin e personave të trafikuar shqiptarë dhe të huaj, si edhe situata në të cilat personat e trafikuar me shtetësi shqiptare, apo të hamendësuar shqiptare ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në pikën 4 të PSV-ve “Përkufizime”, Mbrojtja e personave të trafikuar, përfshin të gjitha veprimet e kryera nga punonjës të institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore, si dhe të institucioneve joshitetërore-anëtare ose jo të Mekanizmit Kombëtar të Referimit për pritjen, identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe ndihmën për rehabilitimin dhe ri-integrimin e sigurt të personave të trafikuar në përputhje me këto procedura. Të gjithë institucionet e ngarkuara në këtë dokument kontribuojnë në mbrojtjen, në të gjitha momentet, që nga identifikimi deri tek ri/integrimi i plotë i personave të trafikuar, por për lehtësi të kuptuarit dhe orientimit në dokument, mbrojtja përfshin:

- Identifikim dhe reagim fillestar;
- Identifikim formal;
- Planifikim dhe Mbështetje për Riintegrim;
- Planifikim dhe Mbështetje për Kthim Vullnetar të Asistuar;
- Pritje e personave të trafikuar me shtetësi shqiptare;
- Kthim vullnetar i asistuar për shtetasit e huaj;

- Mbështetje e hetimit dhe dënimit të trafikantëve.

Sipas PSV-ve, “Identifikim dhe Reagim Fillestar” është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, vendore dhe qendrore, përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë, brenda dhe jashtë territorit të RSH-së, që përcaktojnë se një person i/e mitur apo i/e rritur është viktimë e mundshme e trafikimit të personave. Këto veprime duhet të përfshijnë: 1. vlerësimin e situatës së personave kundrejt treguesve të trafikimit; 2. vlerësimin e potencialit/mundësive të institucionit/organizatës për ta nxjerrë menjëherë personin nga situata e shfrytëzimit; 3. ndërhyrjen për ta nxjerrë menjëherë personin nga situata e shfrytëzimit/ ndërprerjen e shfrytëzimit (vetë apo nëpërmjet punonjësve të policisë së shtetit); 4. Informimin e personit për gjykimin e punonjësit mbi situatën e tij/saj, të drejtat dhe ndihmën që mund të japë vetë institucioni për viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e trafikimit ose mënyrat e qasjes tek ndihma e institucioneve të mbrojtjes së viktimave; 5. Njoftimin e Anëtarit Përkatës të Autoritetit Përgjegjës (APAP) ose drejtuesit/ Kryesuesit të Autoritetit Përgjegjës (D/KAP) dhe komunikimin me të lidhur me vendosjen e personit në një mjedis të sigurt që i plotëson nevojat e tij/ saj të menjëhershme; 6. Mbështetjen e vendosjes së personit në një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm; 7. Vlerësimi i situatës shëndetësore dhe referimi tek strukturat shëndetësore; 8. Plotësimin e dokumentacionit të identifikimit fillestar dhe dërgimin e tij tek anëtari përkatës i AP-së; 9. Mbështetjen e procesit të identifikimit formal; 10. Mbështetjen e hetimit dhe kapjes së trafikantëve; 11. Vijimësinë e mbrojtjes.

Në kufijtë e RSH-së agjencia përgjegjëse për identifikim fillestar është Policia e Kufirit (të gjelbër dhe blu). Në territorin e RSH-së agjencitë përgjegjëse për identifikim fillestar janë agjencitë shtetërore dhe joshtetërore, përfshirë: KKSAT, qendrat e përkujdesjes shoqërore për persona në nevojë, organizatat me programe të ndihmës për persona në nevojë, zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror në qarqe, strukturat e policisë së shtetit, inspektorati shtetëror i punës, shkollat dhe institucionet arsimore, institucionet e kujdesit shëndetësor, strukturat e shërbimeve sociale në bashki. Jashtë territorit të RSH-së, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit me shtetësi shqiptare, janë punonjësit e përfaqësive diplomatike të RSH-së, si dhe agjenci të tjera shtetërore dhe joshtetërore me veprimtari në fushën e mbrojtjes së viktimave të trafikimit.

Identifikimi formal është identifikimi i një personi si viktimë trafikimi i kryer vetëm nga Grupi/Struktura Përgjegjëse për Identifikim Formal (G/SPIF) në bazë të formatit të intervistës formale, e cila kryhet me vullnetin e vetë viktimës dhe, kur ajo është e gatshme për ta kryer atë. Identifikimi formal përfshin minimalisht: 1. Ndërhyrjen e menjëhershme të Sektorit për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm për kryerjen e Intervistës formale kur njoftohet nga agjencia referuese apo kur vetë viktimat e mundshme e trafikimit shpreh vullnetin pranë strukturave të policisë së shtetit për të kryer intervistën formale; 2. përcaktimin nëse personi është i/e trafikuar, nëpërmjet mbledhjes dhe analizës së informacionit të dhënë nga vetë personi; 3. vlerësimin në mënyrë të thelluar të nevojave të personit viktimë e trafikimit për ndihmë dhe mbrojtje; 4. dhënien e udhëzimeve dhe sigurimin e qasjes së personit të trafikuar tek ndihma e përshtatshme dhe e sigurt; 5. grumbullimin e informacionit dhe nisjen e hetimeve për penalizimin e trafikantëve; 6. intervista formale/vërtetimi i statusit të personit si i/e trafikuar kryhet veçmas në kohë nga kallëzimi (edhe nëse personi dëshiron të bëjë kallëzim, në asnjë rast, intervista formale nuk ndërpritet për të marrë kallëzimin, por caktohet një kohë tjetër).

Agjencia/institucioni përgjegjës për identifikimin formal është Grupi/Struktura Përgjegjëse për Identifikimin Formal në kufijtë dhe territorin e RSH-së (G/SPIF)(ad hoc) që kryen intervistimin formal të personave që identifikohen si viktimat e mundshme të trafikimit, e përbërë nga një punonjës i policisë së shtetit i seksionit të luftës kundër trafikëve të paligjshme (SLKTP) dhe punonjësi i mbrojtjes

së fëmijëve/NJMF në bashki/njësi administrative për çdo rast të të miturve dhe një punonjës social shtetëror i zyrës rajonale të shërbimit social shtetëror (ZRSHTSSH) dhe një punonjës i policisë së shtetit i seksionit të luftës kundër trafikëve të paligjshme (SLKTP) për të rriturit.

Procesi i referimit të viktimave të trafikimit shprehet qartë në Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit. Bazuar në këto procedura, pas identifikimit, referimi bëhet në bazë të nevojave të viktimave, vlerësimit të rrezikut dhe vullnetit të tyre. Gjithë procesi menaxhohet nga Autoriteti Përgjegjës dhe mbështetet nga stafi i qendrave pritëse dhe riintegruese dhe nga strukturat shtetërore dhe joshtetërore.

23. What measures are taken in your country to identify victims of THB in immigration detention centres and prisons?

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si institucion përgjegjës për administrimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve me burgim, ka përcaktuar në misionin dhe vizionin e saj filozofinë e humanizmit, duke nënkuptuar trajtimin dinjitoz dhe garantimin e të drejtave të njeriut për qytetarët e burgosur, për arsye të procedimit penal ose për të vuajtur një dënim të formës së prerë lidhur me një krim. Mbrojtja e të drejtave të njeriut ka qenë subjekt i reformave të vazhdueshme nga institucionet e shtetit shqiptar për t'i konkretizuar ato dhe ka qenë gjithmonë një kriter themelor për vlerësimin e performancës dhe standardeve të menaxhimit dhe trajtimit të zbatimit të ligjit. Për sa i përket identifikimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, stafi i burgut ka programe ndërhyrjeje dhe terapeutike për rehabilitimin e autorëve të veprave penale. Njëkohësisht, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, prej tre vitesh zbatohet moduli “Ura e Drejtësisë Restauruese”. Ky modul trajton qasjen e shkelësit ndaj viktimës dhe rikuperimin e viktimave. Ky program është zhvilluar në bazë të programit të BE-së "Drejtësia Restorative". Kjo qasje zbatohet edhe për viktimat e tjera, si dhuna në familje, dhuna seksuale, etj.

24. What services are available in your country to provide specific assistance to particularly vulnerable victims, such as:

- a. persons with disabilities;

Ligji nr.121/2016 “Për Shërbimet Sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM nr.518/2018 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Komunitar dhe Rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, përcaktojnë shërbimet e specializuara për të gjitha kategoritë, si: fëmijët në konflikt me ligjin, personat me aftësi të kufizuar, gratë dhe vajzat e dhunuara, ose të trafikuar dhe të gjitha kategoritë që kanë nevojë për shërbime të tilla, duke përfshirë personat LGBTI, personat me aftësi të kufizur, viktimat me trauma të rënda mendore dhe fizike, personat e pastrehë, etj.

- b. LGBTI+ persons;

Ekziston një strehë që ofron shërbime strehimi për komunitetin LGBTI, si dhe një organizatë e quajtur STREHA që kujdeset për të rriturit LGBTI.

Për më shumë se 5 vjet, MSHMS ka financuar edhe strehën LGBTI pasi ka pasur raste të abuzimit seksual, dhunës dhe trafikimit ndaj personave LGBTI. Në spitalin e Tiranës, qendra Liliu ofron ndihmë për viktimat e dhunës, përfshirë ato seksuale dhe viktimat trafikimi. Një ndihmë e tillë ofrohet për burrat, djemtë, vajzat dhe gratë, pra për të gjithë individët.

Two one Stop (2 Qendra me një ndalesë) - janë qendra shërbimi të përshtatura për fëmijët viktime të dhunës seksuale dhe formave të tjera të rënda të dhunës, (me bazë klinike) të krijuara në Spitalet Rajonale të Fierit dhe Shkodrës (që mbulojnë përkatësisht veriun dhe jugun e vendit). Ky grup fëmijësh përfiton nga shërbimi i urgjencës, i projektuar si një qendër e integruar, me një ndalesë, 24/7, për shërbimet e kujdesit shëndetësor afatshkurtër, përfshirë këshillimin dhe terapinë në rastet e traumës. Për t'i ofruar fëmijës këto shërbime, Qendra bashkëpunon me strukturat spitalore dhe me institucione apo struktura të specializuara. Prindërit/kujdestarët janë gjithashtu përfitues të Modelit të Shërbimit që ofrojnë informacion, këshillim dhe mbështetje në rast krize. Shërbimet në Qendër ofrohen pa pagesë dhe mbuloohen nga buxheti i Qendrës. Qendra financohet nga buxheti i spitalit.

Qendra ofron shërbimet e mëposhtme: 1. ndihma e parë dhe kujdesi emergjent; 2. mbështetje për krizën; 3. mbështetje dhe këshillim i specializuar mjekësor; 4. këshillim të specializuar psikologjik dhe ndërhyrje terapeutike; 5. transport i sigurt; 6. referimi dhe bashkëpunimi me Sistemin e Mbrojtjes së Fëmijëve.

Gjithashtu, janë krijuar 2 linja kombëtare të ndihmës online, për fëmijë dhe të rritur, si meshkuj dhe femra, dhe ofrohet ndihmë nga buxheti i shtetit për individët që mund të kenë përjetuar abuzim seksual, dhunë në familje dhe trafikim.

c. victims with children;

Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës menaxhojnë dhe monitorojnë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë fëmijë VT/VMT. Në zbatim të PSV-ve, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve është pjesë e intervistës formale për fëmijët, dhe, në rastet kur fëmija rezulton VT/VMT merr rastin në mbrojtje sipas legjislacionit në fuqi, duke zbatuar hapat dhe planin individual për menaxhimin e rastit. Pas identifikimit dhe vlerësimit të rastit, përmes vizitave në familje, NJMF mbledh aktorët e nevojshëm dhe realizon mbledhjen e Grupit Teknik Ndërsektorial dhe së bashku hartojnë planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës. Me pjesëmarrjen e profesionistëve nga arsimi, policia, zyra e punës, shërbimi social rajonal, shërbimi social në bashki, shëndetësia dhe OJF-të që operojnë në atë bashki, mbledhen për të diskutuar për dhënien e ndihmës për fëmijen dhe familjen. Çdo shërbim ofrohet nga NJMF-të duke patur në fokus fëmijën. Paketa e shërbimeve që iu ofrohet viktimave të trafikimit përfshin, si më poshtë:

- vizita në familje dhe vlerësime psikologjike, sociale dhe ekonomike;
- shërbime imediate për fëmijët;
- strehim;
- veshmbathje;
- këshillim psikologjik;
- regjistrim në gjendje civile;
- kujdes shëndetësor;
- regjistrim në shkollë/ ndihmë për ri-futjen në sistemin shkollor;
- shërbime mbështetëse për fëmijët dhe familjen (mbështetje me paketa ushqimore, paketa higjeno-sanitare, ndërmjetësim për punësim, shërbim psiko-social, ndërmjetësim dhe asistim në kryerjen e vizitave mjekësore, shërbim ligjor falas, trajnim profesional dhe zhvillim të aftësive për jetën gjatë riintegritimit).

d. victims with severe mental and physical trauma;

Në sistemin e kujdesit shëndetësor publik, çrregullimet e shëndetit mendor trajtohen në nivele të ndryshme të kujdesit shëndetësor. Në nivel komunitar shërbimet e shëndetit mendor ofrohen në Kujdesin Parësor Shëndetësor, nga ekipi i mjekëve të familjes, pjesë e qendrave social-shëndetësore

(të përbërë nga mjekë të përgjithshëm/mjekë të familjes, infermierë, staf psiko-social). Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor janë shërbime të specializuara ambulatorie të shëndetit mendor, me grupet kryesore të synuara personat me çrregullime të rënda të shëndetit mendor. Këto shërbime janë hallka kryesore e sistemit të referimit nga Kujdesi Shëndetësor Parësor tek shërbimet e shëndetit mendor të spitalit. Shërbimet e specializuara të shëndetit mendor ofrohen nëpërmjet ekipeve multidisiplinare, të përbëra nga psikiatër/psikiatër fëmijë dhe adoleshent, psikolog, punonjës social, terapist pune, logoped, infermiere etj.).

Një tipologji e rëndësishme shërbimesh për personat me çrregullime kronike të shëndetit mendor janë Shtëpitë e Mbështetura. Ato janë njësi funksionale të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor me bazë komunitare, të cilat synojnë të ofrojnë shërbime rezidenciale për individët në një mjedis familjar, ku synimi kryesor është kujdesi dhe rehabilitimi i individëve me çrregullime të shëndetit mendor. Procesi i rehabilitimit kryhet nëpërmjet planit individual të bazuar në kontinuumin terapeutik-rehabilitues, si dhe nëpërmjet strehimit të mbështetur pjesërisht ose plotësisht me personel. Shtëpitë e mbështetura janë pjesë e rrjetit të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor, në lidhje të ngushtë me shërbimet e tjera shëndetësore dhe sociale të zonës përkatëse.

Ndërkohë, shërbimet e specializuara të shëndetit mendor spitalor përfshijnë ofrimin e shërbimit 24 orë në nivel dytësor dhe terciar të kujdesit shëndetësor, pranë spitaleve të përgjithshme apo në spitale të specializuara, të cilat organizohen dhe funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet spitalore dhe shëndetësore. Shërbimet spitalore të shëndetit mendor janë për njerëzit që nuk mund të mbështeten më tej në shtëpi dhe duhet të shtrohen në spital për shkak të problemeve të rënda të shëndetit mendor. Përveç shërbimeve të urgjencës dhe fazave akute të ofruara nëpërmjet shërbimeve të pranimit në spital, shërbimet e trajtimit/rehabilitimit ofrohen edhe përmes pavijoneve për pacientët sub-akut që kanë nevojë për trajtim më të gjatë se ai i parashikuar në funksionet e shërbimit të pranimit.

e. homeless persons;

ARSIS administron Shërbimin e Strehimit të Sigurt Emergjent, duke ofruar mbështetje për fëmijët dhe familjet që përballen me situata me rrezik të lartë (ngritur me mbështetjen e bashkisë së Tiranës dhe UNICEF-it në Shqipëri në vitin 2011). Ky shërbim ofron strehim, këshillim, mbështetje psiko-sociale dhe ndihmë të përgjithshme deri në 11 ditë. I vendosur në ambientet e Shtëpisë së Ngjyrave, objekti përbëhet nga pesë dhoma gjumi me gjithsej 20 krevate, të organizuara në mënyrë strategjike për të akomoduar grupe të ndryshme, duke siguruar ndarje sipas gjinisë dhe moshës. Për më tepër, një dhomë e dedikuar me një infermiere të caktuar është në dispozicion për të ofruar vlerësime dhe ndihmë mjekësore fillestare.

Rastet urgjente të mbrojtjes së fëmijëve trajtohen nga një ekip i specializuar profesionistësh, duke përfshirë një psikolog, një punonjës social dhe një menaxher të rasteve 24/7 në dispozicion. Për të adresuar nevojat specifike të secilit rast, ky ekip koordinon transportin e sigurt drejt destinacioneve thelbësore, si: qendrat shëndetësore dhe komisariatet e policisë për intervista ose procedura të tjera të kërkuara. Për më tepër, ekipi lehtëson lidhjet me punonjësin e mbrojtjes së fëmijës dhe policinë, duke siguruar ndihmë gjithëpërfshirëse të përshtatur me rrethanat unike të çdo individi ose familjeje.

Pas referimit të një fëmije viktimë në Shërbimet e Strehimit të Sigurt Emergjent nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve, komisariatit ose strukturave të tjera përkatëse, dhe pas një qëndrimi deri në 11 ditë në strehë (siç përcaktohet zakonisht nga grupi teknik ndërsektorial), merret një vendim. Grupi teknik ndërsektorial vendos nëse fëmija viktimë duhet të shoqërohet në një institucion rezidencial përkujdesjeje, një strehë të specializuar për VT/VMT. Në rastet kur, ka pasur ndryshime pozitive në kushtet e familjes dhe nuk identifikohen kërcënime të vazhdueshme ose faktorë rreziku, fëmija mund

të kthehet në shtëpinë e tij. Vendimi merret me kujdes, duke pasur në konsideratë interesin më të lartë dhe sigurinë e fëmijës.

Shërbimi i urgjencës i ofruar nga Nisma ARSIS respekton në mënyrë rigoroz standardet e përcaktuara për Shërbimin e Strehimit të Sigurt Emergjent (SHSSE), të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Udhëzimin Nr. 354, datë 02.06.2022. Tek ARSIS, Shërbimi i Strehimit të Sigurt Emergjent funksionon në shkallë kombëtare, duke plotësuar kërkesat nga i gjithë territori i vendit. Shërbimi shtrin ndihmën në kategoritë e mëposhtme:

- Fëmijët e moshës 3-18 vjeç pa kujdes prindëror që kanë nevojë për mbrojtje;
- Nëna të shoqëruara nga fëmijë 0-18 vjeç që kërkojnë mbrojtje;
- Familjet (përbëhen nga prindërit me fëmijë) që përballen me kushte specifike të emergjencave civile ose ato që kthehen nga migrimi i pasigurt;
- Fëmijë të huaj të pashoqëruar dhe të ndarë;

Të rriturit, qofshin gra apo burra pa fëmijë, nuk bëjnë pjesë në kompetencën e këtij shërbimi.

f. other.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, është një nga ligjet e miratuara në kuadër të reformës së re në drejtësi, hyrja në fuqi e të cilit solli një reformë të thellë të sistemit të ndihmës juridike duke sjellë një frymë të re në terma të organizimit, funksionimit dhe ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Miratimi i këtij ligji çoi në hartimin e një pakete aktesh nënligjore që rregullojnë me detaje çdo proces për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

Qëllimi kryesor i këtij ligji është ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjitha kategoritë, të cilat për shkak të kushteve në të cilat ndodhen, e kanë të pamundur marrjen e këtij shërbimi. Vëmendje të veçantë i është kushtuar llojit të kategorive të përfituesve, duke u fokusuar në zgjerimin e rrethit të subjekteve si dhe sanksionimin e grupeve vulnerabël si përfitues të drejtpërdrejtë të sistemit të ndihmës juridike falas, ku ndër to përmendim viktimat e mundshme të trafikimit/viktimat e trafikimit.

Ligji 111/2017, "Për Ndihmën Juridike të garantuar nga Shteti", në referim të nenit 11/b të tij, tashmë i ka cilësuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore si subjekte të posaçëm të cilët, pavarësisht nga të ardhurat e tyre janë përfitues të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Shërbimi i ndihmës juridike parësore ofrohet nga 20 Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore (QSHNJP), 15 Organizatat Jofitimprurëse (OJF) të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë dhe 12 Klinikat Ligjore, të cilat kanë një shtrirje territoriale, pothuajse në gjithë vendin.

Shërbimi i ndihmës juridike dytësore ofrohet nga avokatët, të cilët janë bërë pjesë e listës së avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore sipas Dhomave Vendore të Avokatisë dhe kanë lidhur kontratë në mënyrë individuale me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, sipas një procedure të përcaktuar me akt nënligjor mbi mënyrën e përzgjedhjes dhe kriteret që duhet të plotësojnë për të ofruar këtë shërbim. Kjo procedurë realizohet çdo vit. Për vitin 2023, ndihmën juridike dytësore e kanë ofruar 160 avokatë.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në baza mujore, miraton Kalendarin e Veprimtarive Ndërgjegjësuere me tematikë kushtuar të 12 (dymbëdhjetë) kategorive përfituese të ligjit nr. 111/2017 dhe një sërë aktiviteteve janë zhvilluar në kuadër të ndërgjegjësimit të viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Këto aktivitete/fushata ndërgjegjësuere kanë si qëllim informimin dhe njohjen mbi mënyrën, procedurën dhe subjektet përfituese të ligjit për të patur akses në drejtësi përmes ndihmës juridike të garantuar nga shteti, duke u shoqëruar me manuale të thjeshtëzuara, postera dhe fletëpalosje si dhe bashkëpunime me organe kompetente për trajtimin e çështjeve të këtij target grupi.

Në lidhje me referimin për shërbime ndihmëse si shëndetësore, juridike, psikologjike, qendrat kanë ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme, bazuar në marrëveshje dhe kontrata bashkëpunimi me institucione shtetërore apo private, të cilët në mënyrë të vazhdueshme kanë ofruar kontributin e tyre për dhënien e ndihmës për viktimat e trafikimit. Të gjitha rastet e trajtuara si VT/VMT pranë qendrave kanë marrë të gjitha llojet e shërbimeve për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre.

Shërbimet mbështetëse për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit ofrohen nga qeveria dhe OJF, të cilat operojnë në këtë fushë, pasi janë licencuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendra Kombëtare e Biznesit. Të dy aktorët, si shtetërorë ashtu dhe joshtetërorë plotësojnë njëri-tjetrin për shërbimet e munguara sipas rastit apo me ekspertizë më të lartë në aspekte të caktuara.

Ligji 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” neni 11 gërma “b” për viktimat të mundshme të trafikimit/viktimave të trafikimit, iu siguron akses të drejtpërdrejtë në drejtësi duke i specifikuar si një kategori e veçantë që përfiton ndihmën juridike falas në tre forma:

1. Ndihma juridike parësore, e cila konsiston në dhënien e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënia e këshillimit, dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve, dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore, përfaqësim përpara organeve administrative dhe dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.
2. Ndihma juridike dytësore (avokat pa pagesë), “Ndihmë juridike dytësore” konsiston në ofrimin e shërbimit juridik, për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën, ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.
3. Përfundim nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore (ekspert, psikolog etj.) dhe përfundim nga detyrimi i parapagimit të tarifës për ekzekutimin e urdhrit të përmbarrimit.

Gjithashtu, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji nga ofruesit e ndihmes juridike falas, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.

Për periudhën Janar-Nëntor 2023 kanë përfituar shërbimin e ndihmës juridike parësore 88 subjekte që i përkasin kategorisë së viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit dhe gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 34 aktivitete/sesione informuese/ndërgjegjësuere për viktimat e trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit në çdo fazë të procedimit penal.

25. How do you support the (re)integration of victims of THB? What processes are in place in your country to provide assistance to victims of THB exploited abroad after their return?

Në Shqipëri ekzistojnë katër qendra pritëse dhe riintegruese. Të gjitha ofrojnë shërbime për viktimat e mundshme të trafikimit ose të viktimave të trafikimit, të huaj apo vendas, të fëmijëve ose të rriturve, meshkuj apo femra dhe janë si më poshtë:

- Qendra Kombëtare e Pritjes për Viktimat e Trafikimit (QKPVT) në Tiranë. QKPVT, në varësi të SHSSH, është institucion kombëtar i sigurisë së lartë, që ofron shërbimin për pritjen dhe strehimin e viktimave të trafikimit, vendase dhe të huaja;
- Qendra "Të Ndryshëm dhe të Barabartë" në Tiranë;
- Qendra "Tjetër Vizion" në Elbasan, dedikuar posaçërisht për të miturit;
- Qendra Psiko-Sociale "Vatra" në Vlorë.

Qendrat pritëse dhe rinitegruese ofrojnë një paketë të plotë shërbimesh riintegrimi. Shërbimet e riintegritit përfshijnë: akomodimin, sigurinë dhe planin e riintegritit; ndihmë mjekësore; ndihmë psikologjike; asistencë psiko-sociale; ndërmjetësim/lehtësim me familjen e origjinës; ndihmë në arsimim dhe ndjekje të shkollës; ndihmë juridike; formim profesional; trajnim për punësim, këshillim dhe mbështetje për punësim; aktivitete sociale, këshillim; shërbim për fuqizim ekonomik duke përfshirë grantet për mikrobiznes; ndihmë për fëmijët e viktimave të trafikimit; mbështetje financiare dhe akomodim afatgjatë; informacion mbi shërbimet e disponueshme në komunitet dhe informacion përkatës të kontaktit; monitorim dhe mbikëqyrje e vazhdueshme e përfituesve të programit.

Qendrat që trajtojnë viktimat e trafikimit ofrojnë shërbime për VT/VMT, të huaj apo vendas, fëmijë, burra apo gra. Këto strehimore kanë staf të trajnuar për të garantuar sigurinë e viktimave. Një strehë e drejtuar nga OJQ ofron shërbime të specializuara për viktimat më të reja se 18 vjeç dhe ka marrë me qira apartamente për viktimat meshkuj, ku ata kanë marrë ndihmë nga OJQ-të.

Me qëllim përmirësimin e shërbimeve në qendrat rezidenciale, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka nisur procesin e rishikimit të Standardeve të Qendrave Rezidenciale për Viktimat e Trafikimit. Gjatë këtij procesi, grupi i ekspertëve zhvilloi takime me përfaqësuesit e Strehëzave Antitrafik dhe mori të dhëna në lidhje me përmirësimin e standardeve. Pritet që ky proces të finalizohet në vitin 2024.

Tre OJQ-të joshtetërore (Të ndryshëm dhe të barabartë, Qendra Psiko Sociale Vatra dhe Tjetër Vizion) ofrojnë një paketë të plotë shërbimesh riintegrimi. Shërbimet e riintegritit përfshijnë: akomodimin, sigurinë dhe planin e riintegritit; asistencë mjekësore; ndihmë psikologjike; asistencë psiko-sociale; ndërmjetësim/lehtësim me familjen e origjinës; ndihmë për arsimim dhe ndjekje të shkollës; ndihmë juridike; formimi profesional; stërvitje për punësim, këshillim dhe mbështetje për punësim; aktivitete sociale, mentorim; shërbimet për fuqizimin ekonomik duke përfshirë grantet për mikrobiznesin; asistencë për fëmijët e viktimave të trafikimit; mbështetje financiare dhe akomodim afatgjatë; informacion mbi shërbimet e disponueshme në komunitet dhe informacionin përkatës të kontaktit; monitorimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të përfituesve të programit.

Programi i riintegritit është i ndarë në tre faza, duke përfshirë shërbimet e urgjencës, shërbimet e rehabilitimit dhe shërbimet afatgjata dhe monitorimin gjatë procesit të përfshirjes sociale:

Faza #1: Ndërhyrja në krizë dhe akomodimi

Ndihma fillestare për viktimat ka të bëjë kryesisht me akomodimin e tyre në qendrat rezidenciale ku përfituesve u sigurohen nevojat bazë dhe shërbimet e krizës - p.sh. akomodimi, strehimi, veshmbathja, ushqimi, asistencë mjekësore, asistencë psikologjike, trajnimet profesionale, mbrojtja dhe siguria 24 orë, ndërmjetësimi familjar, si dhe përgatitja për fazat e ardhshme të riintegritit. Në këtë fazë, përfituesit, së bashku me stafin (ekipin multidisiplinar), hartojnë dhe ndjekin planet e tyre individuale të riintegritit.

Faza #2: Faza e tranzicionit duke përfshirë jetesën gjysmë të pavarur

Shumica e përfituesve nuk janë në gjendje të shkojnë në shtëpi për shkak të mentalitetit dhe stigmës sociale, arsyet së sigurisë ose refuzohen nga familjet, ndaj atyre u ofrohet një gamë e plotë e asistencës në shtëpi në përgatitje për jetesë të pavarur. Tre OJQ-të ofrojnë apartamente me qira për përfituesit që kanë filluar të bëjnë kalimin e rëndësishëm në jetën 'normale'. Të rriturit mbështeten drejt pavarësisë së tyre ekonomike - p.sh. Pas përfundimit të formimeve profesionale dhe mbajtjes së një pune për disa kohë, ata shpërngulen nga streha dhe në apartamente me qira, të subvencionuara nga qendra. Për të miturit lehtësohen vendosjet në familjet e origjinës dhe mjediset e kujdesit alternativ. Staf i qendrës monitoron përparimin e përfituesve në këto shtëpi dhe familje në gjysmë të rrugës, duke ofruar asistencë të rregullt psiko-sociale.

Faza #3: Ri/integrimi dhe përfshirja sociale

Mbështetja që u jepet rasteve në këtë fazë është fuqizimi i tyre dhe largimi gradualisht nga programi. Kjo mbështetje konsiston në: ofrimin e ndihmës riintegruese për familjen dhe komunitetin ku banon përfituesi; informacion mbi burimet dhe shërbimet e disponueshme në komunitet, asistencë për përfituesit në forcimin e marrëdhënieve me institucionet mbështetëse në komunitetin ku ata jetojnë; dhe monitorim dhe ndjekje të rregullt të rasteve. Shërbimet e ofruara për viktimat e trafikimit nuk kushtëzohen nga bashkëpunimi i viktimave me organet e zbatimit të ligjit në prokurori. Të gjitha qendrat kanë vazhduar të ofrojnë shërbime për raste të reja dhe të vazhdueshme në program, përfshirë viktimat meshkuj (shërbime në komunitet).

Qendra Kombëtare Pritëse financohet nga shteti dhe ofron rehabilitim dhe përgatitje për shërbime riintegrimi duke përfshirë akomodimin, sigurinë dhe planin e riintegrit; asistencë mjekësore; ndihmë psikologjike; asistencë psiko-sociale; ndërmjetësim/lehtësim me familjen e origjinës; ndihmë për arsimim dhe ndjekje të shkollës; ndihmë juridike; formimi profesional; këshillim dhe mbështetje për punësim; aktivitete sociale, mentorim; ndihmë për fëmijët e viktimave të trafikimit strehim afatgjatë; informacion mbi shërbimet e disponueshme në komunitet dhe informacionin përkatës të rastit.

Gjatë periudhës së akomodimit në qendrat e pritjes, të gjitha rastet përgatiten për të përballuar me sukses fazën e riintegrit. Referuar statistikave gjatë gjithë këtyre viteve, përqindja më e lartë e rasteve janë mbështetur me kurse profesionale të certifikuara, në mënyrë që ata të mund të integrohen dhe të fuqizohen përmes punësimit, gjatë riintegrit të tyre. Për këtë, bashkëpunohet ngushtësisht me Qendrat e Formimit Profesional dhe zyrat e punës në qarqe. Gjatë procesit të riintegrit, me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e rasteve VT/VMT (Faza #3), vijon bashkëpunimi me aktorë të tjerë, si: Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Sociale Shtetërore apo organizata të tjera që ofrojnë mbështetje pas largimit të viktimave nga qendrat pritëse, duke mundësuar punësim apo mbështetje ekonomike për to.

Nisma ARSIS për vitin 2023 vazhdon të ofrojë shërbime për fëmijët me nivel të lartë rreziku dhe në nevojë për mbrojtje, duke përfshirë fëmijët në rrezik trafikimi, si më poshtë:

- shërbimi psiko-social gjatë intervistës në ambientet e komisariateve (në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit)
- shërbimin e transportit të sigurt të fëmijës në rrezik për shërbime të tjera si gjykata, drejtoria e policisë, ofruesit e shërbimeve rezidenciale, shërbimet spitalore etj.
- shërbimi i strehimit të sigurt urgjent nga 72 orë deri në 11 ditë (edhe më shumë në varësi të specifikave të rastit).
- shërbimet që lidhen me menaxhimin e rasteve të cilat përfshijnë ndërhyrje direkte, shërbime të specializuara, shërbime shëndetësore, arsimore, ligjore dhe fuqizuese familjare. Sqarojmë se shërbimet e menaxhimit të rasteve ofrohen jo vetëm për rastet e fëmijëve dhe familjeve që strehohen në shërbimin e urgjencës por edhe për rastet që janë nën menaxhim në bashkëpunim me strukturat e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Në rastet e asistuara në shërbimin e urgjencës për vitin 2023 janë akomoduar gjithsej 57 raste, ku 10 janë prindër dhe 47 fëmijë. Pavarësisht nga arsyet e referimit në shërbimin e urgjencës, nga puna e ekipit të shërbimit dhe kryerja e vlerësimit fillestar dhe të thelluar, janë evidentuar 7 raste të cilat pavarësisht arsyes së akomodimit (situatë rrugë, dhunë në familje, etj.) kanë rezultuar me tregues/elementë rreziku si viktimat të mundshme të trafikimit. Pas procesit të intervistimit dhe në varësi të moshës, të miturit akomodohen në shërbime të specializuara për viktimat e mundshme të trafikimit ose fëmijët pa kujdes prindëror.

Në vitin 2021, me vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar u realizua shpërndarja e një “Fondi të posaçëm” i krijuar nga vlerat monetare të konfiskuara. Ky fond financoi projekte të cilat kishin në fokus ofrimin e shërbimeve, në funksion të plotësimit të nevojave dhe riintegrimit për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e krimit të organizuar. Nga Fondi i Posaçëm u financuan projektet për këto qendra:

- Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit në shumën e 3,400,000 (tre milion e katërqind mijë) lekë;
- Qendra “Vatra” në shumën e 2,280,000 (dy milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë;
- Qendra “Të ndryshëm dhe të barabartë” në shumën e 2,280,000 (dy milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë
- Nisma për ndryshim shoqëror ARSIS” në shumën e 2,280,000 (dy milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Gjithashtu në vitin 2023 dy apartamente të konfiskuara në qytetin e Tiranës me sipërfaqe 80.6 m2 dhe 82.4 m2, janë dhënë në përdorim (pa qira) të Nismës ARSIS, në të cilat ofrohen shërbime emergjente për nënat dhe fëmijët në situatë rruge.

Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktmave të mundshme të trafikimit (VKM nr.499, datë 29.08.2018) parashikojnë “Planifikim dhe Mbështetje për Rehabilitim dhe Ri/integrim”. Planifikimi dhe Mbështetja për Rehabilitim dhe Ri/integrim e VT/VMT është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë dhe brenda territorit të RSH-së, si ata të institucioneve vendore, ashtu edhe ata qendrore (në veçanti anëtarët e AP-së). Këto veprime përfshijnë minimalisht: 1. vlerësimin e thelluar të nevojave të personave të trafikuar; 2. hartimin e planeve të mbështetjes; 3. ndihmën direkte për rehabilitimin dhe ri/integrimin/fuqizimin e personit të trafikuar; 4. informimin e AP-së për ecurinë e mbështetjes.

Gjithashtu, PSV-të parashikojnë “Pritjen e personave të trafikuar me shtetësi shqiptare”, duke specifikuar veprimet e institucioneve/agjencive të ngarkuara me mbrojtjen e personave të trafikuar që sigurojnë pritjen e personave të trafikuar/të dyshuar të trafikuar me shtetësi shqiptare dhe vijimësinë e mbrojtjes, si dhe “Planifikimin dhe Mbështetjen për Kthim Vullnetar të Asistuar”.

“Planifikimi dhe Mbështetja për Kthim Vullnetar të Asistuar”, është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë, brenda dhe jashtë territorit të RSH-së, si ata të institucioneve vendore, ashtu edhe ata qendrore (sidomos anëtarët e AP-së) që bënë të mundur kthimin e sigurt, vullnetar dhe të asistuar të një personi të trafikuar me shtetësi të huaj në vendin e origjinës. Këto veprime duhet të përfshijnë minimalisht: 1. vlerësimin e situatës së personave në vendin dhe familjen e origjinës para kthimit; 2. informimin e personit dhe kujdestarit të tij/saj për vlerësimin; 3. marrjen e vendimit të kthimit në interesin më të lartë të fëmijës/personit të trafikuar; 4. marrjen e masave që kthimi të jetë i asistuar/ i sigurt; 5. sigurimin që personat e trafikuar nuk do të ndiqen penalisht në vendin e tyre të kthimit; 6. sigurimin e vazhdimësisë së trajtimit të personit të trafikuar në përputhje me nevojat e tij/saj; 7.

parandalimin e riviktimizimit/rënies pre e trafikimit; 8. sigurimin e ndjekjes penale të trafikantëve dhe kompensimit të personave të trafikuar.

26. If there is a provision in your country's law that provides for the possibility of issuing a residence permit owing to the victim's personal situation, how is this interpreted in practice? Please provide examples.

Neni 53 i ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt" parashikon lëshimin e lejes së qëndrimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Sipas kësaj dispozite:

1. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin pajis me leje të përkohshme qëndrimi të tipit "A" të huajin që është viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit edhe nëse kushtet e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji ose kriteret e tjera të përgjithshme të përcaktuara në këtë ligj nuk plotësohen.

2. Leja e qëndrimit, e lëshuar për këtë motiv, shërben vetëm për qëndrimin e të huajit dhe nuk mundëson rihyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë në rast se i huaji del nga territori. Leja e qëndrimit për këtë motiv lëshohet me afat 1-vjeçar dhe rinovohet vetëm në rastet kur:

a) vlerësohet se qëndrimi i saj/i tij nuk përbën kërcënim për sigurinë publike dhe atë kombëtare;

b) vlerësohet se ekziston një vullnet i qartë i personit për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë gjatë hetimit ose procedimit penal;

c) është në pritje të vlerësimit të statusit nga autoritetet kompetente.

3. I huaji, të cilit i jepet leje e përkohshme qëndrimi sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, gëzon të drejtat për të qëndruar dhe lëvizur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të garantuara si për të huajt që kanë leje qëndrimi të përkohshme, sipas procedurave normale. Ai bashkëpunon me organet përgjegjëse për përcaktimin e identitetit të vet, por mungesa e provës, që vërteton identitetin, nuk mjafton si bazë për refuzimin e lëshimit të lejes së përkohshme të qëndrimit. I huaji përfiton kujdes shëndetësor, ndihmë financiare, mbështetje, si dhe të drejtën për të punuar nëse i përfiton sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin pajis me leje të përkohshme qëndrimi të tipit "A", për një afat 3-mujor, të huajin, pavarësisht nga vullneti i tij/saj për të bashkëpunuar me drejtësinë, kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se i huaji është viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit, e identifikuar si e tillë nga strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit. Kjo leje qëndrimi me afat 3-mujor i jepet viktimës ose viktimës së mundshme të trafikimit me qëllim që të rimarrë veten, si dhe të trajtohet sipas gjendjes fizike dhe mendore për marrjen e një vendimi të mirinformuar për të bashkëpunuar ose jo me organet e drejtësisë.

5. Gjatë periudhës së rikuperimit dhe reflektimit, viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit gëzojnë të gjitha të drejtat dhe shërbimet që përfitojnë viktimat e trafikimit sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

6. Leja e qëndrimit, e lëshuar për periudhën e rikuperimit dhe reflektimit, mund të revokohet nëse provohet se viktimat ose viktimat e mundshme e trafikimit e ka fituar apo pretenduar këtë status në mënyrë të padrejtë, ka rivendosur aktivisht, vullnetarisht dhe/apo me iniciativën e saj/të tij marrëdhënie me personat e dyshuar për trafikimin e qenieve njerëzore ose konsiderohet se qëndrimi i saj/tij në

territor përbën rrezik për sigurinë kombëtare. Revokimi i lejes së qëndrimit për periudhën e rikuperimit dhe reflektimit i komunikohet viktimës apo viktimës së mundshme të trafikimit në formë të shkruar, në gjuhën që ajo/ai kupton, duke e informuar atë për arsyet e revokimit, me përjashtim të rastit kur leja e qëndrimit ndërpritet për arsye të sigurisë kombëtare.

7. I huaji me statusin e viktimës së mundshme të trafikimit ka të drejtën e punësimit pa marrë më parë miratim nga AKPA-ja dhe duhet të njoftohet nga punëdhënësi lidhja e marrëdhënieve të punësimit.

8. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin rinovon lejen e qëndrimit të tipit “A” për të huajin, viktimë e trafikimit në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar si të tillë nga strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit, në njërën ose tjetrën prej dy situatave të mëposhtme ose në të dyja këto situata:

a) vlerëson se qëndrimi i saj/tij është i nevojshëm për shkak të situatës sociale dhe personale;

b) vlerëson se qëndrimi i saj/tij është i nevojshëm për qëllim të bashkëpunimit me organet e drejtësisë gjatë hetimit ose procedimit penal.

9. Dhënia e lejes së qëndrimit nuk kushtëzohet me ekzistencën e mjeteve të mjaftueshme financiare të viktimës për të mbuluar shpenzimet për kohën e qëndrimit apo nga mungesa e dokumenteve identifikuese të viktimës apo viktimës së mundshme të trafikimit.

Në zbatim të këtij ligji, është miratuar VKM nr.858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve të RSH”, ku, specifikisht, në Kreun III/B përcaktohet se një ndër dokumentat dhe kushtet që duhet të plotësojë i huaji, për të aplikuar për leje qëndrimi është edhe dokumenti që provon akomodim të përshtatshëm/kontratë blerje ose marrje me qira të banesës, në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri.

Për vitin 2019-2023, me ndërmjetësimin e Autoritetit Përgjegjës dhe Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit janë pajisur me leje qëndrimi 5 shtetas të huaj VT/VMT;

Në vitin 2019-2021, me ndërmjetësimin e Autoritetit Përgjegjës dhe qendrës “Të ndryshëm dhe të Barabartë” janë pajisur me leje qëndrimi 2 shtetas të huaj VT/VMT;

Në vitin 2023, me ndërmjetësimin e Autoritetit Përgjegjës dhe qendrës “Vatra” janë pajisur me leje qëndrimi 2 viktima të huaja të mundshme trafikimi.

27. What measures are in place to ensure that the identity, or details allowing the identification, of a child victim of trafficking are not made publicly known?

Legjislacioni i brendshëm ka parashikuar, që kur kemi të bëjmë me raste të VT/VMT nuk jepen në asnjë rrethanë emrat e viktimave, dhe në komunikatat e policisë jepen vetëm inicialet e tyre, kjo pasi nuk duhet të dekonspirohet hetimi apo veprimet e mëtejshme procedurale. Nuk ndodh që emrat e VT/VMT të bëhen të njohura në mediat vizive. Konkretisht: Neni 58/a i Kodit të Procedurës Penale parashikon të drejtat e viktimës së mitur:

1. I mituri, viktimja e veprës penale, përveç të drejtave të parashikuara në nenin 58 dhe dispozitat e tjera të Kodit të Procedurës Penale dhe legjislacionit të posaçëm për të miturit, ka të drejtë:

b) Konfidencialiteti i të dhënave të tij/saj personale.

Neni 340 i Kodit të Procedurës Penale parashikon rastet e seancave të mbyllura:

2. Seanca mbahet gjithmonë me dyer të mbyllura në rastet kur:

b) Gjykimi i të pandehurve madhorë që akuzohen për vepra penale të kryera ndaj viktimave të mitura, pavarësisht nga mosha e viktimës gjatë procesit të gjyqimit.

Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” parashikon:

Neni 21 “Mbrojtja e jetës private të të miturit”

1. E drejta e të miturit për jetën private respektohet plotësisht në çdo fazë të drejtësisë penale për të miturit, duke u kujdesur për të shmangur dëmtimin e tij.

2. Nuk publikohet asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e të miturit në konflikt me ligjin, viktimës së mitur ose dëshmitarit të një vepre penale.

Në pikën 2 të nenit 17 “Liria e jetës private” të Ligjit “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” është përcaktuar se: Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshirë ato brenda familjes, institucioneve të kujdesit shëndetësor, shoqëror e të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse.

Në nenin 16 “Mbajtja dhe Raportimi i të dhënave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes” është përcaktuar detyrimi për konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale. Ky detyrim shtrihet për të gjithë personat dhe institucionet e përfshira në procesin e menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje. Gjithashtu dhe në pikën 3 të këtij neni përcaktohet se “Çdo anëtar i GTN-së, i përfshirë në menaxhimin e rastit, nënshkruan një deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit në mbledhjen e parë të GTN-së.

Punonjësit e çdo strukture, të vijës së parë të cilët marrin raportimet për rastet e fëmijëve në rrezik përfshirë dhe fëmijë VT/ VMT dhe ata që e ndjekin çështjen e raportuar, kanë detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin e çështjes dhe mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijës dhe të personit të dyshuar për abuzim.

28. What measures are in place aimed at encouraging the media to protect the private life and identity of victims?

Në korrik 2023 u miratua Kodi i Transmetimit i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), i cili përmban parimet bazë të transmetimit dhe rregullon veprimtarinë audio dhe audiovizive, pothuajse në të gjithë gamën e vet. Kodi i ri i Transmetimit është pasuruar me parime dhe rregulla të reja që përfshijnë promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e diskriminimit gjinor dhe luftimin e seksizmit në mediat audiovizive; parandalimin e gjuhës së urrejtjes, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm; mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve në të gjitha llojet e transmetimeve; mbrojtjen më të mirë të të drejtave dhe lirive të njeriut, pavarësisht statusit ose pozitës shoqërore; mbrojtjen e të drejtave

dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara në mediat audiovizive, si edhe mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale.

Kodi i Transmetimit përmban 11 Seksione, nga 8 që kishte më parë. Seksioni i “Lufta ndaj diskriminimit dhe promovimit të barazisë gjinore” si dhe “Parandalimi dhe lufta ndaj gjuhës së urrejtjes në transmetimet audiovizive” janë përfshirë për herë të parë në këtë Kod. Ndërsa seksionet ekzistuese janë pasuruar dhe zgjeruar çka i shkon më afër qëllimit që Kodi i Transmetimit ka, atë për sigurimin e pavarësisë dhe paanësinë së veprimtarisë së subjekteve audio dhe audiovizive në Shqipëri. <https://ama.gov.al/ama-miraton-kodin-e-ri-te-transmetimit/>

Strukturat e Policisë kryejnë shpesh dhe në mënyrë periodike takime dhe trajnime me mediat vizive që operojnë në vendin tonë, për të informuar në çdo rast që viktimat është një personat më vulnerabël, si me mediat ashtu dhe me marrëdhëniet familjare.

29. Have there been cases of diplomatic households (of your country’s diplomats abroad and of foreign diplomats in your country) employing domestic staff in conditions which could be forced labour or human trafficking? If yes, how was the issue of diplomatic immunity addressed? How were the victims identified, assisted and protected?

Jo, nuk ka pasur raste.

30. What specific steps are taken in your country to identify victims of THB amongst persons recruited and exploited by terrorist/armed groups?

Shqipëria, si shumë vende të tjera, ka marrë një sërë masash për të respektuar rezolutat ndërkombëtare kundër terrorizmit dhe për të parandaluar rekrutimin e luftëtarëve terroristë që udhëtojnë jashtë vendit për t’iu bashkuar organizatave në zonat e konfliktit si, p.sh. Siria. Për këtë arsye, në vitin 2020 u miratua Strategjia ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2021–2025 dhe plani i veprimit 2021–2023 (VKM nr.1137, datë 16.12.2020). Qëllimi i këtij dokumenti është orientimi i politikave dhe forcimi i qasjes gjithëpërfshirëse në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj terrorizmit. Strategjia përcakton objektivat strategjike që mbrojnë vlerat themelore dhe i grupon ato në katër fusha prioritare ose qasje:

1. Parandalimi i terrorizmit, ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizmi;
2. Mbrojtja me zbulimin dhe eliminimin e kërcënimeve të terrorizmit dhe dobësive të sistemit;
3. Ndjekja penale e terroristëve, duke respektuar të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe demokracinë; dhe
4. Përgjigja e sistemit në rast të një sulmi terrorist.

Bazuar në të dhënat që disponohen pranë Autoritetit Përgjegjës, rezulton se nuk ka pasur asnjë rast viktimë e mundshme apo viktimë trafikimi, identifikuar në mesin e personave të rekrutuar apo shfrytëzuar nga grupet terroriste.

31. Are there requirements in your country’s legal framework for the detection and removal of THB-related Internet content, and what are the sanctions for non-compliance? Is there a code of conduct for providers? If a person is detected as a presumed victim of THB in the process, how is this person referred to assistance?

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ushtron veprimtarinë e saj Drejtoria për Hetimin e Krimeve Kibernetike, e cila jep kontribut për mbrojtjen e fëmijeve të mitur për parandalimin, ndjekjen dhe hetimin e krimeve kibernetike ndaj fëmijëve në hapësirën kibernetike.

Po ka kërkesa të herë pas hershme lidhur me zbulimin dhe heqjen e materialeve me përmbajtje jo etike conform legjislacionit në fuqi, por nuk ka një strukturë specifike, e cila merret vetëm me rastet dhe zbulimin e trafikimit të personave.

If a person is detected as a presumed victim of THB in the process, how is this person referred to assistance?

Nëse një person identifikohet si VT/VMT gjatë procesit të hetimit të krimeve nëpërmjet rrjeteve kompjuterike, atëherë zbatohen PSV-të dhe materialet referohen në prokurori, si dhe kërkohet të kryhen verifikimet e të dhënave nga cili operator apo rrjet kompjuterik janë hedhur të dhënave dhe më pas është prokurori i cili drejton hetimin.

III. INVESTIGATION, PROSECUTION, SANCTIONS AND MEASURES (Articles 4, 18, 19, 23, 24, 27, 28 and 30)

32. Is the abuse of a position of vulnerability part of the human trafficking offence in your country's law? How are the concepts of "vulnerability" and "abuse of a position of vulnerability" defined in law? Have they been subject to judicial interpretation? If yes, please provide relevant case-law.

Aktualisht në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ka dy dispozita që në mënyrë të shprehur kriminalizojnë trafikimin e qenieve njerëzore, neni 110/a "Trafikimi i personave të rritur" dhe neni 128/b "Trafikimi i të miturve", me përmbajtje si më poshtë:

Neni 110/a "Trafikimi i personave të rritur" (Shtuar me ligjin 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004; ndryshuar titulli, fjalët në paragrafin e parë dhe paragrafi i tretë dhe shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013).

"Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me ¼ e dënimit të dhënë".

Neni 128/b Trafikimi i të miturve (Shtuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004; shtuar me ligjin nr. 9859, datë 21.1.2008; ndryshuar fjalët në paragrafin e parë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013)

“Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me $\frac{1}{4}$ e dënimit të dhënë”.

Nga përmbajtja e dispozitave të cituara më sipër, gjejnë pasqyrim konceptet e “vulnerabilitetit” dhe “abuzimit me pozicionin e cenueshmërisë”, sipas përkufizimit në aktet ndërkombëtare. Konkretisht paragrafi i parë i nenit 110/a, ndër mjetet për realizimin e trafikimit të personave të rritur cilëson me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike e të dëmtuarit (pozita vulnerabël).

Kurse neni 128/b lidhet me trafikimin e të miturve, të cilët janë më vulnerabël se të rriturit dhe prandaj janë më të rrezikuar për t’u bërë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore.

Gjithashtu për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka nxjerrë vendimin njësuës nr. 00-2022-1679 Vendimi (217) datë 27.07.2022 lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, ku ndër të tjera parashikon konceptet e “vulnerabilitetit” dhe “shpërdorimit të pozitës së cenueshmërisë”, duke theksuar se, gjykatat dhe prokuroria duhet të kenë në vëmendje që personat që jetojnë në një ambient social apo familjar me probleme ekonomike, financiare, personale apo psikologjike, duhen trajtuar me shumë kujdes, si viktime të mundshme të trafikimit. Pra, në legjislacionin penal shqiptar, si dhe në vendimin njësuës të Gjykatës së Lartë, abuzimi me pozicionin e cenueshmërisë /pozitës vulnerabël, parashikohet si një nga mënyrat që trafikantët përdorin për realizimin e qëllimit të tyre. <https://www.gjykataelarte.gov.al/sq/vendimet-e-gjykatës>

Gjithashtu, pika 31, e nenit 3 “Përkufizime” të Ligjit për të huajt” përcakton se: “Persona vulnerabël” janë të miturit e huaj, të miturit e pashoqëruar, persona me aftësi të kufizuara, të moshuar, femra shtatzëna, prind i vetëm me fëmijë të mitur, si dhe persona, të cilët kanë qenë objekt i torturës, përdhunimit ose formave të tjera të dhunimeve të rënda psikologjike, fizike e seksuale, migrantët që, për shkak të situatës së tyre specifike nuk janë në gjendje të gëzojnë të drejtat e tyre dhe janë në kushte veçanërisht delikate, si punëtorët e shtëpisë, migrantët me orientim seksual të caktuar, migrantët në gjendje shëndetësore të rëndë dhe ata me aftësi të kufizuara.

33. Is the special vulnerability of the victim considered as an aggravating factor for the offender's sentence?

Neni 50 i Kodit Penal, germa e, parashikon rrethana rënduese: “e) kur vepra kryhet ndaj fëmijëve, grave shtatzëna ose personave të tjerë, të cilët për shkaqe të ndryshme nuk mund të mbrohen. Sipas

Kodit, cenueshmëria e veçantë e viktimës (vepra kryhet ndaj fëmijëve, grave shtatzëna ose personave të tjerë që për arsye të ndryshme nuk mund të mbrohen) konsiderohet si një faktor rëndues për dënimin e autorit.

34. According to national case-law, what forms of vulnerability are mostly abused by offenders in human trafficking cases? Please provide specific examples that show how the concept of “abuse of a position of vulnerability” is used in practice. What are the challenges in its application? Is it sufficient to prove the existence of a position of vulnerability of the victim, or must it also be proven that the defendant knew or should have known of the victim’s vulnerability, and intentionally manipulated the victim on this basis?

Sipas treguesve statistikorë të Zyrës së Statistikës në Prokurorinë e Përgjithshme, forma më e spikatur e për të cilën janë regjistruar më shumë raste është trafikimi me qëllim shfrytëzimin seksual; abuzimi lidhet me situata të ndryshme të viktimës. Në rastin kur viktimat janë të rritur, pëlqimi apo vullneti i viktimës nuk ndikon në cilësimin e veprës penale, pasi autori i abuzimit përdor mjetet (që parashikohen në dispozitë) për të realizuar qëllimin, d.m.th. trafikimin. Gjatë hetimit duhet të provohen mjetet e përdorura nga autori për manipulimin e viktimës me qëllim trafikimin e saj.

Format e cenueshmërisë shfrytëzohen kryesisht nga shkelësit, duke përfituar nga gjendja sociale, fizike ose psikologjike e viktimës për shembull: familjet me probleme socio-ekonomike (të varfra, të papunë, pa arsim), divorci, dhuna në familje, abuzimi seksual në familje, personat me aftësi të kufizuar, personat me probleme të shëndetit mendor, të miturit pa kujdes prindëror, personat e varur nga alkooli dhe droga, etj).

Ligjvënësi ka elaboruar duke përcaktuar gjendjen sociale, fizike apo mendore por ajo mund të jetë edhe emocionale, familjare, ekonomike madje edhe e lidhur me traditën apo kulturën e familjes apo përkatësisë etnike të viktimës. Situata mund t'i referohet gjithashtu statusit të parregullt të viktimës së huaj, varësisë ekonomike nga trafikanti, problemeve shëndetësore ose rrethanave të tjera të vështira që e detyrojnë atë të pranojë shfrytëzimin.

Vepra penale e parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal konsiderohet e kryer plotësisht, kur provohet një nga veprimet, një nga format dhe qëllimi i shfrytëzimit të viktimës.

Në rastin e trafikimit të të rriturve, pëlqimi ose gatishmëria e viktimës për t'u përfshirë në prostitucion ose forma të tjera shfrytëzimi nuk ndikon në përcaktimin e veprës penale për sa kohë që vërtetohet se është përdorur një nga format e referuara në dispozitën penale specifike për arritjen e qëllimit neni (format në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore janë: mashtrimi, përdorimi i forcës, rrëmbimi, kërcënim i ose përdorimi i formave të tjera të detyrimit, keqpërdorimi i detyrës ose përfitimi nga gjendja sociale, fizike ose psikologjike etj., - elemente këto që duhet të gjykohet në rastin e trafikimit të të rriturve).

Në veprën penale “Trafikimi i të miturve”, për shkak të përcaktimit ligjor të veprës, mjafton të vërtetohet ekzistenca e njëres prej formave të trafikimit si: rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose strehimi i të miturit, për ta përdorur atë. Ndërsa, vullneti ose pëlqimi i viktimës së mitur të trafikimit, në lidhje me shfrytëzimin e synuar, nuk ka asnjë vlerë, pavarësisht nga rrethanat ose mënyra në të cilën është kryer.

35. Is the concept of “abuse of a position of vulnerability” addressed in criminal justice training? Is there any specific guidance on applying this concept? Please provide copies

of guidance and/or training materials that shed light on how this concept should be applied in practice.

Shkolla e Magjistraturës, bazuar në Programin e Formimit Vazhdues organizon trajnime me prokurorë, gjyqtarë, koordinatorë, oficerë të policisë gjyqësore, psikologë, etj. Më poshtë do të gjeni trajnimet e organizuara gjatë periudhës raportuese, numrin e pjesëmarrësve në temat që trajtojnë çështje të trafikimit, pozicionit vulnerabel të subjekteve të caktuara, e të tjera çështje që përfshihen në fushën e rekomandimeve të GRETA-s:

1.	6-7 shkurt 2019	Trafikimi i qenieve njerëzore. Ndjekja dhe gjykimi penal i veprave të trafikimit të qenieve njerëzore në përputhje me risitë në Kodin e Procedurës Penale. Të drejtat e viktimës së trafikimit gjatë procesit penal.	20 pjesëmarrës (14 gjyqtarë, 5 kandidatë për magistrat, 1 psikolog)
2.	25-26 mars 2019	Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar, dhe risitë e tij; Hetimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale. Procesi i të provuarit dhe shndërrimi i barrës së provës. Risitë e shtesave dhe ndryshimeve.	12 pjesëmarrës (5 gjyqtarë, 7 prokurorë)
3.	21 shkurt 2020	Trafikimi i qenieve njerëzore, ligji dhe praktika kombëtare dhe ndërkombëtare.	26 pjesëmarrës (5 gjyqtarë, 6 prokurorë, 15 OPGJ)
4.	12 janar 2021	Specifikat e procesit të intervistimit të të miturit 14 vjeç-18 vjeç dhe të të miturit viktimë/dëshmitar nën 14 vjeç në hetim dhe gjykim. Koncepti i viktimizimit të përsëritur. Rregullat e veçanta të pyetjes së të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar i shfrytëzimit seksual ose dhunës seksuale. Ekuilibri për garantimin e pjesëmarrjes së të miturit viktimë në procedim dhe për garantimin e mbrojtjes së jetës private dhe mirëqenies së të miturve viktimë dhe dëshmitarë.	19 pjesëmarrës (2 gjyqtarë, 8 prokurorë, 9 OPGJ)
5.	8-9 shkurt 2021	Teknikat e hetimit për veprat penale: - Krimet kibernetike; - Falsifikimet kompjuterike, ndërhyrja në të dhënat kompjuterike.	18 pjesëmarrës (9 prokurorë, 9 OPGJ)
6.	16-17 shkurt 2021	Qasje praktike për teknikën e intervistimit të të miturve gjatë hetimit & gjyqimit.	13 pjesëmarrës (5 gjyqtarë, 6 prokurorë, 2 OPGJ)
7.	16-17 shkurt 2021	Ndërmjetësimi në çështjet penale dhe zbatimi i ndërmjetësimit sipas KDPM. Dënimet penale alternative ndaj të miturit në konflikt me ligjin sipas	11 pjesëmarrës (7 gjyqtarë, 2 prokurorë, 2 OPGJ)

		K.D.P.M, llojet dhe trajtimi në vështrim krahasues i tyre me dënimet alternative që zbatohen ndaj subjektit madhor sipas Kodit Penal.	
8.	19 shkurt 2021	Shfrytëzimi seksual online i të miturve dhe metodat e hetimit. Raste të praktikës gjyqësore. Problematikat dhe sfidat në luftën kundër shfrytëzimit seksual të të miturve.	20 pjesëmarrës (4 gjyqtarë, 6 prokurorë, 10 OPGJ)
9.	22-23 shkurt 2021	Të mbrojmë fëmijët viktimë përmes Drejtësisë Restauruese. <i>Kurs online</i>	1 pjesëmarrës (1 gjyqtar)
10.	25 shkurt 2021	Veçantitë e Drejtësisë Penale për të dëmtuarit. Natyra dhe qëllimi i tyre.	12 pjesëmarrës (6 gjyqtarë, 6 prokurorë)
11.	25-26 shkurt 2021 dhe 11-12 mars 2021	Të mbrojmë fëmijët viktimë përmes Drejtësisë Restauruese. <i>Kurs online</i>	2 pjesëmarrës (1 gjyqtar, 1 prokuror)
12.	1-2 mars 2021 dhe 25-26 mars 2021	Të mbrojmë fëmijët viktimë përmes Drejtësisë Restauruese. <i>Kurs online</i>	6 pjesëmarrës (2 gjyqtarë, 1 prokuror, 3 kandidatë për magistrat)
13.	7 prill 2021	Llojet e masave të shmangies nga ndjekja penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin, (trajtimi teorik dhe praktik). Praktika pozitive dhe probleme të evidentuara nga gjykatat dhe prokuroritë në këtë drejtim. Nevoja për unifikim të modeleve të akteve procedurale të aplikueshme për dhënien e masave të shmangies. Mospërbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale dhe pasojat ligjore. Procedura ligjore dhe organet kompetente monitoruese të masave të shmangies. Ndërmjetësimi në çështjet penale dhe zbatimi i ndërmjetësimit sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDPM). Roli i prokurorisë dhe gjykatës në zbatimin e ndërmjetësimit viktimë dhunues.	9 pjesëmarrës (3 gjyqtarë, 2 prokurorë, 4 OPGJ)
14.	4 maj 2021	Trafikimi i qenieve njerëzore. Risitë në legjislacionin penal. Mbështetja e viktimave të trafikimit gjatë procesit penal.	12 pjesëmarrës (3 gjyqtarë, 7 prokurorë, 2 OPGJ)
15.	5-6 maj 2021	Viktima “i mitur” në procesin penal. Të drejtat dhe garancitë e tij përgjatë gjithë fazave të procesit penal. Rregullat e veçanta të pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar dhe roli i psikologut. Intervistimi i të miturit viktimë dhe fazat e këtij procesi. Analizë e jurisprudencës vendase dhe asaj ndërkombëtare.	16 pjesëmarrës (5 gjyqtarë, 7 prokurorë, 4 OPGJ)
16.	11 maj 2021	Trafikimi i qenieve njerëzore.	12 pjesëmarrës

		Rishtë në legjislacionin penal. Mbështetja e viktimave të trafikimit gjatë procesit penal.	(6 gjyqtarë, 6 prokurorë)
17.	2 qershor 2021	Kriteret ligjore dhe procedura specifike e aplikimit të “Lirimit me kusht” të të miturit në konflikt me ligjin. Dallimet në zbatimin e Institutit të “Lirimit me kusht” ndaj të dënuarit madhor dhe të miturit në konflikt me ligjin. Zëvendësimi i pjesës së pakryer të dënimit si një risi në legjislacionin penal të drejtësisë për të mitur. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë. Lirimi me kusht i të dënuarve me burgim të përjetshëm (Standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ-së); Aspekti krahasimor me vendet e tjera.	34 pjesëmarrës (17 gjyqtarë, 12 prokurorë, 5 OPGJ)
18.	23 qershor 2021	Trafikimi i të miturve. Metodatat e hetimit të trafikimit të të miturve. Kuadri ligjor ndërkombëtar e kombëtar i zbatueshem. Evidentimi i formave të krimit të trafikimit. Jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi çështjet e trafikimit të të miturve. Problematikat dhe sfidat në luftën kundër trafikimit të të miturve. Mbrojtja nga zhdukjet me forcë.	24 pjesëmarrës (8 gjyqtarë, 8 prokurorë, 8 OPGJ)
19.	1-2 korrik 2021	Masat e sigurimit personal ndaj të miturit në konflikt me ligjin, veçanërisht masat e veçanta për të miturit, trajtimi në veshtrim krahasues i zbatimit të tyre përgjatë viteve 2018-2020 referuar jurisprudencës vendase dhe asaj ndërkombëtare.	26 pjesëmarrës (11 gjyqtarë, 7 prokurorë, 8 OPGJ)
20.	11-12 tetor 2021	Roli i prokurorëve dhe gjyqtarëve në ekzekutimin e shmangies, dënimeve penale ndaj të miturve. Qasje praktike për intervistimin e të miturve gjatë hetimit dhe gjykimit.	16 pjesëmarrës (5 gjyqtarë, 8 prokurorë, 3 specialistë)
21.	28 shkurt 2022	Shfrytëzimi seksual online i të miturve dhe metodatat e hetimit. i) figurat e reja të veprave penale të grooming, cyberbullying, cyberharrasment dhe revenge porn; ii) roli i rrjeteve sociale dhe moshës e aksesit në këto rrjete. Bashkëpunimi me platformat online dhe kompanitë që veprojnë në këtë fushë; iii) teknikat e posaçme të hetimit të këtyre veprave (edhe ato të cilat nuk përfshihen në kodin e RSH) iv) raportimi dhe ndihma për viktimat e shfrytëzimit online. Problemet juridiksionale.	18 pjesëmarrës (4 gjyqtarë, 6 prokurorë, 2 këshilltarë ligjor, 3 OPGJ, 3 kandidatë për magjistrat)
22.	26-27 maj 2022	Trafikimi i Qenieve Njerëzore.	18 pjesëmarrës

		Nëntemat: - Pozicioni procedural dhe mbështetja e viktimave gjatë gjykimit të çështjeve të trafikimit. Intervistimi i viktimave. - Kompensimi për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. - Interesi më i lartë i fëmijës viktimë e trafikimit.	(5 gjyqtarë, 7 prokurorë, 5 OPGJ, 1 kandidat për magistrat)
23.	30 nëntor 2022	Fillimi kryesisht i procedimit penal dhe pavarësia e prokurorit. Kuadri ligjor. Rastet dhe procedura që ndiqet për regjistrimin e procedimit kryesisht. Standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare.	45 pjesëmarrës (2 gjyqtarë, 35 prokurorë, 3 OPGJ, 5 këshilltarë ligjor)
24.	26 qershor 2023	Trafikimi i qenieve njerëzore, personave të rritur dhe të mitur. Kuadri ligjor ndërkombëtar e kombëtar i zbatueshëm dhe format e kryerjes së krimit të trafikimit. Metodat, teknikat e posaçme në kryerjen e hetimeve të trafikimit dhe instrumentet e ndihmës së ndërsjellë juridike në funksion të hetimit. Specifikat e intervistimit të të miturit, viktimë e trafikimit	13 pjesëmarrës (2 gjyqtarë, 5 prokurorë, 5 OPGJ, 1 psikolog)

36. What procedures and measures exist in your country to take into account the specific needs of vulnerable victims at the different stages of criminal proceedings?

Neni 58 “Të drejtat e viktimës së veprës penale” (Shtuar pika 3 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) parashikon:

1. Viktima e veprës penale ka të drejtë:

a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;

b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;

c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;

ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;

d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;

dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtojë kërkesa të tjera përpara organit procedues;

e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;

ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;

f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;

g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;

gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;

h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;

i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;

j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.

3. Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.

4. Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j”, të paragrafit 1, të këtij neni. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

Neni 58/a i Kodit të Procedurës Penale parashikon të drejtat e viktimës së mitur.

1. I mituri viktima e veprës penale, përveç të drejtave të parashikuara në nenin 58 dhe dispozitat e tjera të këtij Kodi dhe legjislacionit të veçantë për të miturit, ka të drejtë:

a) të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;

b) të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;

c) të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.

2. Organi procedues duhet të trajtojë viktimën e mitur të veprës penale duke mbajtur parasysht moshën, personalitetin dhe rrethana të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm.

3. Nëse ekziston mundësia që viktima është e mitur dhe mosha e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur.

4. Viktima e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kriterëve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. Kur viktima e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedise të përshtatura për të.

Neni 58/b parashikon të drejtat e viktimës së dhunuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore.

Veç të drejtave të parashikuara në nenet 58 dhe 58/a, të këtij Kodi, viktima e abuzuar seksualisht dhe viktima e trafikimit të qenieve njerëzore kanë gjithashtu të drejtë:

a) të pyeten pa vonesë nga një oficer i policisë gjyqësore ose prokuror i të njëjtës gjini;

b) të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale;

c) të kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

Gjithashtu, në zbatim të parashikimeve ligjore, në të gjitha prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm vijon ushtrimi i funksioneve nga koordinatorët për asistencën e viktimave, përfshirë dhe viktimat e trafikimit. Në këtë fushë vijon zbatimi i detyrave të koordinatorëve të përcaktuara në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.5, datë 26.10.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, ku përfshihet dhe letra e të drejtave të viktimës, si dhe akte të tjera që lidhen me informimin e viktimave të trafikimit lidhur me ecurinë e procesit penal.

37. If you have criminalised the use of services of a victim of THB, how is this provision applied in practice? Please provide any relevant case-law.

Përdorimi i shërbimeve të njeriut është i kriminalizuar në vendin tonë, kjo parashikohet në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, neni 110/b. Në këtë nen thuhet se: “Përfitimi ose përdorimi i shërbimeve

të ofruara nga personat e trafikuar, apo shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke qenë në dijeni se personi është i trafikuar dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.”

Nuk ka pasur praktikë gjyqësore.

38. What technology-based tools and initiatives exist in your country to support investigations and enhance prosecution of THB cases? What training is provided to law enforcement officials, prosecutors and judges on THB facilitated by information and communication technology?

Vëmendje e veçantë i është kushtuar forcimit të kapaciteteve në luftën ndaj krimit kibernetik, provave elektronike dhe krimeve të tjera të lidhura me të. Pavarësisht se temat nuk janë drejtëpërdrejtë për trafikimin e qenieve njerëzore të lehtësuara nga internet apo teknologjia e informacionit, këto trajnime i shërbejnë hetimit të çdo vepre penale. Trajnimet/takimet e kryera nga Prokuroria e Përgjithshme janë si më poshtë:

- Trajnim me temë, "Rritja e reagimit të strukturave të drejtësisë mbi identifikimin e provave në çështjet e hetimit të trafikimit të personave në Europën Juglindore", organizuar në datat 4-6 Prill 2023 në Shkup, me pjesëmarrjen e një prokurori;
- Trajnim me temë "Forcimi i kapaciteteve të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë në Shqipëri dhe bashkëpunimi mes agjencive në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore", organizuar nga OSBE në Tiranë në datën 2 mars 2023, me pjesëmarrjen e 3 prokurorëve;
- Në kuadrin e bashkëpunimit me projektin EU4LEA, një delegacion me përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, SPAK, Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit etj, ka marrë pjesë në një vizitë zyrtare të zhvilluar në Hagë, Hollandë në datat 27-29 shtator 2023 në selinë e Europol dhe Eurojust, si pjesë e planit të punës për fazën e 3-të të projektit, "Rritja e kapaciteteve operacionale të SPAK, PSH, PP/PO në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm, korrupsionit të nivelit të lartë dhe mjedisit".
- Në kuadrin e Projektit EU4FOCAL është organizuar aktiviteti "Trajnim mbi krimin kibernetik dhe e-evidence", organizuar në datat 9-10 Maj, në Lisbonë, Portugali dhe në datat 28-29 September në Sofie, Bulgari me pjesëmarrjen e një prokurori.
- Samiti i nivelit të lartë për luftën kundër krimit kibernetik në Evropën Julindore, organizuar në Kroaci në datat 21-23 Maj 2023, me pjesëmarrjen e dy prokurorëve.
- Trajnim lidhur me krimin kibernetik, organizuar nga iProceeds, në datat 11-12 prill në Vjenë, me pjesëmarrjen e një prokurori.

Koordinatorët e viktimave në Prokurorinë e Përgjithshme, kanë qenë referues/drejtues në kuadër të muajit kombëtar të trafikimit të qenieve njerëzore, organizuar në ambientet e Këndit Amerikan me grupin e të rinjve, për marrjen e njohurive për trafikimin e qenieve njerëzore. Koordinatorët e viktimave në prokuroritë e rretheve gjyqësore kanë marrë pjesë në disa trajnime me tematika të lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore, si më poshtë:

- Trajnim me temë: "Rritja e angazhimit të të rinjve dhe insitucioneve vendore në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave", organizuar nga Qendra Psiko-Sociale Vatra me pjesëmarrjen e koordinatorëve të viktimave të prokurorive të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- Trajnim me temë: "Lufta kundër krimit kibernetik" tek të rinjtë dhe të miturit, pjesë e projektit RAYS i Mbretërisë së Bashkuar me pjesëmarrjen e koordinatorëve të viktimave të prokurorive pranë gjykatave së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Shkolla e Magjistraturës përgjatë vitit 2023 ka zhvilluar këto trajnime:

- Janar 2023 është zhvilluar trajnimi me temë "Shfrytëzimi seksual online i të miturve dhe metodat e hetimit", ku kanë marrë pjesë 10 prokurorë dhe 6 oficerë të policisë gjyqësore;
- Qershor 2023, është zhvilluar trajnimi me temë "Trafikimi i qenieve njerëzore", ku kanë marrë pjesë 5 prokurorë dhe 5 oficerë të policisë gjyqësore.

Lidhur me trajnimet, për më tepër shih pyetjen 35 më lart.

39. In what ways, if any, does your country utilise provisions from the Council of Europe Cybercrime Convention (Budapest Convention) to fight THB? If not, why is that the case?

Me ligjin nr.8888, datë 25.4.2002 Për ratifikimin e “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Budapestit dhe me ligjin nr. 9262, datë 29.7.2004, “Për ratifikimin e protokollit shtesë të konventës për krimin kibernetik, për penalizimin e akteve me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike”, bëri pjesë të rendit të saj juridik edhe protollin e saj shtesë.

Për të reflektuar angazhimet e këtyre akteve, janë miratuar në Kodin Penal ndryshime me ligjin nr. 10023/2008 dhe nr.10054/2008. Në Kod, veprat penale kompjuterike janë shtuar në krerë e seksione të veçanta duke iu bashkëngjitur dispozitave të tjera, bazuar në objektin juridik që mbrojnë. Bazuar edhe në nenin 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme.

Part II – Country-specific follow-up questions

40. Please provide information on measures taken in your country in respect to the following recommendations made in GRETA’s previous reports:

- ☐ adopt measures to facilitate and guarantee access to compensation for victims of THB;

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023 u miratua “Udhërrëfytyesi për shtetin e së drejtës”. Udhërrëfytyesi është dokumenti i politikave shtetërore, piketave hapëse të grupkapitullit të parë “Themeloret” (Kapitulli 23 dhe 24), në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Periudha e zbatimit të kësaj VKM-je është 2024-2030. Tek kapitulli 24 “Liria dhe siguria e drejtësisë, pika 5: Trafikimi i qenieve njerëzore, tek shtylla “Performanca”, është parashikuar masa: Kuadër i përmirësuar legjislativ për mbrojtjen e viktimave, ku përfshihet edhe kompensimi i tyre.

<https://www.drejtësia.gov.al/baza-ligjore-dokumente/>

Me mbështetjen e UNICEF-it në Shqipëri, Projektit JUSTAL të BE-së dhe Prezencës së OSBE-së, Qeveria e Shqipërisë miratoi për herë të parë Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030 dhe Planin e saj të Veprimit. Ndër të tjera, Strategjia parashikon edhe kompensimin e viktimave. Këtu është lidhja e Strategjisë së miratuar:

<https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/186/198e150f-ed3e-4938-846f-d6afb328dd0b>

- ☐ take additional measures to ensure that THB cases are investigated proactively, prosecuted effectively, and lead to effective, proportionate and dissuasive sanctions;

Ministria e Drejtësisë është në procesin e hartimit të një Kodi të ri Penal në Shqipëri. Projektligji synon të përmirësojë kuadrin ligjor të së drejtës penale materiale, bazuar në zhvillimin e praktikës gjyqësore, unifikimin e jurisprudencës ndërmjet Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sigurimin e standardeve ndërkombëtare, përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe zbatimin e praktikave më të mira nga vendet e tjera.

Hartimi i Kodit të ri Penal doli si përgjigje ndaj ndryshimeve dhe shtesave të shpeshta të pasqyruara në përmbajtjen e Kodit Penal ekzistues. Kjo nismë trajton mungesën e efektivitetit në ndryshimet e bëra ndër vite, si rezultat i modifikimeve të sanksioneve për veprat penale, riformulimit të dispozitave dhe nevojës për harmonizim ndërmjet tyre, përafrimin e Kodit Penal me aktet ndërkombëtare në fuqi, si dhe përputhshmërinë e tij me legjislacionin e Bashkimit Evropian, duke pasur parasysh anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Aktualisht, fokusi i drejtësisë penale, i ndikuar nga zhvillimet globale, përfshin luftën kundër pastrimit të parave, terrorizmit, mbrojtjen e të drejtave financiare, mbrojtjen e mjedisit, parandalimin e trafikut të drogës dhe ndalimin e tregtisë dhe qarkullimit të armëve të zjarrit të ndaluara. Në këtë kuadër, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, të gjitha masat që lidhen me shfrytëzimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore, veçanërisht të të miturve, të përcaktuara në aktet e Bashkimit Evropian, janë pjesë e procesit të hartimit të Kodit të ri Penal.

Miratimi i Kodit të ri Penal është planifikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian për vitet 2024-2026, me synim përafrimin e tij me direktivat në fushën e së drejtës penale. Një nga këto direktiva është Direktiva 36/2011 “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave, dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/CBD”. Rrjedhimisht, janë krijuar grupe pune ndërinstitucionale për të përgatitur një analizë të nivelit të përafrimit dhe mangësive në legjislacionin penal aktual në lidhje me përmbajtjen e Direktivës, me qëllim pasqyrimin e këtyre mangësive në projektligjin për miratimin e Kodit të ri Penal.

Kjo është thelbësore sepse, pavarësisht rëndësisë që i jepet luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, përfshirja e dispozitave nga Direktiva 36/2011 në legjislacionin e brendshëm është e nevojshme. Direktiva përcakton një standard minimal rregullash në lidhje me përcaktimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore. Ajo përfshin gjithashtu dispozita në lidhje me perspektivën gjinore për të forcuar parandalimin e këtij krimi dhe mbrojtjen e viktimave të tij. Dënimet në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore duhet të jenë efektive, parandaluese dhe proporcionale. Përfshirja e zyrtarëve publikë në trafikim konsiderohet një rrethanë e rëndësishme, duke garantuar dënime shtesë kur personat juridikë përfshihen në aktivitete kriminale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore. Direktiva përshkruan detyrimet shtetërore për të ndihmuar viktimat e trafikimit, mbrojtjen e fëmijëve viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore dhe kompensimin e tyre.

- ▣ increase efforts to proactively identify victims of trafficking for the purpose of labour exploitation;

Me ligjin nr. 13/2022, Shqipëria ka ratifikuar konventën nr. 190 për ndalimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës. Me qëllim ndërveprimin e palëve në luftën kundër diskriminimit dhe pabarazisë në punë, më datë 22.02.2023, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD).

Gjithashtu, është hartuar Memorandumi i Bashkëpunimit “Për procedurat e bashkëpunimit për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë”, ndërmjet

Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, i cili do të nënshkruhet muajt në vijim. Qëllimi i këtij memorandumit është rritja e masave parandaluese për identifikimin proaktiv si dhe mbrojtjen e viktimave të punës së detyruar dhe trafikimit. Fokusi kryesor i memorandumit është zbatimi i parimit të ligjshmërisë për ndalimin e punës së detyruar, mbrojtja e të dhënave personale, respektimi i të drejtës së lirisë së lëvizjes, mbrojtja shoqërore në punë, mosdiskriminimi, si dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve. Memorandumi do të kontribuojë në vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë midis institucioneve palë në të, me qëllim shmangien e vonesave në shkëmbimin e informacionit, por edhe ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta me qëllim parandalimin dhe identifikimin e rasteve të shfrytëzimit në punë.

Gjatë vitit 2023, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore me mbështetjen teknike të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe financim të Bashkimit Evropian (BE) në kuadër të Projektit ESAP 2, ka bërë të mundur përmirësimin e sistemit të analizës së Rriskut, e cila synon forcimin e efikasitetit të Sistemit të Vlerësimit të Riskut në procesin e planifikimit të subjekteve, duke u mbështetur në historikun dhe analizën e të dhënave historike apo ndërthurjen e çdo faktori risku të vlerësuar në nivel sektori, rajoni, etj. Kjo vlerësohet si një zhvillim i rëndësishëm për ISHPSHSH drejt një inspektimi më të efektshëm dhe me cilësi në funksion të punës së denjë, sigurisë dhe kujdesit të shëndetit në punë.

Gjatë vitit 2023, ISHPSHSH ka qenë pjesë e aktiviteteve të zhvilluara në lidhje me Konventën C190, si më poshtë:

- Trajnim për Trajnerë 18-19 prill 2023 me temë “Kuatridhe ligjor, standardet ndërkombëtare dhe praktika kombëtare e ndërkombëtare lidhur me diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin në botën e punës dhe rolin e ndërveprimit të institucioneve inspektuese/monitoruese”;
- Takim informues 23 maj 2023 me temë “Fenomeni i diskriminimit, dhunës e ngacmimit si çështje të sigurisë dhe të shëndetit në punë. Roli i aktorëve”;
- Trajnim 22-23 qershor 2023 me temë “Shqyrimi i ankesave lidhur me diskriminimin, ngacmimin dhe dhunën në botën e punës dhe mjetet efektive me qëllim zbatimin e nenit 10/h të Konventës 190, të tilla si: autorizimi për të trajtuar dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, duke përfshirë lëshimin e urdhrave që kërkojnë marrjen e masave me forcë ekzekutuese të menjëhershme; urdhra për të ndaluar punën në rastet e një rreziku të afërt për jetën, shëndetin ose sigurinë, etj.;
- Më datat 23 tetor – 26 tetor 2023, janë kryer inspektimet dypalëshe ISHPSHSH-KMD;
- Më datë 11 dhjetor 2023 u zhvillua Konferenca vjetore ISHPSHSH – KMD “Së bashku në një bilanc vjetor të arritjeve dhe përvojave në lidhje me reduktimin dhe eliminimin e diskriminimit, dhunës e ngacmimit në botën e punës.

Kështu, riinxhinierimi i Sistemit të Analizës së Rriskut dhe pjesëmarrja në aktivitetet e zhvilluara në kuadër të zbatimit të Konventës 190, janë përpjekje dhe masa të marra nga ISHPSHSH për të identifikuar në mënyrë proaktive viktimat e trafikimit me qëllim shfrytëzimin e punës.

- provide sufficient funding to NGOs assisting victims of THB and improve the assistance services available for male victims.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vite me radhë financon nga buxheti i shtetit 3 qendrat joshtetërore pritëse dhe riintegruese (“Vatra”, “Të ndryshëm të barabartë” dhe “Tjetër Vizion”) për pagesat e punonjësve socialë që ofrojnë shërbime në qendra rezidenciale dhe për fond ushqimesh për viktimat e trafikimit.

Më poshtë do të gjeni fondet e alokuara nga buxheti i shtetit për 3 qendrat pritëse dhe riintegruese joshitetërore, si dhe për Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut (QKPVT), e cila është qendër shtetërore.

Viti 2019:

Për vitin 2019 u lëvrua fondi nga buxheti i shtetit për pagesat e 29 punonjësve socialë që ofrojnë shërbime në qendra rezidenciale dhe për fond ushqimesh për viktimat e trafikimit, nëpërmjet subjekteve jopublike, Shoqatës “Tjetër Vizion”, “Vatra”, dhe Të ndryshëm të barabartë”. Specifikisht:

Qendra “Të ndryshëm & të Barabartë”	2.306.800 lekë fond ushqimesh 6.747.687 lekë fond pagash (9 punonjës)
Qendra “Tjetër Vizion”	2.190.000 lekë fond ushqimesh 5.792.615 lekë fond pagash (8 punonjës)
Qendra “Vatra”	2.306.800 lekë fond ushqimesh 8.976.564 lekë fond pagash (12 punonjës)

Për QKPVT fondi në total është 20.130.000 lekë, ku 8.200.000 lekë janë fonde për shpenzimet operative.

Viti 2020:

Për vitin 2020 u çel fondi nga buxheti i shtetit për pagesat e 28 punonjësve socialë që ofrojnë shërbime në qendra rezidenciale dhe për fond ushqimesh për viktimat e trafikimit, nëpërmjet subjekteve jopublike, Shoqatës “Tjetër Vizion” “Vatra”, dhe “Të ndryshëm & të barabartë”. Specifikisht:

Qendra “Të ndryshëm & të Barabartë”	2.306.800 lekë fond ushqimesh 6.747.687 lekë fond pagash (9 punonjës)
Qendra “Tjetër Vizion”	2.190.000 lekë fond ushqimesh 1.792.615 lekë fond pagash (8 punonjës)
Qendra “Vatra”	2.306.800 lekë fond ushqimesh 8.976.564 lekë fond pagash (11 punonjës)

Për QKPVT fondi në total është 29.250.000 lekë, ku 8.000.000 lekë janë fonde për shpenzimet operative dhe 21.250.000 fond pagash.

Viti 2021:

Për vitin 2021 u çel fondi nga buxheti i shtetit për pagesat e 30 punonjësve socialë që ofrojnë shërbime në qendra rezidenciale dhe për fond ushqimesh për viktimat e trafikimit, nëpërmjet subjekteve jopublike, Shoqatës “Tjetër Vizion” “Vatra”, dhe “Të ndryshëm & të barabartë”. Specifikisht:

Qendra “Të ndryshëm & të barabartë”	2,306,800,800 lekë fond ushqimesh 6,784,658 lekë fond pagash (9 punonjës)
Qendra “Vatra”	2.306.800 lekë fond ushqimesh

	9,446,272 lekë fond pagash (12 punonjës)
Qendra “Tjetër Vizion”	2,193.000 lekë fond ushqimesh 5,792,615 lekë fond pagash (9 punonjës)

Për QKPVT fondi në total është 22.350.000 lekë, për shpenzime operative, paga dhe sigurime dhe 21.250.000 fond pagash.

Viti 2022:

Për vitin 2022 u çel fondi nga buxheti i shtetit për pagesat e 30 punonjësve socialë që ofrojnë shërbime në qendra rezidenciale dhe për fond ushqimesh për viktimat e trafikimit, nëpërmjet subjekteve jopublike, Shoqatës “Tjetër Vizion” “Vatra”, dhe “Të ndryshëm & të barabartë”. Specifikisht:

Qendra “Të ndryshëm & të Barabartë”	2.306.800 lekë fond ushqimesh 6.747.658 lekë fond pagash (9 punonjës)
Qendra “Tjetër Vizion”	2.628.000 lekë fond ushqimesh 6.406.796 lekë fond pagash (9 punonjës)
Qendra “Vatra”	2.306.800 lekë fond ushqimesh 9.499.501 lekë fond pagash (12 punonjës)
QKPVT	7.290.000 lekë fond ushqimesh 12.828.000 lekë fond pagash (17 punonjës)

Viti 2023:

Për vitin 2023 u çel fondi nga buxheti i shtetit për pagesat e 30 punonjësve socialë që ofrojnë shërbime në qendra rezidenciale dhe për fond ushqimesh për viktimat e trafikimit, nëpërmjet subjekteve jopublike, Shoqatës “Tjetër Vizion” “Vatra”, dhe “Të ndryshëm & të barabartë”.
Specifikisht:

Qendra “Të ndryshëm & të Barabartë”	2 306 800 lekë fond ushqimesh 6,748,658 lekë fond pagash (9 punonjës)
Qendra “Vatra”	2 306 800 lekë fond ushqimesh 9 499 501 lekë fond pagash (12 punonjës)
Qendra “Tjetër Vizion”	2 628 000 lekë fond ushqimesh 6,406,794 lekë për 9 punonjës

Për QKPVT janë alokuar 24,131,000 lekë, nga të cilat 16,661,000 lekë për paga dhe sigurime, ndërsa 1,258,014 lekë për ushqime dhe 7,470, 000 lekë për shpenzime operative.

Në shkurt 2023, Vatra aplikoi për një projekt në Ministrinë e Drejtësisë, pas thirrjes për propozime që Ministria hapi për organizatat e autorizuara nga Ministria për ofrimin e mbështetjes ligjore parësore për viktimat. Pas miratimit të projektit, Ministria e Drejtësisë financoi projektin e Vatrës me një fond prej 1,026,224 lekë.

41. Please provide information on developments in your country since GRETA's third evaluation report concerning:

- ☐ emerging trends of trafficking in human beings;

Shih pyetjen 1:

- ☐ the legislation and regulations relevant to action against THB;

Kuadri ligjor dhe institucional që rregullon, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, luftën kundër trafikimit të personave:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;
- Kodi Penal, neni 110/a “Trafikimi i të rriturve”, neni 128/b “Trafikimi i të miturve”, neni 298 “Ndhma për kalim të paligjshëm të kufijve”, neni 124/b “Keqtrajtimi i të miturit”, neni 117 “Pornografia”
- Ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 108/2014, “Për policinë e shtetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”;
- Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit përmes masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- Ligji nr. 98/2017, “Për tarifatat gjyqësore në RSH”;
- Ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”;
- Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1140, datë 24.12.2020, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e Veprimit 2023–2025”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 195, datë 11.4.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në

- rrezik trafikimi”;
- Vendimi nr. 933, datë 2.7.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe Europol”, i ndryshuar;
 - Vendimi nr. 729, datë 13.12.2023 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024-2030, planit të veprimit të saj dhe pasaportës së treguesve”;
 - Vendimi nr.81, datë 14.2.2023 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2023-2025 dhe planin e veprimit 2023-2025”;
 - Vendimi nr.81, datë 14.2.2023 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Afësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024”;
 - Vendimi nr. 892, datë 27.12.2022 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë për të mitur 2022–2026, planit të veprimit dhe të pasaportës së indikatorëve”;
 - Vendimi nr. 91, datë 9.2.2022 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve, 2021-2025”;
 - Urdhri nr. 805, datë 1.8. 2017, i ministrit të Brendshëm, “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”;
 - Marrëveshja e bashkëpunimit për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave (MKR), datë 26 qershor, 2023.
 - Udhëzimi i përbashkët nr. 132, datë 8.9.2023, “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”;
 - Memorandumi i mirëkuptimit, i Ministrisë së Brendshme, i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe i Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë në Shqipëri (OSCE) “Për promovimin dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm” (nënshkruar në vitin 2007).
- ☐ the institutional and policy framework for action against THB (co-ordinating bodies, specialised entities, national rapporteur or equivalent mechanism, involvement of civil society, public-private partnerships);

Në vazhdimësi ekziston vullneti politik i Qeverisë shqiptare për të luftuar fenomenin e trafikimit dhe për të trajtuar dhe mbrojtur viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Bazuar në Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 18, datë 19.01.2024 “Për caktimin e detyrave që mbulon zëvendësministri i Brendshëm”, Zëvendësministrit të Brendshëm i ngarkohet të ndjekë, monitorojë dhe koordinojë bashkëpunimin me institucionet e ngarkuara për zbatimin e masave në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Drejtoria e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin mbetet struktura kryesore e përqendruar në veprime dhe politika kundër trafikimit të personave, e cila koordinon dhe monitoron aktivitetet antitrafik në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Gjatë periudhës raportuese, janë ndërmarrë masa të rëndësishme në drejtim të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional, për një përgjigje të bashkërenduar dhe efektive, me qëllim parandalimin, identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e VT/VMT, si dhe ndjekjen penale dhe dënimin e trafikantëve. Konkretisht, disa nga aktet kryesore janë, si më poshtë:

Më datë 26 qershor 2023 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit për Funkcionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit të Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit të Personave (MKR). Marrëveshja përfshin 15 institucione shtetërore dhe joshtetërore. Fokusi kryesor i kësaj marrëveshjeje është viktima dhe mbrojtja e saj, duke shqyrtuar çdo situatë rast pas rasti dhe ndërton disa standarde të pranuar nga të gjithë për mënyrën sesi zhvillohet i gjithë procesi i identifikimit, referimit dhe, më pas, i mbrojtjes së viktimës së trafikimit. Përveç viktimave të trafikimit, kjo marrëveshje merr në mbrojtje edhe viktimat e mundshme të trafikimit, duke synuar kështu ushtrimin e një mbrojtjeje parandaluese për ata persona që mund të jenë viktima të mundshme trafikimi. Ky është instrumenti më i rëndësishëm për sa i përket identifikimit, referimit, mbrojtjes dhe asistencës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Proces i hartimit të marrëveshjes është produkt i një procesi të gjatë konsultimesh dhe debatesh konstruktive ndërmjet një numri të konsiderueshëm agjencish të rëndësishme shtetërore, joshtetërore, të pavarura dhe të shoqërisë civile kombëtare dhe ndërkombëtare me një përvojë të gjatë në parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të personave, asistimin dhe mbrojtjen e viktimave jo vetëm në Shqipëri, por edhe përtej saj. Gjithashtu, me qëllim rritjen e rolit të inspektorëve të punës në identifikimin fillestar të viktimave të mundshme të trafikimit dhe adresimin e qasjes me “në qendër” viktimën nëpërmjet arsimimit dhe formimit profesional, është anëtarësuar në MKR, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Ndërsa, Ministria e Brendshme, përpos Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit përfaqësohet edhe nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Nisur nga fusha e përgjegjësisë është përfshirë në MKR edhe Ministria e Drejtësisë, si mbikëqyrëse e ndihmës juridike dhe kompensimit të viktimave të trafikimit. MD ka në juridiksionin e saj Komisionin Shtetëror për Asistencë Ligjore Falas.

Udhëzimi i Përbashkët Nr. 132, datë 08/09/2023 "Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit" nënshkruar nga Ministri i Brendshëm, Ministri i Arsimit dhe Sportit, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme. Udhëzimi përcakton qartë detyrat e përgjithshme si dhe ato konkrete të Autoritetit Përgjegjës ndër të cilat janë: bashkërendimi i procesit të identifikimit, referimit, udhëheqja e zbatimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit lidhur me të gjitha rastet e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar dhe referuar në bazë të këtij mekanizmi në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit, si dhe detyrat specifike për secilin institucion/organizatë, në këtë udhëzim, për të cilat ato duhet të angazhohen t'i realizojnë brenda kapaciteteve që disponojnë. Në bazë të këtij udhëzimi, Autoriteti Përgjegjës, në përbërjen e tij ka një përfaqësues nga Drejtoria e Politikave të Antitrafikut dhe Migracionit (drejtori-kryetar), 4 përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Sektori kundër Trafikeve të Paligjshme, Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, Sektori i Dhunës në Familje dhe Mbrojtjes së të Miturve dhe Sektori kundër Krimit Kibernetik) një përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror, një përfaqësues nga MSHMS, një përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, një përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, një përfaqësues nga Drejtoria Konsullore në MEPJ, një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe një përfaqësues nga KKSAT. Në mbledhjet e AP-së ftohen të jenë të pranishëm përfaqësues nga Prokuroria dhe përfaqësues nga anëtarë të tjerë të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, në varësi të nevojave për mbështetje dhe ekspertizë, sipas rasteve që do të trajtohen. Sektori i Antitrafikut në MB, shërben si Sekretariati Teknik i AP-së.

Komitetet Rajonale të Luftës kundër Trafikimit të Personave, janë struktura antitrafikim të ngritura në 12 qarqet e vendit dhe drejtohen nga Prefektët e qarqeve. Funkzionet kryesore të Komitetit, janë kryesisht në drejtim të parandalimit të trafikimit nëpërmjet identifikimit të problemeve parësore, në nivel rajonal, si dhe nëpërmjet marrjes së masave për mbrojtjen e individëve dhe grupeve të rrezikuara nga trafikimi, duke krijuar një bazë të dhënash për të gjithë kategoritë dhe individët e rrezikuar nga trafikimi në nivel qarku. Gjatë periudhës raportuese, një rëndësi e veçantë i është kushtuar forcimit të Komiteteve Rajonale Antitrafik me qëllim të funksionimit më të mirë të tyre në lidhje me parandalimin e trafikimit përmes identifikimit të problemeve prioritare në nivel rajonal, si dhe përmes vlerësimit të situatës dhe përcaktimit të nevojave specifike brenda rajonit.

Gjatë vitit 2019, Ministria e Brendshme në bashkëpunim me Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Antitrafik (KKSAT) nënshkruan Marrëveshjen ndërmjet Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik “Mbi Ngritjen dhe Funksionimin e Bordit Këshillimor për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit (Nr. 2931 Prot, datë 08.04.2019). Në datë 30 maj 2019 u ngrit Bordi Këshillimor për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit me 3 anëtarë. Në zbatim të Marrëveshjes, u hartua Rregullorja e Bordit, Deklarata e Konfidencialitetit dhe Deklarata e Pëlqimit. Bordi ka rol këshillues për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, të parandalimit, ndjekjes penale dhe në veçanti mbrojtjes së VT dhe një rol aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi shfrytëzimin e personave për qëllime seksuale, punë të detyruar, lypje, apo forma të tjera të shfrytëzimit. Janë zhvilluar disa takime me anëtarët e Bordit Këshillimor, ku anëtarët kanë dhënë sugjerime mbi ruajtjen e konfidencialitetit, të privatësisë, zhvillimin e trajnimeve për punonjësit e policisë lidhur me intervistimin e viktimës, komunikimin etik dhe profesional.

Prej vitit 2018, zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.499, datë 29.08.2018 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”. Fokusi kryesor i këtyre procedurave është viktimat dhe mbrojtja e saj, duke shqyrtuar çdo situatë rast pas rasti dhe duke ndërtuar disa standarde të pranuar nga të gjithë për mënyrën sesi do të zhvillohet i gjithë procesi i identifikimit, referimit dhe më pas, i mbrojtjes së viktimës së trafikimit. Duhet theksuar se, këto procedura zbatohen për të gjitha kategoritë e viktimave/viktimave të mundshme (të mitur dhe të rritur, femra dhe meshkuj, shqiptarë dhe të huaj) që janë subjekt i trafikimit për të gjitha llojet e shfrytëzimit.

Ministria e Brendshme është duke drejtuar procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e saj të Veprimit, që do të përfshijë periudhën 2024-2030. Ky dokument po hartohet në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 9, datë 26.1.2023 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e saj të Veprimit”. Qëllimi kryesor strategjik është “Qeverisja e efektshme e migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të problematikave dhe sfidave që lindin nga lëvizjet migratore, duke synuar rritjen e ndikimit të migracionit tek zhvillimi, në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë shqiptare”. Qëllimet politike referuar parashikimeve të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) dhe vlerësimeve të arritjeve politike në fushën migratore janë katër, të cilat përbëjnë dhe katër shtyllat kryesore të dokumentit të ri strategjik, si më poshtë:

1. Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri;
2. Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit tek zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/lokal;
3. Promovimi i migracionit të rregullt, mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare.

4. Forcimi i sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, garantimi i të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme”.

Draft Strategjia Kombëtare e Migracionit 2024-2030 pritet të miratohet së shpejti.

Ministria e Brendshme e konsideron shumë të rëndësishme koordinimin e përpjekjeve ndërmjet organizatave ndërkombëtare që punojnë në fushën e antitrafikimit. Duke pasur parasysh interesin ndërkombëtar dhe mbështetjen e vazhdueshme të ofruar nga disa qeveri të huaja dhe subjekte të tjera, Ministria e Brendshme, më datë 27 tetor 2022 organizoi takimin koordinues të donatorëve, të cilët vepron në fushën e trafikimit. Në takim morën pjesë përfaqësues të Delegacionit Evropian, Këshillit të Evropës, Ambasadës Amerikane, Ambasadës Angleze, Ambasadës Holandeze, UN, OSBE, IOM, GIZ dhe UNICEF, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Brendshme. Donatorët pjesëmarrës në këtë takim u njohën me prioritetet e Qeverisë Shqiptare në fushën e trafikimit, duke u fokusuar tek synimet strategjike dhe objektivat specifike, sipas VKM-së nr.670, datë 10.11.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023”.

Në takim u diskutua lidhur me forcimin e bashkëpunimit mes organizmave ndërkombëtarë dhe strukturave shtetërore, të cilat kanë në fushën e përgjegjësisë së tyre luftën kundër trafikimit të personave, koordinimin e veprimeve në realizimin e prioritetëve dhe objektiveve të qeverisë shqiptare, sa i takon zbatimin të masave të planit të veprimit antitrafik, si dhe mbështetjen dhe bashkëpunimin e donatorëve nëpërmjet implementimit të projekteve dhe suportit të tyre financiar, që do të jenë një vlerë e shtuar për ndërhyrjet programore aktuale dhe të ardhshme.

Në kuadër të integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Qeveria Shqiptare miratoi për herë të parë Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030 me vendimin nr.729 më 13 dhjetor 2023, duke e përafuar me prioritetet dhe programin e Qeverisë Shqiptare. Strategjia, e hartuar nga Ministria e Drejtësisë, është përgatitur në frymën e Strategjisë së BE-së për të drejtat e viktimave 2020-2025, si dhe të acquis të BE-së në lidhje me mbrojtjen e viktimave të krimit. Strategjia fokusohet tek viktimat e veprave kriminale në përgjithësi dhe ato me nevoja specifike për mbrojtje. Ai i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të viktimave të krimit, duke ofruar një sistem drejtësie penale të aksesueshme, transparente dhe efikase që mbështet të drejtat e njeriut sipas standardeve evropiane.

Ndër të tjera, dokumenti strategjik thekson edhe koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në zbatimin e mekanizmave mbrojtës dhe rehabilitues për viktimat e krimit, duke krijuar mjedise të sigurta për viktimat, veçanërisht duke pasur parasysh grupet e cënueshme dhe komunitetet e marginalizuara me akses të kufizuar në drejtësi. Në këtë kuadër, strategjia ka planifikuar zhvillimin e “Javës së Ndërgjegjësimit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit në Shqipëri”, e cila organizohet në kuadër të “Ditës Evropiane të Viktimave të Krimit”, duke filluar nga shkurti i këtij viti (15-22 shkurt). Qëllimi është rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë në luftën për dhe mbrojtjen e viktimave të krimit.

Gjatë kësaj jave do të organizohen fushata sensibilizuese, diskutime informuese dhe aktivitete të tjera për të nxitur reflektimin dhe angazhimin për këtë çështje të rëndësishme. Përfaqësues nga institucionet qendrore dhe lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe komuniteti do të marrin pjesë në këto aktivitete, duke shkëmbyer njohuritë dhe duke shërbyer për të forcuar bashkëpunimin mes tyre në mbrojtjen e viktimave të krimit.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë penale për të miturit ka qenë në fokus të punës së Ministrisë së Drejtësisë, duke konfirmuar se ka ndërmarrë reforma të shumta ligjore në këtë fushë. Me synimin garantimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të reformës në drejtësinë penale për të miturit, Ministria e Drejtësisë ka hartuar strategjinë e dytë për drejtësinë për të miturit, miratuar me vendimin

e Këshillit të Ministrave nr.892, datë 27.12.2022, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Miturit 2022-2026, plani i veprimit dhe pasaporta treguese”.

Strategjia është hartuar duke marrë parasysh disa dokumente të rëndësishme ndërkombëtare dhe rajonale në lidhje me drejtësinë miqësore për fëmijët, raportet e progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe sugjerimet e dhëna nga institucionet bashkë-hartuese të kësaj Strategjie. Strategjia e re Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Miturit 2022-2026 synon riorganizimin e të miturve në konflikt me ligjin nëpërmjet normave dhe vlerave për rehabilitimin pozitiv, riintegrimin në komunitetin e tyre dhe parandalimin e sjelljeve recidiviste.

Ky dokument strategjik përbën dokumentin e politikave të qeverisë shqiptare që përshkruan shtyllat bazë të reformës në drejtësinë për të miturit dhe synon të promovojë një drejtësi miqësore dhe restauruese për të miturit në konflikt me ligjin, duke rritur kapacitetet dhe specializimin e aktorëve kryesorë në drejtësinë për të miturit duke konsoliduar aksesin e plotë në drejtësi, efektiv dhe profesional sipas standardeve të mirëpërcaktuara për çdo të mitur. Drejtësia miqësore për të miturit përfshin akses në shërbime mbështetëse me standarde, të aksesueshme në çdo kohë dhe për çdo fëmijë.

- ▣ the current national strategy and/or action plan for combating trafficking in human beings (objectives, main activities, budget, bodies responsible for the implementation, monitoring and evaluation of results);

Në vitin 2021, Qeveria miratoi Planin Kombëtar të Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 10.11.2021, i cili është dokumenti më i rëndësishëm politik dhe strategjik në vend në fushën e antitrafikimit.

Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave antitrafikim të parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin e saj të Veprimit, sigurisht, të përshtatura me dinamikën e trafikimit, vizionin e ri qeverisës në qasjen ndaj fenomenit të trafikimit për të krijuar një platformë të mirëorientuar synimesh e objektivash strategjike, në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare, si dhe bazuar në rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.

Zbatimi i këtij plani veprimi bazohej në bashkëpunimin e shumë aktorëve shtetërorë, ku rol më të spikatur ka pasur Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë dhe përfshinte një listë të gjerë aktorësh të tjerë shtetërorë, si: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit. PKV u realizua në bashkëpunim dhe me aktorë jo-shtetërorë që përfshin organizatat ndërkombëtare dhe organizata jo-fitimprurëse, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e antitrafikimit dhe adresimit të faktorëve nxitës të tij.

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave 2021-2023 ishte 412,552,420 Lekë, ose 3,300,419 Euro. Kursi mesatar për referencë u përlogarit me 125 lekë për 1 Euro.

Efektet financiare janë përlogaritur për çdo aktivitet të Planit të Veprimit, duke mbajtur në konsideratë produktet dhe treguesit e përcaktuar për çdo aktivitet. Efektet financiare janë parashikuar të përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhete të donatorëve dhe institucioneve të tjera që janë ngarkuar për zbatimin e masave. Planin e veprimit shoqërohej me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet.

Ministria e Brendshme me mbështetjen e OSBE-së, në tetor 2023 ka nisur procesin e përgatitjes së Planit të ri Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025. Më datë 26 tetor u prezantua drafti i Planit, tek anëtarët e MKR-së, të cilët përcollën komente dhe sugjerime lidhur me aktivitetet që do të parashikohen në të. Plani Kombëtar i Veprimit ruan ato elementë të vlerësuar si pika më të forta në luftën kundër trafikimit, por edhe duke u përditësuar me një përfaqje të re në përgjigje të nevojave dhe kontekstit të ri në të cilin ndodhemi. Në këtë Plan Veprimi janë ruajtur elementë të rëndësishëm që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen e agjencive shtetërore dhe joshtetërore, si dhe shtrirjen e veprimit të tij në të gjithë territorin e vendit, duke e vënë theksin sërish në forcimin e kapaciteteve dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor, bazuar edhe në reformën e re territoriale-administrative. Drafti i u finalizua në dhjetor 2023 dhe çdo aktivitet i parashikuar në dokument është i shoqëruar me koston financiare. Aktualisht është dërguar për mendim tek ministrinë e linjës. Gjithashtu, më datë 27 shkurt, Ministria e Brendshme do të organizojë një takim të përbashkët me anëtarë të MKR-së dhe me përfaqësues të organizmave ndërkombëtarë dhe përfaqësive diplomatike të akredituara në vendin tonë, ku do të prezantohen objektivat specifike dhe masat konkrete të Qeverisë Shqiptare për luftën kundër trafikimit të personave, si dhe adresimi politik i rekomandimeve të raporteve ndërkombëtare. Qëllimi i kësaj tryeze është kordinimi dhe bashkërendimi i masave të planifikuara në Planin e Veprimit 2024-2025 me organizatat dhe donatorët.

▣ recent case-law concerning THB for different forms of exploitation.

Vendimi njësesues i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 00-2022-1679 Vendimi (217) datë 27.07.2022. Për më shumë informacion, shih tek pyetja 32.

Part III - Statistics on THB

42. Please provide the following statistics, per year starting with 2019, where available disaggregated as indicated below:

▣ Number of presumed victims and identified victims of THB in the sense of having been recognised by a state institution or mandated NGO as bearers of rights to services provided for by the Convention (with breakdown by sex, age, nationality, form of exploitation, internal or transnational trafficking, and body which identified them).

Për periudhën raportuese 2019-2023 janë identifikuar gjithsej 625 VT/VMT. Më poshtë tabela me të dhëna, sa i takon statusit (viktimë/viktimë e mundshme trafikimi), gjinisë, moshës, shtetësisë dhe format e shfrytëzimit.

Viti	Gjithsej	VT	VMT	Meshkuj	Femra	Të rritur	Të mitur	Shqiptarë	Të huaj
2019	103 VT/VMT	7	96	23	80	36	67	97	6
2020	86 VT/VMT	5	81	24	62	28	58	83	3
2021	159 VT/VMT	5	154	60	99	47	112	156	3
2022	112 VT/VMT	2	110	31	81	38	74	109	3
2023	165 VT/VMT	1	164	50	115	56	109	161	4

Totali	625	20	605	188	437	205	420	606	19
	VT/VMT								

Format e shfrytëzimit	2019	2020	2021	2022	2023	Totali
Shfrytëzim seksual	65	48	59	60	80	312
Lypje	22	24	51	37	60	194
Punë e detyruar	4	3	16	5	3	36
Vepra të ulëta kriminale	4	7	25	9	19	64
Situatë rruge	7	1	7		1 (vjedhje)	16
Premtim për martesë/martese e detyruar	1	3	1	1	2	8

- ☐ Number of victims of THB identified as part of the asylum procedure (disaggregated by sex, age, nationality, form of exploitation).

Nuk ka.

- ☐ Number of victims of THB who received assistance (disaggregated by sex, age, nationality, form of exploitation, internal or transnational trafficking).

Gjatë periudhës raportuese, të gjitha viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit kanë marrë asistencë dhe mbrojtje në të tre fazat e integritetit të tyre, qoftë në qendra, familje, apartament apo në komunitet. Në vazhdimësi zbatohen programet dhe masat që qeveria ka ndërmarrë në drejtim të mbrojtjes së VT/VMT, përfshirë asistencën në arsim, shëndetësi, këshillim ligjor, strehim, etj. Gjithashtu, në zbatim të projekteve dhe programeve që zbatohen në bashkëpunim me organizatat partnere, është ofruar mbështetje për punësim, formim profesional, ngritje kapacitetesh, financim për ngritje biznesesh të vogla, etj. Më poshtë do të gjeni disa të dhëna dhe informacione:

Gjatë vitit 2019, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lëshoi karta shëndetësore për VT dhe VMT, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 141/2014 datë 23.10.2014 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përfshihen VT dhe VMT kategoria ekonomikisht joaktive e personave, kujdesi shëndetësor i të cilëve paguhet nga buxheti i shtetit. Për vitin 2019, janë pajisur me karta shëndeti gjithsej 55 VoT/PVoT.

Gjatë vitit 2019-2023 janë regjistruar pranë zyrave të punësimit, si punëkërkues të papunë gjithsej 87 viktima dhe viktima të mundshme të trafikimit. Ata kanë marrë informacion dhe këshillim sipas nevojave të tyre për mundësitë për të punuar në tregun e punës.

Në zbatim të programit “Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit në dhe nga Shqipëria”, Gjatë periudhës 2021-2022, rreth 24 përfitues/e janë përfshirë në programin e intershipit duke punuar në biznese të ndryshme. 25 përfitues janë mbështetur për përgatitjen e planeve të biznesit dhe hapjen e 25 bizneseve të vogla: dyqan për shitjen e rrobave, rrobaqepësi, estetikë, shitja e këpucëve të përdorura, dyqan për prodhim dhe shitje reçelrash, dyqan për pjekje, bluarje dhe shitje kafe, etj. Në zbatim po të këtij programi, bashkëpunimi rezultoi me punësimin e 70 individëve (gra kryefamiljare, individë të rriskuar nga trafikimi dhe viktima/viktima të mundshme trafikimi) për periudhën 2020-2022, ndërsa startup-et e krijuara numërojnë 40 për të njëjtën periudhë.”

- ☐ Number of child victims of THB who were appointed legal guardians.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës disponon të dhëna statistikore vjetore vetëm për rastet e fëmijëve të trafikuar që kanë menaxhuar Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës.

Nga raportimet e NJMF për vitet 2019-2023 rezulton si më poshtë;

Viti 2019 - 45 raste të fëmijëve të trafikuar të menaxhuara nga NJMF-të;

Viti 2020 - 60 raste të fëmijëve të trafikuar të menaxhuara nga NJMF-të;

Viti 2021 - 38 raste të fëmijëve të trafikuar të menaxhuara nga NJMF-të;

Viti 2022 - 35 raste të fëmijëve të trafikuar të menaxhuara nga NJMF-të.

Deri në shtator vitin 2023 ka 20 raste të fëmijëve të trafikuar, të menaxhuar nga NJMF-të. ASHDMF është në proces të mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave statistikore për vitin 2023. Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës menaxhojnë dhe monitorojnë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, përfshirë fëmijë VT/VMT. Në zbatim të PSV-ve, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve është pjesë e intervistës formale të fëmijëve, dhe në rastet kur fëmija rezulton VT/VMT merr rastin në mbrojtje sipas legjislacionit në fuqi, duke zbatuar hapat dhe për menaxhimin e rastit. Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës në bashkëpunim Grupin Teknik Ndërsektorial në nivel vendor, hartojnë Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës.

- ☐ Number of victims of THB granted a recovery and reflection period (disaggregated by sex, age, nationality, form of exploitation).
- ☐ Number of victims of THB granted a residence permit, with an indication of the type of the permit (for the purpose of co-operation in the investigation/proceedings, on personal grounds, other) and its duration (disaggregated by sex, age, nationality, form of exploitation).

Për periudhën raportuese janë pajisur me leje qëndrimi 9 raste:

- 1 viktimë e mundshme trafikimi, femër, 38 vjeç, rumune, shfrytëzim seksual, leje qëndrimi humanitare, 6 muaj;
- 1 viktimë e mundshme e trafikimit, femër, 35 vjeç, Filipineze, shfrytëzim për punë, leje qëndrimi humanitare, 3 muaj;
- 1 viktimë e mundshme trafikimi, femër, 49 vjeç, nga Sri Lanka, shfrytëzimi për punë, leje qëndrimi humanitare, 6 muaj;
- 1 viktimë e mundshme trafikimi, femër, 39 vjeç, nga Siria, shfrytëzim seksual, leje qëndrimi si azilkërkues, 6 muaj;
- 1 viktimë e mundshme trafikimi, femër, 24 vjeç, nga Gambia, shfrytëzim seksual, leje qëndrimi humanitare, 3 muaj;
- 1 viktimë trafikimi, femër, 23 vjeç, serbe, shfrytëzim seksual, leje qëndrimi humanitare, 3 muaj;
- 1 viktimë e mundshme trafikimi, femër, 31 vjeç, italiane, shfrytëzim seksual, leje qëndrimi humanitare, 3 muaj;
- 1 viktimë e mundshme trafikimi, femër, 24 vjeç, rumune, premtim për martesë, leje qëndrimi humanitare, 3 muaj;
- 1 viktimë e mundshme trafikimi, femër, 32 vjeç, rumune, shfrytëzim për punë, leje qëndrimi humanitare, 3 muaj.

- ☐ Number of persons given refugee status or subsidiary/complementary protection on the grounds of being victims of THB (disaggregated by sex, age, nationality, form of exploitation).

U identifikuan 2 raste të mitur në mesin e grupit të refugjatëve me statusin VMT (një sirian dhe një afgan).

- ☐ Number of victims of THB who claimed compensation, who were granted compensation and who effectively received compensation (disaggregated by sex, age, nationality, form of exploitation, with an indication of whether the compensation was provided by the perpetrator or the State, and the amount awarded).

Gjatë vitit 2018 në bashkëpunim me Qendrën për Iniciativa Qytetare, D&E mbështeti një rast (viktimë trafikimi) në gjykatë për dëmshpërblim. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë në vitin 2018 ka vendosur: “Detyrimin e trafikantit për të kompensuar viktimën si pasojë e shfrytëzimit seksual në shumën totale 5,595,623.4 lekë. Vendimi u ankimua nga avokati i autorit. Në vitin 2023, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Viktima nuk është dëmshpërblyer ende as nga autori apo nga shteti.

Në dhjetor 2023, 1 viktimë trafikimi, femër, 24 vjeç, me kombësi shqiptare, shfrytëzim seksual ka aplikuar për dëmshpërblim. Procesi është në fazën fillestare, ku është kërkuar që, gjatë procesit penal (për dënimin e trafikantit), të procedohet njëkohësisht edhe me procesin civil të dëmshpërblimit të viktimës.

- ☐ Number of victims of THB who received another form of financial support from the State, with the indication of the amount received.

Bazuar në legjislacion në fuqi, viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit kanë të drejtë të marrin mbështetje financiare (ndihmë ekonomike) nga shteti, pasi largohen nga streha deri sa të punësohen, në shumën 9.900 lekë. Për periudhën 2019-2023 kanë përfituar ndihmë ekonomike gjithsej 52 viktimat/viktima të mundshme të trafikimit. Konkretisht, në vitin:

2019- 9 VT/VMT;

2020- 9 VT/VMT;

2021 -10 VT/VMT;

2022- 11 VT/VMT;

2023- 13 VT/VMT.

- ☐ Number of victims of THB who received free legal aid.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është institucioni përgjegjës për administrimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti bazuar në të dhënat e rasteve që janë trajtuar nga ofruesit e tyre: 20 qendra të shërbimit parësor të ndihmës juridike, 15 organizata jofitimprurëse dhe 12 klinikat ligjore në të gjithë Shqipërinë.

Në vitin 2019 u bë i mundur miratimi i 90% të akteve nënligjore në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Pavarësisht se ligji ka hyrë në fuqi në vitin 2018, struktura organizative është miratuar në mars 2019. Për këtë vit nuk ka të dhëna të përpunuara për viktimat e trafikimit.

Nga administrimi dhe analiza mujore e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike parësore dhe dytësore për numrin e rasteve të trajtuara për viktimat e trafikimit lidhur me përfitimin e

ndihmës juridike falas nga viti 2020-2023, gjithsej 203 viktimë/viktima të mundshme të trafikimit kanë përfituar nga ndihma ligjore parësore dhe 1 ka përfituar ndihmë juridike dytësore.

Viti	Ndihmë ligjore parësore
2020	24
2021	43
2022	44
2023	92
TOTAL	203

Lidhur me buxhetin e shfrytëzuar, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka një buxhet të dedikuar për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Buxheti është parashikuar në tërësi për të gjithë fushën e veprimtarisë së saj.

Për të gjitha viktimat e mbështetura nga Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafikim, ofrohet asistencë ligjore dhe këshillim nga avokatë profesionistë të këtyre organizatave. Organizatat “Vatra” dhe “D&E” janë të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë për periudhën 2022 – 2024 për të ofruar ndihmë juridike falas. Të gjitha viktimat janë të informuar për të drejtat e tyre, legjislacionin dhe gjithashtu, për ato raste që kanë denoncuar trafikantët e tyre, janë asistuar gjatë gjithë procesit të denoncimit në polici, gjatë marrjes në pyetje në prokurori dhe në gjykatë. Gjatë viteve 2019-2023 kanë përfituar ndihmë juridike falas 402 viktimë të trafikimit/viktima të mundshme të trafikimit (ndihma juridike parësore, ndihmë juridike dytësore dhe përfaqësim në gjykatë).

- ☐ Number of victims of THB who were returned or repatriated to/from your country (disaggregated by sex, age, country of destination, form of exploitation).

Gjatë viteve 2019-2023, për 7 viktimë të mundshme trafikimi është mundësuar kthimi vullnetar i asistuar:

- 1 mashkull, viktimë e mundshme trafikimi, Filipinas, shfrytëzim për punë të detyruar;
- 1 femër, viktimë e mundshme trafikimi, 35 vjeç, Filipineze, shfrytëzim për punë të detyruar;
- 1 femër viktimë e mundshme trafikimi, 39 vjeç, nga Sri Lanka, shfrytëzim për punë të detyruar;
- 1 femër viktimë e mundshme trafikimi, 31 vjeç, Greke, shfrytëzim seksual;
- 1 femër viktimë e mundshme trafikimi, 28 vjeç, nga Gambia, shfrytëzim seksual;
- 2 meshkuj viktimë të mundshme të trafikimit, të mitur nga Afganistani dhe Siria, u ribashkuan me familjen e tyre të origjinës.

- ☐ Number of investigations into THB cases (disaggregated by type of exploitation, with an indication of the number of victims concerned).

Më poshtë do të gjeni tabelat me statistikat e Policisë së Shtetit, nga viti 2019-2023.

Viti 2019:

NR.	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCAVE	Evidentuar	Zbuluar	Zbulimi ne %	Autorë të veprave penale	
					Gjithsej	Masa sigurimi

						Arrestuar	Ndaluar	Gjykim i Lire	Larguar	Ndryshme
1	Trafikimi i personave	34	31	91.18	45	6	1	29	6	3
2	Trafikimi i të miturve	7	7	100	17	4	0	12	1	0
3	Përdorimi shërbimeve nga persona të trafikuar	2	2	100	2	0	0	2	0	0
4	Shfrytëzim prostitucioni	71	59	83.1	79	9	5	57	8	0
5	Mbajtja e lokaleve për prostitucion	20	20	100	31	4	2	24	1	0

Viti 2020:

NR.	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCAVE	Evidentuar	Zbuluar	Zbulimi ne %	Autorë të veprave penale				
					Gjithsej	Masa sigurimi			
						Arrestuar	Ndaluar	Gjykim i Lire	Larguar
1	Trafikimi i personave	22	19	86.4	14	12	0	2	0
2	Trafikimi i të miturve	5	7	100	5	0	0	5	0
3	Përd. Shërb nga Personat e Trafikuar	2	2	100	2	0	0	2	0
4	Veprime që lehtësojnë trafikimin	2	2	100	5	0	0	2	0
5	Shfrytëzim prostitucioni	59	52	88.1	83	8	15	6	4
6	Mbajtja e lokaleve për prostitucion	20	19	95	42	2	15	3	2
7	Ndihmë për kalim të paligjshëm kufiri	304	293	96.3	572	317	43	165	47

Viti 2021:

NR.	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCAVE	Evidentuar	Zbuluar	Zbulimi ne %	Autorë të veprave penale				
					Gjithsej	Masa sigurimi			
						Arrestuar	Ndaluar	Gjykim i Lire	Larguar
1	Trafikimi i personave	14	12	85.71	25	7	2	16	0
2	Trafikimi i të miturve	9	9	100	9	2	0	7	0
3	Përd. Shërb nga Personat e Trafikuar	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Veprime që lehtësojnë trafikimin	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Shfrytëzim prostitucioni	39	35	89.7	41	9	3	29	0
6	Mbajtja e lokaleve për prostitucion	11	11	100	13	4	1	8	0
7	Dhënie ndihme për kalim kufiri	389	377	96.92	576	274	25	230	35

Viti 2022:

NR	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCAVE	Evidentuar	Zbuluar	Zbulimi ne %	Autorë të veprave penale					
					Gjithsej	Masa sigurimi				
						Arrestuar	Ndaluar	Gjykim i Lire	Larguar	Ndryshme
1	Trafikimi i personave	21	21	100	30	0	0	30	0	0
2	Trafikimi i të miturve	12	12	100	18	0	0	18	0	0
3	Përd. Shërb nga Personat e Trafikuar	5	5	100	5	0	0	5	0	0
4	Veprime që lehtësojnë trafikimin	3	3	100	5	0	0	5	0	0
5	Shfrytëzim prostitucioni	69	64	92.75	89	12	3	73	1	0

6	Mbajtja e lokaleve për prostitucion	37	33	89.19	47	12	2	33	0	0
7	Dhënie ndihme për kalim kufiri	418	411	98.33	628	272	46	261	45	4

Viti 2023:

NR.	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCEVE	Evidentuar	Zbuluar	Zbulimi ne %	Autorë të veprave penale					
					Gjithsej	Masa sigurimi				
						Arrestuar	Ndaluar	Gjykim i Lirë	Larguar	Ndryshme
1	Trafikimi i personave	36	36	100	90	5	0	83	2	0
2	Trafikimi i të miturve	15	14	93.3%	18	1	0	15	2	0
3	Përdorimi shërbimeve nga persona të trafikuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Veprime që lehtësojnë trafikimin	3	3	100	3	0	0	3	0	0
5	Shfrytëzim prostitucioni	2	2	100	20	0	0	21	0	1
6	Mbajtja e lokaleve për prostitucion	44	44	100	103	20	5	74	4	1
7	Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve	154	152	98.7	291	114	33	108	29	7

- ☐ Number of prosecutions in THB cases (disaggregated by type of exploitation, with an indication of the number of victims and defendants concerned).

Lidhur me treguesit statistikorë të trafikimit, sipas të dhënave të Zyrës së Statistikës në Prokurorinë e Përgjithshme, që nga viti 2019, rezultojnë si vijon:

1. Treguesit statistikorë të trafikimit të qenieve njerëzore për vitin 2019:

- Nga të dhënat statistikore vërehet një tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal “Trafikimi i personave të rritur” në vitin 2019, prej 11,76 % në krahasim me vitin 2018, nga 17 në 19 procedime. Numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është rritur nga 1 procedim me 3 të pandehur në vitin 2018, në 2 procedime me 4 të pandehur për vitin 2019.

- Numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal “Trafikimi i të miturve”, në vitin 2019 është 6, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 5, ndërkohë numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është 1, po aq sa në vitin 2018. Edhe dënimet, në vitin 2019 rezultojnë po aq sa në vitin 2018, konkretisht 4 të dënuar.

2. Treguesit statistikorë të trafikimit të qenieve njerëzore për vitin 2020:

- Lidhur me trafikimin e personave të rritur, të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal, nga të dhënat statistikore për këtë vepër penale vërehet një tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara prej 21,05 % në krahasim me vitin 2019. Në vitin 2020, për këtë vepër penale janë regjistruar 23 procedime penale dhe 1 procedim me 2 të pandehur janë dërguar për gjykim.

- Për veprën penale “Trafikimi i të miturve” të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal në vitin 2020 për këtë vepër penale janë regjistruar 5 procedime ose me ulje në shifra 1 procedim krahasuar me vitin 2019, dhe është dërguar për gjykim 1 procedim me 11 të pandehur ose me rritje rreth 5 herë të numrit të personave të dërguar për gjykim, krahasuar me vitin 2019.

3. Treguesit statistikore të trafikimit të qenieve njerëzore për vitin 2021:

- Lidhur me trafikimin e personave të rritur, të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal, në vitin 2021, sipas të dhënave statistikore për këtë veprë janë regjistruar 8 procedime penale me 2 të pandehur, dhe 2 procedime me 4 të pandehur janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2020 me ulje 34.7 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe rritje të numrit nga 1 procedim me 2 të pandehur të dërguar për gjykim në vitin 2020 në 2 procedime me 4 të pandehur të dërguar për gjykim në vitin 2021 për këtë veprë penale.

- Për veprën penale “Trafikimi i të miturve” të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, sipas të dhënave statistikore në vitin 2021 për këtë veprë janë regjistruar 2 procedime penale me 2 të pandehur, dhe 2 procedime me 2 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2020 me ulje 66.6 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe shifra të njëjta të numrit procedimeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë veprë penale.

4. Treguesit statistikore të trafikimit të qenieve njerëzore për vitin 2022:

- Për veprën me trafikimin e personave të rritur, të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal, janë regjistruar 7 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 2 të pandehur, ose krahasuar me vitin 2021 me ulje nga 8 në 7 të numrit të procedimeve të regjistruara dhe ulje nga 4 në 2 të numrit të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë veprë penale.

- Për veprën penale “Trafikimi i të miturve” të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, janë regjistruar 4 procedime, ndërkohë nuk ka procedime apo të pandehur të dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2021, me rritje nga 2 në 4 të numrit procedime të regjistruar dhe ulje të numrit nga 2 në 0 të procedimit dhe pandehurit të dërguar për gjykim për këtë veprë.

5. Treguesit statistikore të trafikimit të qenieve njerëzore për 9 mujorin 2023:

i) Lidhur me “Trafikimin e personave të rritur”, të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal, në 9 mujorin 2023, sipas të dhënave statistikore rezulton se është regjistruar 1 procedim penal, ndaj 7 procedimeve penale të regjistruara në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

ii) Për veprën penale “Trafikimi i të miturve” të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, sipas të dhënave statistikore rezulton se në 9 mujorin 2023 janë regjistruar 7 procedime penale dhe 2 të pandehur, ndërkohë që 1 procedim penal me 2 të pandehur është dërguar për gjykim. Krahasuar me 9 mujorin 2022 gjatë të cilit rezulton 1 procedim i regjistruar dhe asnjë procedim i dërguar për gjykim, vërehet rritje e treguesve për këtë veprë penale, gjatë periudhës raportuese.

Të dhënat e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) për çështjet e regjistruara për trafikimin e qenieve njerëzore në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal për vitet 2019-2023:

Viti 2019:

Nr. Rend	Vepra penale	Çështje të regjistruara në vitin 2019	Numri i personave	Përfundimi
1	110/a, 278/a, 283/a, 333/a	1		Dërguar për kompetence

2	110/a, 334, 333/a	1		Pezulluar
3	110/a, 333/a, 334	1		Pezulluar
	Totali	3		

Në vitin 2020 nuk ka pasur çështje të regjistruara për trafikimin e qenieve njerëzore në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal.

Viti 2021:

Nr. Rend	Vepra penale	Çështje të regjistruara në vitin 2021	Numri i personave	Përfundimi
1	110/a/1, 283/a/1, 28/4, 333/a, 334	1		Hetim
2	110/a, 284/a	1	1	Pushuar
	Totali	2	1	

Viti 2022:

Nr. Rend	Vepra penale	Çështje të regjistruara në vitin 2022	Numri i personave	Përfundimi
1	110/a, 143, 186, 298/3, 333/a	1		Bashkuar
2	110/a, 114/2, 287, 333/a	1		Hetim
	Totali	2		

Viti 2023:

Nr. Rend	Vepra penale	Çështje të regjistruara në vitin 2022	Numri i personave	Përfundimi
1	110/a, 283, 283/a, 298/2, 333/a	1		Hetim
	Totali	1		

- ☐ Number of convicted perpetrators of THB (disaggregated by sex, age, nationality, form of exploitation).
- ☐ Number of convictions for THB, with an indication of the form of exploitation, whether the victim was adult or child, the type and duration of the penalties, and whether they were effectively enforced or suspended.

Të dhënat e Ministrisë së drejtësisë në lidhje me dënimet për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore, konkretisht, nenin 110/a “Trafikimi i të rriturve” dhe neni 128/b “Trafikimi i të miturve”, për vitet 2019-2022 jepen më poshtë. Lidhur me të dhënat e vitit 2023, do ua dërgojmë sapo të përpunohen dhe analizohen.

Neni	2019		2020		2021		2022	
	Rastet e zgjidhura	Të dënuarit	Rastet e zgjidhura	Të dënuarit	Rastet e zgjidhura	Të dënuarit	Rastet e zgjidhura	Të dënuarit
110/a	4	2	1	2	3	3	1	3
110/b	0	0	0	0	0	0	0	0
110/c	0	0	0	0	0	0	0	0
128/b	3	4	0	0	1	1	0	0

- ☐ Number of judgments in THB cases resulting in the confiscation of assets.
0
- ☐ Number of convictions of legal entities for THB.
0